



kyriias

NUMËR 1, 2023

REVISTË PERIODIKE SHKENCORE-INFORMATIVE

BOTIM I KOLEGJIT UNIVERISTAR "QIRIAZI"



**Gurthemeli në ngrehinën e
arsimit të lartë**

KYRIAS- Është një revistë shumëdisiplinare shkencore-informative e Kolegjit Universitar Qiriazi.

KYRIAS është revistë dygjuhëshe (shqip dhe anglisht) dhe publikohet çdo gjashtëmujor.

Kjo revistë është një burim informacioni me qasje të hapur.

© KOLEGJI UNIVERSITAR QIRIAZI – TIRANË, SHQIPËRI

This is a multidisciplinary scientific-informative journal of Qiriazi University College.

KYRIAS is a bilingual (Albanian and English) journal, and is published semi-annually.

This Journal is an Open Access source of information.

© Published by: QIRIAZI UNIVESITY COLLEGE – TIRANA, ALBANIA

Kryeredaktori: / Editor-in-Chief: Dr. Gjovalin Gjeloshi

Redaktor: / Editor: PhD. Viliem Kurtulaj

Bordi Editorial: / Editorial Board:

Prof. Dr. Hamit Boriçi, Tiranë

Akademik, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj, Akademia e Shkencave e RSH

Prof. Dr. Abdyl Sinani, Kolegji Universitar Qiriazi

Prof. Dr. Vejsel Rizvanolli, Kolegji Universitar Qiriazi

PhD. Viliem Kurtulaj, Kolegji Universitar Qiriazi

Komiteti Shkencor: / Scientific Committee:

Prof. Dr. Halit Xhafa, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Prof. Dr. Ylli Zhurda, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë,

Prof. Dr. Dr. Basil Schader, Shkolla e Lartë Pedagogjike, Zyrih, Zvicër

Prof. Asc. Dr. Arif Atak, Bursa Uludag University, Bursa Turqi

Prof. Dr. SkenderAsani, ITKSHSH, Shkup, Maqedonia e Veriut.

Dr. Mark Camaj, Universiteti Shtetëror i Nikshiqit, Mali i Zi

Prof. Asc. Dr. Enida Bozheku, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Gurakuç Kuçi, Instituti i Sigurisëw “Oktapod”, Prishtinë, Kosovë

Dr. Meri Kraja, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Gerta Gjeta, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Valentina Memini, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Marsela Resulaj, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Erjona Fusha, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Altin Kulli, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë

Dr. Sadri Ramabaja, Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, Prishtinë, Kosovë

Dr. Gjovalin Gjeloshi, Kolegji Universitar Qiriazi, Tiranë.

Design: Hekuran Koka

TIRANË/TIRANA, 2023

Udhë të mbarë, “Kyrias”!

Prof. Gjokë Uldedaj
President i Kolegjit
Universitar Qiriaz



Me këtë numër, po fillojmë një botim periodik të Kolegjit Universitar Qiriaz. E kemi emërtuar “Kyrias”, në nderim dhe në respekt të ikonave themeluese të Institutit Femëror Kyrias (Qiriaz), motrat Qiriaz dhe Kristo Dako, vepër e cila u projektua përpara më shumë se 100 viteve dhe vijon sot nga stafi akademik e administrativ i këtij Institucioni të Arsimit të Lartë.

Revista lindi dhe u formësua si një nevojë për vëmendje të shtuar ndaj jetës studentore, punës dhe aktiviteteve në auditore dhe jashtë tyre, por edhe si një detyrë akademike për të pasqyruar punimet shkencore të pedagogëve dhe studentëve, të cilën ne e konsiderojmë si një mision parësor.

Numri i parë i revistës Kyrias është konceptuar në dy rubrika kryesore, të cilat përbëjnë edhe drejtimin e saj: shkrimet informative dhe ato me karakter shkencor.

Revista do të jetë e hapur dhe e disponueshme për të gjithë, dhe jo vetëm për pedagogët dhe studentët tanë, por edhe për intelektualët dhe studiuesit, kryesisht ato që vijnë nga hapësira jonë kombëtare, për të promovuar punime të cilat synojnë të kontribuojnë në kërkimin shkencor dhe politikat social-ekonomike. Kjo vihet re qysh në këtë numër të cilin tashmë e

këni në dorë.

Botimi i revistës është një projekt i kahershëm i joni, por asgjë nuk bëhet “pa i ardhur dita”, thotë populli. Si numër i parë, natyrisht që do të ketë edhe mangësitë e veta, por nuk pritëm më. Thamë: më mirë një revistë të paperfeksionuar, se sa një revistë të munguar. Por numër pas numri, do të kemi synime të qarta dhe ambicioze, që “Kyrias” të zërë vendin e merituar midis botimeve të universiteteve të tjera, brenda dhe jashtë vendit.

Duke parë strukturën dhe autorët të cilët janë të përfaqësuar në këtë botim është lehtë të konkludojmë që bëhet fjalë për një revistë periodike serioze, që vjen pas botimit tonë të librit “Mosha e Artë e Një Universiteti”, për t’u krijuar hapësirë atyre që mendojnë dhe krijojnë, si një dëshmi trashëgimie për ne dhe për kohën tonë. Kjo për faktin se ne kemi një traditë historike të spikatur dhe na shkon që edhe të lavdërohemi për këtë të vërtetë, por Elioti ka thënë: ... nëse këni nevojë për traditë, atëherë duhet ta fitoni me shumë mund!

Fillimisht është konceptuar si një revistë periodike informative-shkencore. Më vonë, do të kalojmë në botimin e dy revistave të tilla: njëra informative dhe tjetra shkencore. Këto janë angazhimet tona për të ardhmen e afërt. Synimet tona janë të bëhemi një zë i fuqishëm, si në pasqyrimin e jetës studentore të universitetit tonë e më gjerë ashtu edhe në pasqyrimin e punës kërkimore shkencore, veprimtarinë akademike dhe ndërkombëtarizimin e universitetit, duke ju përmbajtur edhe në vazhdimësi modelit evropian të qeverisjes universitare, bazuar në lirinë akademike dhe autonominë administrative. Ky hop cilësor do të pasqyrohet edhe në faqet e kësaj reviste, duke botuar rubrika të veçanta edhe në anglisht.

U jam shumë mirënjohës dhe i përgëzoj për këtë botim, kryeredaktorin Dr. Gjovalin Gjeloşi dhe anëtarëve të këshillit botues që miratuan përgatitjen e botimit të numrit të parë: Prof. Dr. Hamit Boriçit, Prof. Dr. Akademik Gjovalin Shkurtaç, Prof. Dr. Abdyl Sinani etj.

Jemi të vetdijshëm për punët që na presin përpara, si për të mbajtur lart emrin e revistës, “Kyrias”, këtë dritë të iluminizmit shqiptar, ashtu edhe për të qenë një hapësirë e lirë e mendimit akademik në dobi të zhvillimit dhe ecjes përpara të vendit tonë.

Gurthemeli në ngrehinën e arsimit të lartë

Nga Dr. Gjovalin Gjeloşi



Universitetet disashekullore në Europë dhe në botë, rrënjët e historisë së tyre i kanë në kolegje, shkolla normale apo teknike. Ato nuk kishin statusin e sotëm qysh në vitin e themelimit, por natyrisht numërimin e viteve të moshës, e fillojnë prej andej, sepse është viti i lindjes së tyre. Historia e arsimit në Shqipëri, megjithëse më e vonuar se në vendet e tjera të Europës, do të kishte edhe ajo sot, universitete 100 e më shumë vjeçare, nëse do të kishim një rrjedhë normale historike. Ne kishim disa kolegje e shkolla teknike cilësore, të krahasueshme me ato të vendeve të tjera, që mund të ishin djepet e disa prej universiteteve të sotme. Një ndër to dhe fatkeqësisht, i vetmi i mbetur gjallë, që filloi si shkollë vajzash më 1891 në Korçë; u rihap si “Instituti Femëror Qiriaz” më 1922, në Tiranë; u rithemelua si Shkollë e Lartë Universitare më 2006 dhe u rikonfirmua si Kolegj Universitar më 2016, e vijon edhe sot, është Kolegji Universitar “Qiriaz”.

101 vite...

Gjyshërit tanë, kur donin të tregonin për dënimin e rëndë që i ishte bërë një personi, na thonin: e mbyllën në kala të dënuem me 101 vite burg. A ishte apo jo, e parashikuar kjo masë në Kodin Penal të ish Perandorisë Osmane, këtë e kam të paqartë, por fakti është se disa vende anglo-saksone, edhe sot e aplikojnë këtë: ose si shumë të bashkimit të akuzave të ndryshme (shifër që mund të dalë edhe më tepër), ose si dënim maksimal. Se ku dallon termi “dënim i përjetshëm” me atë “101 vite”, don një spjegim sa juridik, aq edhe psikologjik mendoj, por nuk është vendi të merremi me këto përkufizime.

Para disa dekadave, edhe Instituti i Vajzave “Qiriazi”, në Kodër Kamëz, pas vetëm pak viteve jetë, u dënua (u mbyll), por pa dhënë një dënim të përcaktuar. Megjithatë me kohët që pasuan më vonë, shumë menduan se ai që një dënim i përjetshëm. Jo me “101 vite”, sepse një dënim i tillë, linte vend për shpresë. Nën regjimin komunist, askush nuk kishte të drejtë të mendonte se do të kthehej e kaluara: “e errët” për regjimin, “e ndritur” për ëndërrimtarët... Por ja që, të dytët patën të drejtë të shpresonin. Sot, në krye të 101 viteve, Kolegji “Qiriazi” nuk



është më i dënuar. Ai i përkujton në liri këto vite. Qe i dënuar, u ngrit nga hiri. Qe i nëpërkëmbur, u rrethua nga lavdia e vet. U ngrit bashkë me themeluesit, sepse në këtë përvjetor të 101-të, mendja së pari na shkon te ata që vunë gurin e parë në ato themele. Në themelet e arsimit të lartë, nuk qe guri i vetëm ky i Qiriazëve, qenë edhe gurë të tjerë, por në lartësimin e mureve të kësaj ngrehine, vetëm ky gurë mbeti. Ishte një gur faqok. Asi gurësh që mbajnë qoshen e ngrehinës. Historia e gurthemelit të këtij institucioni nis me Gjerasim Qiriazin, që siç shkruan Kristo Dako në kujtimet e tij “Të ndjerit... i takoi nderi për të qenë i pari, që e mëkoi këtë ide fisnike, për të hapur një shkollë shqipe për vajzat”. Ndërsa Sevasti Qiriazit (Dako) kujton: “Në tetor të vitit 1891, dyert e Shkollës së vashave, njohur me emrin Instituti Qiriazi, u hapën në shtëpinë tonë me tri vajza mjaft inteligjente e premtuese. Fillimi ishte shumë i thjeshtë, por kur mbyllëm vitin shkollor në qershor, numri kishte arritur në 27 nxënëse, më shumë nga çfarë kishim guxuar edhe të shpresonim si fillim”. Një dhomë e shtëpisë mori pamjen e klasës mësimore: disa banka me madhësi të ndryshme, një tavolinë për mësuesen, një dërrasë e zezë dhe disa harta të varura mureve. Këto ishin “të gjitha orenditë” që përbënin shkollën e parë... Kjo ishte përvoja edhe e shkollave të tjera të vajzave që ishin ha-



Kur hidheshin themelet e arsimit të lartë

pur në të gjithë ish-Perandorinë Osmane. Çfarë ishte shkolla e vashave? Përgjigjen e jep vetë Parashqevi Qiriazi kur shkruan: “Për nga tipi, ajo është një shkollë e dytë, me një shkollim në katër vite dhe së bashku me të, i shtohet një shkollë elementare si aneks që zgjat pesë vjet. Qeveria e ka luftuar për 22 vjet këtë shkollë, por lavdi Zotit, nuk ia ka dalë ta mbyllë”.

Ndërsa Aleksandër Dako, i biri i dy ikonave të arsimit tonë kombëtar, Kristo Dakos dhe Sevasti Qiriazit, do të shkruante në kujtimet e tij: “Mitropoliti i Korçës, botërisht dhe zyrtarisht, e cilësonte shkollën kombëtare shqipe të vashave, si shkollë protestante. Kjo merrte ngjyra zyrtare, se Mitropolia ishte një institucion zyrtar i Perandorisë Turke, se varej nga Patrikana e Stambollit, e cila kishte të drejtë mbi të gjithë të krishterët orthodoksë të Perandorisë. Institucionet protestante ishin institucione të huaja që përfitonin nga privilegjet e fituara me traktatet e kapitulacioneve e autoritetet turke nuk kishin pushtet mbi to. Pra ky epitë i shpikur nga Mitropolia greke, në vend që t’u demaskonte shkollën e Sevastisë, u bë një armë në dorë të saj”.

Edith Durham, mike e ngushtë e Sevastisë, pasi vizitoi Korçën, do të shkruante: Ndërsa Ohri është ende mesjetar, Korça është e qytetëruar. Në shkollën shqipe të vajzave m’u bë një pritje shumë e ngrohtë. Shkolla ishte aq moderne, sa m’u duk sikur befasisht kthyer prapë në Europë. Është e vetmja shkollë në

gjithë Shqipërinë e Jugut, ku fëmijët shqiptarë lejohen të mësojnë shkrim e këndim në gjuhën e tyre amtare, që qëndronte e hapur me gjithë kërcënimet. ...Kjo shkollë ishte gjithmonë plot me nxënës, ndonëse po ta vazhdoje atë, si për prindërit ashtu edhe për nxënësit vetë, do të thoshte të përndiqeshe nga turqit ose të shkishëroheshe nga prifti grek.

Nga ”Shkronjëtorja” tek “Pedagogjia”

Në shkollën e vashave mësoheshin lëndë të tilla si: gjuha shqipe (shkronjëtorja), alfabeti (këndimi), të shkruarit (bukurshkrimi), truptregonja e njeriut (anatomia), botëshkronja (histori e botës), dhëshkronja (gjeografia), kafshëshkronja, (zoologjia), bimëshkronja (biologjia), histori e shenjteruar (histori e feve), këndimi i ungjillit, (fjalëlidhja), punëdore (qepje, qëndisje, thurje me shtiza), vjersha, këngë, valle, dialogje etj). Por nuk mungonin edhe arithmetika e gjeometria. Shumica e teksteve bazë u realizuan nga mësuesit e shkollës, por pati edhe mjaft libra të përkthyer. Duke shfletuar regjistrin themeltar të Institutit Qiriazi në Kamëz, mësojmë edhe për strukturën e lëndëve që janë zhvilluar në këtë institucion arsimor. Në programet arsimore, një vend të rëndësishëm zinte edhe mësimi i gjuhëve të huaja, si klasike: latinisht, greqishte e vjetër e arabisht, ashtu edhe moderne: gjuhët anglisht, frëngjisht e italisht.



Musine Kokalari dhe Drita Kosturi, Studente te Kolegji Femëror Qiriazi.
 Në ditët e vjeshtës së dytë tiranase, Musinea erdhi në këtë tempull me emrin KYRIAZ. Me të vërtetë kishte qenë me fat, por sidoqoftë, ajo ishte ende një vajzë e vogël dhe e merrte malli. Kishim mësueset e shquara Sevasti Dakon dhe Parashqevi Kyrias, të cilat na mësonin me dashuri dhe zell. Musinea erdhi nga Gjirokastra. Ishte jashtëzakonisht e sjellshme dhe e urtë. Ne kishim bërë anglisht dhe ishim më përpara. Musinea dallonte në të gjitha mësimet dhe vështirësitë e anglishtes, i kapërceu me punë e me një vullnet të jashtëzakonshëm, sepse të gjitha mësimet i bënim në gjuhën angleze. Gjuhën shqipe na e jepte Sevasti (Qiriazi) Dako.- Ganimet Gilani, ish nxënëse e Institutit.

Në regjistrat e klasave të Fillores, të Liceut dhe të Normales të Institutit Kyrias, janë të shënuara këto lëndë:

- Në klasat e fillores: Mësim shkrimi, Këndim, Diktat (Diktim), Kaligrafi, Vizatim, Kangë, Gjymnastikë, Trajtë e Përjashtme e Shkrimit; Italisht, Ushtrime gramatikore, Hartim, Anglisht, Matematikë e gjeometri, Histori natyre, Dituri natyre (Zoologji), Gjeografi e histori, Shkrim e ortografi.
- Në klasat e Liceut: Letreshkrimi, Ushtrime gramatikore, Anglisht, Frëngjisht, Arithmetikë e Gjeometri, Dituri Natyre (Zoologji), Gjeografi, Histori, Kaligrafi, Vizatim, Kangë, Gjymnastikë, Italisht, Kangë e piano, Ekonomi shtëpiake, Punë dore, Fizikë, Botanikë, Letërsi, Psikologji, Pedagogji, Histori e Arteve, Filozofi.
- Në klasat e Normales: Italisht, Letërsi, Anglisht, Arithmetikë e gjeometri, Filozofi, Psikologji, Kimi, Gjeografi, Histori, Pedagogji, Kangë, Vizatim, Gjymnastikë,

Ekonomi shtëpiake, Punëdore.

Vajzat që hoqën mbulesën e përqaftuan librin

Sipas statistikave, gjatë 23 viteve të funksionimit të shkollës në Korçë, janë ulur në bankat e saj plot 1028 vajza, nga të cilat 20 kanë arritur të diplomohen. Pra, ndërkohë që Shkolla Normale e Elbasanit, nuk kishte nxjerrë akoma të diplomuarit e parë, nga shkolla e vashave në Korçë kishin dalë 20 mësuese, të cilat shërbyen në shumë shkolla fillore të Shqipërisë. Të diplomuarat e para në Institutin Kyrias në Tiranë, dalin në vitin 1928: Nadide Nafiz dhe Çeçilja Lezhja. Çeçilja Ndoc Lezhja emërohet mësuese në shkollën që e kishte diplomuar. Në vitin e dytë, më 1929, numri shkon në gjashtë. Ndërsa në vitin 1931 diplomohet numri më i madh krahasuar me të gjitha vitet e funksionimit të Institutit, gjithësej 12 studente: Liria



T. Buda, Viki Thoma, Viola Floqi, Nazmie Xhepa, Roksani Naçi, Makbule Beshiri, Antonetta De Bella, Amalia Koljaka, Maria Shala, Angjeliqi Magjistari, Naxhie Gjoni dhe Ballkezi Besim. Nxënëse të Institutit “Kyrias” ka qenë edhe Musine Kokalari, e cila vijoi pastaj në Institutin “Nana Mbretneshe”, një grua me personalitet të lartë, që u bë shembull frymëzimi për qëndrestarët dhe u kthye në ikonë të pathyeshmërisë, me gjithë egërsinë e regjimit që veproi mbi të. Në Institutin Qiriazi studjuan edhe katër nga gjashtë motrat e mbretit Zog: Maxhide, Ruhije, Sanije dhe Myzejen Zogu. Tre motrat e personalitetit shqiptar Aleks Buda: Liri, Tashko dhe Rosa Buda. Vini re emrat e vajzave. Aty nuk kishte dallime fetare: të krishtera dhe myslimane, madje në këtë institut kishte vajza edhe prej vendeve të huaja. Shtypi i kohës shkruante se, në vitin 1931 Institutit kishte 150 nxënëse. “76 ndjekin Degën Normale, 54 Degën Liceale dhe 20 Degën e Ekonomisë Shtëpiake”. Këtë Degë të fundit, Institutit kishte planifikuar që ta zgjeronte, duke i dhënë një rëndësi më të madhe. Gjithashtu do të zgjeroheshin edhe studimet muzikore. Por rrezatimi i dijes dhe arsimit prej shkollës dhe institutit Kyrias, e tejkalonte numrin e vajzave që u ulën në banka dhe “të mësuarit shqip” shkoi edhe në skajet më të largëta. Numrit të qindrave vajzave që muarën dije aty, prej mësueseve të tyre, i shtohen edhe qindra të tjerë që mësuan këto vajza në familjet e vendbanimet e tyre si dhe qindra djem që pasditeve merrnin mësim nga vetë drejtoresha e shkollës

Sevasti Qiriazi.
 Në Institutin “Qiriazi” nuk u regjistruan vajza që vinin vetëm nga zonat e Tiranës. Sipas kujtimeve të Sevastisë, qysh në vitin e dytë [1923-1924] u regjistruan një turmë vajzash. Kishte vajza që përfaqësonin rrethet e Dibrës, Matit, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Vlorës dhe Beratit.

Programet e studimit-si themele të arsimit të lartë

Në vitin shkollor 1930-1931, Institutit “Qiriazi” në Tiranë ishte i organizuar në dy departamente: Departamenti Gjymnazial, në të cilin nxënëset që kishin mbaruar shkollën fillore merrnin mësimet të përgjithshme. Mësimet në këtë kurs zgjasnin 3-4 vjet, dhe Departamenti Superior, i cili ndahej në tri degë të specializuara: Dega e Shkencave dhe ajo e Ekonomisë Shtëpiake, ku pranoheshin nxënëse që kishin mbaruar kursin gjymnazial dhe që dëshironin të specializohen në shkencat apo në ekonominë shtëpiake. Ky kurs zgjaste dy vjet, kurse ai shkencor katër; e dyta, Dega e Shkencave Pedagogjike, ku pranoheshin nxënëse që kishin mbaruar kursin gjymnazial. Qëllimi i këtij kursi që zgjaste tre vjet, ishte të përgatiste mësuese “në kuptimin të plotë të fjalës me dijeni pedagogjike të sosur e me sjellje morale shembullore” dhe e treta, Dega Liceale (klasike). Në këtë degë pranoheshin nxënëse që kanë mbaruar kursin gjymnazial. Qëllimi i

këtij kursi që zgjaste katër vjet, “është plotësimi i kursit liceal (dega klasike dhe të gjuhëve moderne), kështu t’u çelë nxënseve rrugën për të hyrë në universitete. Mësimet jepen pas një programi të aprovuar nga shteti.

Përveç arsimimit të vajzave të reja, drejtuesit e Institutit planifikuan që të jepnin mësim të veçanta për gratë e martuara. Për këtë arsye edhe u hap departamenti i shkencave shtëpiake dhe një departament i ekonomisë shtëpiake.

Edukimi i grave të martuara nëpërmjet këtyre departamenteve ndikoi shumë në rritjen e nivelit të kulturës së jetesës në familjet shqiptare, pjesë e të cilave ishin këto gra. Kultura e mësimet që muarën te “Qiriazi” ndikoi dukshëm në përmirësimin e nivelit të jetesës dhe në edukimin e tyre dhe të fëmijëve që ato rrisnin.

Në programet e vitit 1931 e në vijim, drejtuesit e Institutit thurnin plane të reja, të cilat do ta çonin këtë institucion në shtigje të pashkelura më parë, por me besim të plotë se do të arrinin në parametra të arsimit perëndimor. Qëllimi i tyre ishte që “për riorganizimin e degëve, në marrëveshje me Ministrinë e Arësimit, Instituti të kishte 4 vjet gjimnazial të ulët dhe 4 vjet liceal superior. Edhe Dega Normale të bëhej 8 vjeçare. Si plotësuese për Degën Normale, të çelë një shkollë fillore, që jo vetëm të vlejë për praktikën e normalisteve, por edhe “të prega-



titen vajza të vogla me dituri më të shëndoshë e të përshtatshme”. Të çelë edhe një foshnjore e sistemit “Montesori” për fëmijë të vegjël të moshës 4-6 vjeçare, të cilët të merreshin me autobus që në mëngjes dhe do të kthehen në shtëpi në mbrëmje.

Kur provimet ktheheshin në festë “kombiare”

Shumë gazeta të kohës, në lajmet informative përcillnin “emocione dhe festë” në provime. Dhe kjo atmosferë përcillej si nga shkolla e vashave në Korçë ashtu edhe prej Institutit Qiriazi në Tiranë. “...Sivjet s’mbeti njeri pa mos marrë pjesë në këtë festë thjeshtë kombiare, shkruan njëra prej gazetave të kohës, për provimet në shkollën e vashave.

E njëjta atmosferë dhe metodikë pune në organizimin e ditës së provimeve, sikurse në Korçë ndiqej edhe në Kamëz. “Ka një javë që po vazhdojnë provimet për mbylljen e vitit shkollor në Institutin Qirias, nën vëzhgimin e Jonuz Blakçorit, i dërguar nga Ministria e Arësimit – njofton shtypi i kohës. Këtë muaj me 23 qershor (1931), diplomohen 12 vajza të Institutit, por në rast se do të realizohet riorganizimi, disa do marrin një degë tjetër dhe do të vazhdojnë për tri vjet të tjera”.

Ndërsa një vit më vonë, gazeta “Ora”, me titullin “Festim i bukur në Institutin Qiriaz”, na jep një panoramë të radhë feste në muajin e provimeve. “Pjesëmarrje e jashtzakonshme aq sa edhe sheshi i ministrive ku parkonin makinat e shtetit apo edhe taksitë, ishte bosh. Taksitë venin e vinin nga qyteti i Tiranës për në Kodër-Kamëz, ku është Instituti për të dërguar atje ata që donin të ishin prezent në këtë festë. Nuk mungonte as ministri i Arsimit, Hilë Mosi”. Në festën e fundvitit shkollor, gjithçka e organizonin vetë nxënëset: teatrin, muzikën, ekspozitat e punimeve me dorë apo manifestimet sportive. Aq të arrira ishin vajzat në luajtjen e pjesëve muzikore në këtë institut, sa një autor shprehet: po të jepen mësimet e muzikës edhe në shkolla të tjerat të mbretërisë si në Institutin Qiriazi, nuk do të ishte nevoja e ngritjes së një shkolle të veçantë për muzikë edhe për shumë kohë. Ndërsa në festimet e 40

vjetorit të themelimit të Institutit Qiriazi, më 1931, pasi nga vajzat u shfaq drama “Foleja Kombëtare”, një zyrtar i lartë, i emocionuar nga niveli artistik dhe loja e aktoreve-studente, u shpreh: “Unë kurrë nuk kam menduar se vajzat tona ishin të afta për të na dhënë një dramë, e cila do të na mbante të gjithëve gojëhapur...”.

Mësuesi - si ikonë e shkollës

Instituti Qiriazi, qysh në themelimit si shkollë vajzash në Korçë pati mësues të aftë e të përkushtuar. Personeli i shkollës në vitet e para në Korçë, përbëhej nga: Gjerashim Qiriazi, drejtor, Sevasti Qiriazi, Thanas Sina Postenani dhe Fanka Eftim. Mësues të tjerë që kanë dhënë mësim në këtë shkollë janë edhe patriotët e shquar Grigor e Katerina Cilka, Gjergj Qiriazi, Kristo Dako, Parashqevi Qiriazi, nxënës të kësaj shkolle Polikseni Luarasi, Helidhona Titu (Falli), amerikanët Fineas e Violet Kenedi të Misionit Amerikan etj. Përshtypje të jashtëzakonshme tek të gjithë mësuesit dhe nxënësit e institutit, bënte Sevastia trupvogël, me vështrim të butë e sy të qeshur. Gjithnjë e qetë, e përmbajtur, përhapte rreth vetes shumë mirësi e dritë. Unë s’njoh tjetër shenjë madhështie, veç mirësisë. – shprehej ajo. Njeriu mund të jetë i madh, vetëm kur e ka shpirtin të madh, si poeti ynë Naim Frashëri.

Sevastia nuk shpërthente kurrë, kujton një studente e institutit, megjithëse ishte në këmbë që nga mëngjesi deri në darkë. Ajo kishte hijen e një gruaje të shquar, me kulturë, që të bënte për vete dhe të detyronte të bindeshë. Kjo figurë arsimtareje ishte shumëfishuar në përbërjen e kolektivit mësimdhënës në Kyrias. Në vitin shkollor 1928-1929, personeli mësimor përbëhej nga 11 mësues, që përveç vetë Qiriazos-Dakove dhe e palodhura Fanka Eftim, ishin edhe Çeçilja Lezhja, Marianne Bouffard nga Zvicra, Verena Pfenninger nga Zvicra, Eugenia Damin nga Roma. Tefta Naçi, e bija e Nuçi Naçit, ishte një mësuese tjetër e re. Ajo vinte nga familja e njohur e Naçeve, miq të Kyriazëve. Tefta jepte historinë e Shqipërisë dhe edukatën.

Instituti Qiriazi kishte rregulla të ngjashme me shkollat e vendeve të përparuara, përsa i përket

marrjes në punë të mësuesve. Nga që mungonin mësueset brenda vendit, drejtorja e Institutit hynte në kontakt me mësuese të huaja, si italiane, amerikane, austriake, franceze etj., të cilat pasi njiheshin me kushtet e kontratës, filonin punë aty. Mësueset ishin rezidente dhe si shtëpi banimi shërbentë kati dytë i një ndërtese të bukur që funksionon edhe sot.

Drejtorja e Institutit bënte një punë mjaft të kujdesshme me personelin, jo vetëm për rekrutimin e tyre si pjesëtarë të trupës pedagogjike-mësimore, por edhe në trajtimin e tyre në vijimësi. Mësimdhënësit trajtoheshin sikur të ishin pjesëtarë të familjes në kuptimin e dashurisë dhe respektit.

Siç shihet, personeli mësimor më së shumti përbëhej nga mësuese të huaja, të gjitha të përkushtuara dhe shumë shpejt të mësuar me zakonet e vendit dhe me gjuhën shqipe. Të gjitha vajza të reja beqare, ato vijuan traditën e mësueseve idealiste, që punuan qysh në vitet e Perandorisë Osmane, në vendet më të vështira të Lindjes, për të kontribuar në përparimin dhe arsimimin e popujve të lënë në errësirë.

Nga Tirana në Kodër-Kamëz

Në vitin 1922, Instituti Femëror “Qiriazi” u hap fillimisht në një shtëpi tiranase, (atë të S. Kusit) në të ashtuquajturën “Rruga e Fiqve”. Viti shkollor 1927-1928 filloi në godinën e re, aty ku është edhe sot Kolegji Universitar Qiriazi. Kabinete të plota, salla të bollshme, me tavane të larta e me dritare të mëdha plotë dritë. Kati i tretë ishte kryesisht fjetore. Sipas kujtimeve të studenteve, në atë kat kishte dhomën e vet edhe zonjusha Parashqevi, e cila e kishte përshtatur këtë dhomë sipas traditës korçare. Mësueset e tjera flinin në godinën afër, në katin e dytë, ndërsa në katin e parë qe biblioteka. Poshtë shtrihej kompleksi sportiv, aty ku gjendet edhe sot dhe që i shërben Kolegjit Universitar. Ambienti i shkollës dhe konvikti ishin të përsosur, kujton Ganimet Gilani, një ish-nxënëse - me një pastërti shembullore. Çdo mëngjes, bënim banjë, visheshim me uniformë, fund e bluzë, këndonim hymnin e flamurit. Hynim në mensë e hanim në tryeza të veçanta. Kishim mësuese italiane, angleze e franceze. Kishte



Shtëpia e Sulejman Kusit, ku u hap për herë të parë Instituti Femëror Qiriazi, 1922

edhe nxënese franceze, armene, italiane, të cilat e mësuan aq bukur shqipen, sikur të qenë rritur në Shqipëri. Pasi mbaronim mësimet në shkollë, vijonin orët e studimit në konvikt dhe në kohën e lirë, secila merrej me ç'të dëshironte më shumë: dikush merrej me muzikë e të tjerat me sport, hendboll e basketboll.

Instituti "Kyrias" vijoi punë normale, pa ndërprerje vetëm në dekadën e parë të krijimit 1922-1932 (vetëm pesë vjet në kampusin e ri). Në vitin 1933, "kolegji femnuer", si shumë shkolla të tjera private e fetare në Shqipëri, u mbyllën me ligj të parlamentit shqiptar, duke e konsideruar arsimin, kryesisht "të drejtë shtetërore". Ky është edhe viti i fundit, sepse në dallim me shkollat e tjera private, Instituti "Kyrias", kjo "Fole Kombëtare", ky "Tempull dije", kjo "Dritë Fari", "Altar kombëtar i shqiptarizms", "Një shkollë e formës amerikane", siç ishte emërtuar prej vendasve dhe prej të huajve, nuk u çel më. Objektet shkollore pa frymë njeriu brenda, humbën bukurinë dhe shkëlqimin. Në vitet që pasuan, fashizmi, nazizmi e komunizmi, që do të ngjasonin si tri pika uji, arritën ta sekustronin, xhvatnin e përdornin Institutin Kyrias për nevojat e tyre. Për disa dekada me radhë, godina e Institutit Qiriazi-Dako, përfaqësonte korpusin kryesor të Institutit të Lartë Bujqësor. Fillimisht ishte godina e vetme për të gjitha fakultetet: për fjetje, salla mësimi e laboratore, ndërsa në vitet e mëvonshme, godina kryesore e Institutit Kyrias përfaqësonte vetëm Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore.

Pas 47 vitesh të sekuestrimit, më 1992 Instituti Kyrias nuk është më pronë publike. Aleksandër Dako, nuk humbi shumë kohë nëpër gjyqe, për të rikthyer pronën e prindërve. Pas vdekjes së tij, i biri, Robert Dako, realizoi ëndrrën e gjyshërve, Kristos e Sevastisë dhe "tetos", Parashqevi Qiriazi: Në vitin 2006, Instituti "Kyrias", u riçel për të dytën herë (e para ishte në vitin 1922), me statusin "Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Sevasti e Parashqevi Qiriazi".

Pas pezullimit të saj më 2014, në vitin akademik 2016-2017 u rihap për herë të tretë, me emërtimin "Kolegji Universitar Qiriazi", një emër që afrohej më tepër me paraardhësin "Instituti Femëror Qiriazi". Kjo u realizua nga Prof. Dr. Gjokë Uldedaj, i cili konsiderohet si njeriu që e shpëtoi Institutin Qiriazi nga përvjetoret "post mortum".

Sot, Kolegji Universitar "Qiriazi" ka një fytyrë dhe përmbajtje të re. Ka katër Njësi kryesore: fakultetin e Ekonomisë; të Drejtësisë; fakultetin e Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit si dhe Kolegjin Profesional të Lartë, ku përmbledhen 13 programe studimi me pesë diploma profesionale, pesë bachelor, dy diploma master shkencor dhe një diplomë të studimeve të integruara në Drejtësi. Nga 2016-2023, "Kolegji Universitar Qiriazi", ka kaluar dy akreditime institucionale dhe janë të akredituara të gjitha programet e studimit.

Këto ditë po punohet për akreditimin në gjuhën angleze, të dy prej programeve të fakultetit ekonomik.



Shtëpia e Sulejman Kusit, ku u hap për herë të parë Instituti Femëror Qiriazi, 1922

Nëntori i dytë

Kronikë e një përvjetori që priti 90 vjet

NË NËNTOR TË VITIT TË
KALUAR (2022), 90 VJET
PASI ISHTE FESTUAR 40
VJETORI I THEMELIMIT TË
INSTITUTIT TË FEMRAVE
QIRIAZI, KOLEGJI UNIVER-
SITAR "QIRIAZI" PËRKUJTOI
131 VJETORIN E THEMELIMIT
TË KËTIJ INSTITUCIONI DHE
100 VJETORIN E RIHAPJES
NË KAMËZ TË TIRANËS.

*Gjovalin Gjeloşi
Majlinda Prendi*

Duhet të biem dakort për disa të vërteta

Nga Tivari në Korçë, prej shek. të XIII-të deri në të XV-tin, datojnë disa shkolla shqipe si ajo e Ulqinit më 1258, në Durrës, Shkodër, Tivar, Pult, Drisht dhe përfundon në Korçë, në vitin 1496. Të gjitha shkollat e kësaj periudhe, nga Kotorri në Durrës, rezultojnë të jenë të hapura nga priftërinjt katolik të rritit françeskan. (Kujtojmë se urdhëri françeskan, kishte vetëm 50 vjet që ishte krijuar, 1209) Ndërsa në Korçë, shkolla e parë për vajza dhe djem, e ndërtuar në këtë vit, u themelua nga Iljaz bej Mirahori. Kjo shkollë, natyrisht si pjesë e medresesë, ishte e pajisur edhe me një bibliotekë të pasur. Interesante për kohën është se, vajzat dhe djemtë mësonin bashkë në të njëjtën shkollë. Përveç fëmijëve, në këtë shkollë mund të mësonte edhe çdo njeri tjetër që dëshironte, pavarësisht moshës apo gjinisë.

Një shekull më vonë, fillon një fazë tjetër. Në vitin 1584 u themelua shkolla shqipe nga klerikët katolikë në Stubllë, afër Gjilanit, i njohur në Kosovë, si Kolegji i Shën Lukës. Më 1632, hapet shkolla shqipe e Kurbinit nga Imzot Gjon Kolesi. Në vitin 1638, Etërit Françeskanë hapën shkolla në Shkodër dhe në Pllanë. Në vitin 1639, Fretërit e Troshanit hapën shkollë në Blinisht të Zadrimes. Në vitin 1664, hapet shkolla shqipe në Janjevë, afër Prishtinës, me kërkesë të Andrea Bogdanit dhe me mësues të parë Pjetër Mazreku. Të dy ishin pjestarë të Klerit katolik. Më 1698, Padër Filip Shkodra çelë shkollë në familjen Kamsi, në Shkoder.



Sevasti Qiriazi - Dako

Akoma dy shekuj më mbra, nis një fazë e tretë e përpjekjeve për hapjen e shkollave dhe zgjerimin e arsimit të popullatës në gjuhën shqipe. Në Prizren, në vitin 1885, ka një shkollë shqipe për vajza. Më herët, më 1858, Kushe Micja çelë shkollën për vajza shkodrane dhe më 1861 françeskanët hapën një shkollë fillore publike në Shkodër. Në vitin 1874 në Shirokë hapet një shkollë, ku mësohet gjuha shqipe dhe aritmetika nga Dom Zef Ashta. Edhe pse “mësuesi” ishte një prift, shkolla konsiderohet si shkolla e parë laike. Pesë vjet më vonë, më 1879 në Shkodër, Motrat Stigmatine hapin një shkollë fillore për vajza. Madje kjo e fundit, ishte një shkollë që jetoi gjatë. Dhe më 1882, nis e funksionon kolegji Troshanit, institucioni më me emër i kohës. Nga Veriu kthehem përsëri në Korçë. Nuk është rastësi që shkolla e parë shqipe, që njihet deri më sot zyrtarisht, i përket këtij qyteti, 7 mars 1887. Korça kishte një traditë afro 400 vjeçare deri në këtë vit, sepse shkollën e lashtë të Mirahorit e pasuan edhe shkolla të tjera të hapura pranë 2-3 xhamive. Dhe në përmbyllje të shekullit të 19-të, në fund të rrugës së mundimshme mbi 600 vjeçare, që kishte bërë kryesisht Kleri katolik, por edhe ai mysliman, për mësimin e gjuhës shqipe, më 1891 “u lind”

Shkolla e Vashave e Korçës. Është shkolla e fundit shqipe, pa trokitur shekulli i 20-të dhe është shkolla e parë dhe e vetme që mbijetoi dhe funksionon edhe sot, e transformuar me metamorfozën e saj të rritjes: në Kolegj Univer-sitar. Po mirë atëhere, për çfarë duhet të biem dakort? Që mos ta lemë në dorë të fantazisë së shkodranit, korçarit apo kujtdo, se kush është shkolla e parë shqipe: kur, ku e kush e ka hapur. “Si burrat”, duhet të biem dakort: ato shkollat e para që u thanë më sipër, a ishin shqipe, pavarësisht se u themeluan prej klerikëve? Po pse more, kaq ateist është ky popull, sa të mos e pranojë faktin historik të hapjes së një shkolle në gjuhën e vet, vetëm se konsiderohet fetare? Apo, janë ateiste qeveritë që zgjedh populli? Ose minimumi të pranojmë të themi: shkolla e parë shqipe (duke e cilësuar) “laike”, kur i referohemi 7 marsit të vitit 1887. Më tutje të biem dakort të pranojmë, se e vetmja shkollë shqipe (për djem apo vajza, s’ka rëndësi), që u hap në periudhën e rilindjes e vijon edhe sot në një stad më të avancuar, është Kolegji “Qiriazi”, tashmë universitar.

Duke kujtuar përvjetorin e parë...

Në maj të vitit 1931, Instituti Femëror Kyrias (Qiriazi), përkujtoi 40 vjetorin e themelimit. Vajzat Kyrias dhe Kristo Dako, atë ditë ishin kryefjala e Shqipërisë. Ngjarja më e shënuar e kohës – cilësohej nga shtypi. Në kronikat e atyre ditëve lexojmë: Të dielën më 24 maj, ora 3.30 pas dreke, me një bukuri të jashtëzakonshme, filloi në Kambëzë kremtimi i 40 vjetorit të Institutit Kyrias. Kremtimi mbajti deri në orën 7.30 dhe u zhvillua me një mënyrë madhështore, ashtu si i ka hije kësaj vatre të gjallë kombëtare shqiptare. Një shumicë e madhe populli, afër 800 personash, nga ma të zgjedhurit e kryeqytetit, rodhi posi mbletë që të ndodhet prezent në këtë kremtim. Kishte edhe prindër, edhe kujdestar të nxansave të ardhur nga qytetet e tjera të vendit. Të gjithë kaluan një pasdreke të tërë në këtë institut të bukur që ka zanë vend në një nga kodrat ma të hijshme të qarkut të Tiranës... Në këtë kremtim të 40 vjetorit, mori pjesë kryeministri Pandeli Evangjeli, kryetari i parlamentit Koço Kotta, kryetari i Këshillit të Shtetit Mehdi Frashëri. Ministrat: Hilë Mosi, Musa Juka. Hysein Vroni, Milto Tutulani. Nga udhëheqësit e vendit mungonte vetëm NM e Tij Mbreti Zog, por ishin prezent oborrtarët: Gjeneral De Ghiraldi e Sotir Martini, Major Osman Gazepi dhe Allaman Çupi. Ministrat e akredituar në vendin tonë: të Italisë, SHBA, Çekosllovakisë, Bullgarisë, Turqisë, Greqisë etj. Përfaqësuesë të organizatave e shoqërive të ndryshme, deputetë, oficerë, profesorë etj. Në platformën e pritjes qëndronin themeluesit e Institutit: zonja Dako, z-sha Kyrias dhe zoti Dako. Programi i asaj dite ishte i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë ishin përshëndetjet dhe fjalimet e organizatorëve dhe të të ftuarve. U lexua edhe përshëndetja e Mbretit Zog, që i dërgonte Institutit të Vajzave. Sevasti Dako e filloi kështu fjalën e saj: “Institutit “KYRIAZ”, që qëndron mbi këtë kodër të bukur e vazhdon në heshtje e në qetësi, veprën e tij dobiprurëse për hir të atdheut, derisa të mbërrijë këtu, i është dashur të bëjë një rrugë të gjatë e të vështirë. Përfyty-



Z. Talat Xhaferrri,
Kryetari i Paralamentit të
Maqedonisë së Veriut

rojeni jetën e tij, si një vajzë e re, së cilës iu desh ta rrahin dallgët e një deti me furtunë e që vetëm me një vullnet dhe ideal të shenjtë, mund të dilte faqebardhë. Dhe mendojeni, se kësaj vajze, një njeri fytyrë-engjëlli, me flakën e së vërtetës e dritën e dijes në dorë, i tha: “Mundime e rreziqe shumë të mëdha ke për të parë, po armët e diturisë do të të nxjerrin faqebardhë, prandaj ec përpara e mos u tremb, as mos u tut, sepse, po të përmbushësh qëllimin që ndjek, mundimet e tua do të kurorëzohen me kënaqësinë e ndërgjegjes sate....!”, (Ky fytyrë-engjell ishte Naim Frashëri). Pjesa e dytë e kremtimeve, ishte mrekullia që dinin të bënë vajzat. U luajt pjesa teatrale “Foleja Kombëtare”, ku në një vepër dramatike të shkruar nga Parashqevi Qiriazi, paraqitej e gjithë jeta e Institutit, me përpjekjet, vuajtjet e me ndjekjet e shumta, duke dalë në skenë të gjitha personazhet që kishin kontribuar, por edhe që kishin penguar shkollën. Të gjitha ro-





Zj. Albana Tole,
Zv. Ministre e Arsimit dhe Sportit

let, edhe ato mashkullore, luheshin nga vajzat: Amalia Koljaka, Viki Thoma, Ksanthipi Dilo, Azizë Mborja, Marie Shala, Hilmije Zaimi, Makbule Beshiri etj, etj, ishin vajzat që luanin rolet e Sevasti Dakos, Naim Frashërit, Gjerasim Qiriazit, Sulltan Hamitit, Mati Logorecit etj.

Përvjetori i Artë...

Organizatorët e kremtimit të 100 vjetorit të rihapjes së Institutit Kyrias në Tiranë, zgjodhën vetëm këto dy fjalë, për të thënë gjithçka rreth këtij institucioni, në vend të mijëra fjalëve që mund të thuheshin për këtë përvjetor. Jo për të glorifikuar, por për të treguar moshën fisnike, rritjen intelektuale dhe akademike që arrin një institucion arsimor kur i dalin thinjat. Kanë kaluar 90 vjet nga kremtimi i përvjetorit të parë. Është e njëjta godinë, janë të njëjtat

koordinata që të shpien aty, te ajo kodër e bukur e veshur me pyll shumësorë drurësh dhe e mbushur me shpend gjithëfarësh. Është e njëjta rrugë që të shpie nga Tirana në Kamëz, por tashmë më e sistemuar dhe e zgjeruar. Është e njëjta urë, që u ndërtua disa vite më vonë se sa të hapej instituti. Madje, për hirë të së vërtetës, duhet thënë se, edhe sot kjo urë quhet “Ura e Institutit”. Pavarësisht se brezi i sotëm apo edhe i djeshëm, nuk e lidhin emrin e urës me institutin Qiriaz, ky emër ka mbetur qysh në kohën e Dakos, kur Instituti Femëror Qiriaz, i bënte kërkesë qeverisë së kohës për të ndërtuar urën mbi lumin që rrethonte Kodrën e Kamzës dhe pengonte lidhjen e shkollës me qytetin e Tiranës. Edhe pse disa qindra metra larg vendndodhjes së institutit, ky emër i vendosur qysh atëhere, tregonte se kjo urë u ndërtua, së pari për institutin.

Në krye të 90 viteve, natyrisht që ndryshojnë vetëm njerëzit: pritisit dhe miqtë; prindër të studentëve; studentët që tashmë nuk janë vetëm vajza, por vajza dhe djem. Ata janë në festë: ndihen krenar se Kolegji ku po studiojnë, po feston një përvjetor me moshën 100 vjeçare. Tashmë kanë lexuar për historikun e këtij institucioni. E dinë se kjo godinë ku kanë auditoret, laboratorët dhe ambiente të tjera studimi, çlodhëse dhe argëtuese, ka një histori të vlerësuar.

Prof. Dr. Gjokë Uldedaj dhe Prof. Dr. Maksim Meço, përkatësisht presidenti dhe rektori i Kolegjit Universitar Qiriaz, janë në pritje të vizitorëve, të cilët kanë filluar të vijnë shumë më herët se sa ora kur do të fillojnë ceremonia. “Vizitori i nderit” – mund ta quajmë, edhe pse vjen nga larg, mbërrin i pari. Ai është kryetari i parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi. Nga qeveria shqiptare ka ardhur një zyrtarë e lartë e ministrisë së arsimit. Kryeministri ka njoftuar se nuk ndodhet në Shqipëri, por ka gjetur mënyrën për të përshëndetur. Kanë mbërritur rektorë e ish rektorë të universiteteve të ndryshme: Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës; Prof. Dr. Et’hem Ruka, rektor i Universitetit Luarasi; Prof. Dr. Selami Xhepa, rektor i Universitetit European të Tiranës; Prof. Dr. Lufter Xhuveli, ish rektor i Universitetit Bujqësor, ish



deputet e ish ministër; Prof. Dr. Hamit Boriçi, ish zv/rektor i Albanian University, Prof. Dr. Myqerem Tafaj, ish ministër arsimit etj. Në sallë ishin shumë akademikë. Në listën e të ftuarvë kishte deputetë, biznesmenë të njohur, drejtues mediash etj. Pas një vizite në stendat e muzeut, bashkëpunim i Kolegjit Universitar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, të ftuarit e festës zenë vend në sallë për të ndjekur, dokumentarin “Përvjetori i Artë”, prodhim i tv. shqiptar me producent gazetarin Tomë Therçaj dhe me skenar të Gjovalin Gjeloshit. 130 vite histori vijnë në 30 minuta film. Ky realizim fillon me atmosferën që krijon muzika e këngës së alfabetit, me tekst të Parashqevi Qiriazit dhe vijon me të intervistuarit e këtij dokumentari që janë figura nga më të shquarat të shkencës dhe arsimit shqiptar: Frashër Demaj, Shaban Sinani, Nevila Nika, Valentina Duka, Myqerem Tafaj, Et’hem Ruka, Genc Pollo, ambasadori Mal Berishaj etj, për të ardhur te një figurë e spikatur politike e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, kryetari i parlamentit maqedonas, Talat Xhaferi. Përvjetori i vazhdimësisë, e quajti Gjokë Uldedaj në fjalën e mirëseardhjes, këtë kremtim, - duke u kujtuar pjesëmarrësve, se 90 vjet

më parë, në këtë godinë madhështore, madje në këtë sallë që jemi edhe sot, themeluesit e këtij institucioni, ikonat e arsimit tonë kombëtar, Sevasti e Parashqevi Qiriaz dhe Kristo Dako, në prani të një auditori të tejmbushur cilësisht, përkujtuam 40 vjetorin e Institutit Femëror. Një shkollë me një traditë të spikatur, me drejtim perëndimor dhe me sytë nga përvoja e arsimit në SHBA. Në vazhdim të traditës së krijuar, vijoi më tej Uldedaj, Kolegji Universitar “Qiriaz”, do të ketë në themel të strategjisë së tij, jo vetëm cilësinë akademike, kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive, por edhe forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me Institucionet me prestigjioze të vendit, me Universitetet dhe Kolegjet e vendeve Perëndimore, me qëllim ndërkombëtarizimin e institucionit, për të përgatitur të diplomuar që të jenë të aftë të konkurojnë në tregun e punës intelektuale brenda dhe jashtë vendit. Synimi ynë është krijimi i një institucioni elitari në arsimin e lartë, duke ju përmbajtur edhe në vazhdimësi modelit evropian të qeverisjes universitare, bazuar në lirinë akademike dhe në autonominë administrative. Kam besim të plotë se investimi i kryer deri



Prof. Dr. Hamit Boriçi



Prof. Dr. Ak. Gjovalin Shkurtaç

tani nga ana jonë dhe që do të vazhdojë edhe në të ardhmen, i ka dhënë vlera dhe dimensione të reja këtij Universiteti, duke krijuar një infrastrukturë me ambjente bashkëkohore, me kabinete dhe laboratore të krahasueshme me universitetet më të mira. Kjo do t'i pasurojë më tej vlerat që trashëgoi kjo shkollë – përfundoi profesor Uldeadaj.

Për Talat Xhaferin, Manastiri, ku hodhën shtat motrat Qiriazi, në përbërje të kësaj familje të famshme, është zemra e shqiptarisë për gjuhësinë. Kongresi i Manastirit, një organizim së pari i familjes Qiriazi, vendosi një herë e përgjithmonë me e nda Shqipërinë nga e kaluara 500 vjeçare, në çështjen më të ndjeshme dhe në veçorinë kryesore që na dallon ne si komb: gjuhën e shkruar. Në gjuhën e shkruar me germa latine, as cirilike, as arabe dhe as greke.

Zëvendësministrja e arsimit dhe sporteve Albana Tole, e cilësoi Kolegjin Universitar “Qiriazi”, si një ndër institucionet e arsimit të lartë, që jep kontribut në arsimimin e brezit të ri, duke e veçuar kryesisht për programet profesionale që ka të akredituara, duke synuar që të jetë në të njëjtën gjatësi vale me tregun e punës, por edhe për emrin e mirë që kanë

fituar fakultetet e Ekonomikut dhe Drejtësisë. Vlerësoi përpjekjet e univeritetit për ndërkom-bëtarizimin e tij, duke përmendur marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit që ka me universitetet e rajonit dhe Europës.

Pas dokumentarit, “prodhimi” i dytë historik, që evokon historinë e Kolegjit Femëror Qiriazi, të ardhur deri në Kolegj Universitar në ditët e sotme, është botimi i librit “Mosha e artë e një universiteti”, me autor Gjovalin Gjeloshi. Librin e paraqiti para auditorit Prof. Dr. Akademik Gjovalin Shkurtaç.

Libri ka tematikë e parashtrim që rreket të tregojë e të dëshmojë, tha akademiku Shkurtaç, por edhe të përcaktojë vendin që i takon një institucioni të rëndësishëm arsimor si “Shkolla shqipe e vashave”, prandaj, nderi e kënaqësia e të qenit paraqitës e vlerësues, terratisen e zbehen dhe zotëruese bëhen ndjenja e përgjegjësisë dhe droja se mos nuk ia del t'i parashtrosh, t'i tumirosh e t'i përthekosh të gjitha ato prurje që ka sjellë autori nga hulumtimet, kundrimet e qëmtimet e tij, mesa duket të kryera për një kohë bukur të gjatë, jo vetëm në biblioteka, po edhe në arkivin e shtetit e në arkivat vetjake të Qiriazëve, Dakove etj. Kemi në dorë një libër që jo vetëm rrëfen e pohon, po edhe që ju vë

në mendime, që na fton të gjykojmë me mendje të kthjellët për të gjitha bëmat, të mira e të vështira, për të gjitha ato vepra e veprimtari të së shkuarës, në fushën e arsimit e të arsimimit, duke nxjerrë në pah sidomos kahun e mbarë të përpjekjeve për shkollimin e grave shqiptare e ku, natyrisht, vihet në dukje roli i pavidrë i motrave e vëllezërve Qiriazi si dhe i Kristo Dakos. Në pjesën e fundit të librit, ashtu sikundër pritej, autori përshkruan “rikthimin në identitet”, duke bërë një paraqitje relativisht të gjerë e të plotë në sythas “Shkolla e Lartë Universitare “Sevasti e Parashqevi Qiriazi” dhe “Kolegji Universitar “Qiriazi”, ku, si të themi, me një “Happy End” (Fund të gëzueshëm) jepet një përmbledhje e gjendjes dhe pritshmërive të kësaj shkolle të lartë, në të cilën, lavdia e së shkruarës shërben si bazë e synim për mbërritje të një formimi universitar bashkëkohor të studentëve, një shkollë e lartë që kombinon mësimdhënien me veprimtarinë dhe kërkimin shkencor dhe, qysh nga viti 2006, ofron studime në 6 programe, përkatësisht në Drejtësi dhe Ekonomi, duke arritur në 13 programe në ditët tona. Me të drejtë u është bërë vend në libër, rolit dhe kontributit të dhënë nga “Babë e bir”: Aleksandër dhe Robert Dako, të cilëve u takon nderimi dhe vlerësimi për qëndresën dhe ndihmesën e tyre për ta mbajtur e mbrojtur atë institucion, si dhe i Prof. Dr. Gjokë Uldeadaj, të cilin autori e konsideron si personazhin që luajti rolin kryesor në aktin e fundit të dramës “Shpëtimi i Institutit Kyrias”. Kremtimet vijuan me dhënien e titujve dhe medaljeve. Titulli “Doktor Honoris Causa” u dha për z. Aleksandër Dako, djali i Sevasti dhe Kristo Dakos, me motivacion: Për kontributin e Tij, si pasardhës i familjes “Dako-Qiriazi”, për të evidentuar dhe ndriçuar me dokumente autentike, veprat e ikonave të arsimit tonë kombëtar Sevasti e Parashqevi Qiriazi dhe Kristo Dako. Për angazhimin dhe përkushtimin e Tij, për rikthimin e pronave të shtetëzuara nga regjimi komunist, në pronësi të trashëgimtarëve të ligjshëm të familjes “Dako-Qiriazi”. Nismëtar i kthimit në identitet të Institutit “Qiriazi”.

Medalja “Mirënjohja e Përvjetorit të Artë”, me vendim të Senatit Akademik të

Kolegjit Universitar Qiriazi, u dha për Prof. Dr. Abdyl Sinani, Drejtor i Kolegjit Profesional të Lartë. Me motivacion: “Personaliteti i shquar në hapsirën mbarëkombëtare shqiptare, në industrinë dhe teknologjinë ushqimore. Drejtues mendjehapur i Kolegjit Profesional të Lartë, një model për t'u ndjekur në mësimdhënie bashkëkohore, në veprimtari botuese dhe kërkimore-shkencore. Për punën me studentët në projekte konkrete në fushën e teknologjisë ushqimore në një laborator modern të krijuar me shumë dashuri dhe që mban emrin e Tij”. Prof. Dr. Halit Xhafa, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, me motivacionin: “Në vlerësim të punës dhe kontributeve të çmuara shkencore dhe publike në fushën e financës dhe menaxhimit financiar. Personaliteti i shquar akademik në mësimdhënie, në veprimtari botuese dhe punë kërkimore-shkencore. Kolegji Universitar “Qiriazi” është mirënjohës për punën e Tij, në drejtim të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe punës së Tij drejtuese në këtë Institucion. Prof. Dr. Vejsel Rizvanolli, Dekan i Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit, me motivacionin: “Për kontribut të shquar në riorganizimin dhe transformimin e sistemit të arsimit të lartë në fushën e edukimit fizik dhe sporteve në Shqipëri. Me një karrierë të shkëlqyer botuese dhe kërkimore -shkencore me angazhime dhe kontribute të spikatura si sportist dhe si Rektor i Universitetit të Sportit. Ka dhënë një ndihmë të çmuar si drejtues, në zhvillimin e programit të studimit “Edukim Fizik dhe Sporte” në Kolegjin Universitar “Qiriazi”.

Medalja “Mirënjohja e Përvjetorit të Artë”, u akordua edhe për Prof. Dr. Palokë Kolnikaj, ish drejtues i institucionit të arsimit të lartë dhe një bashkëpunëtor i Kolegjit Qiriazi, “Për kontribut të veçantë në transformimin e sistemit bankar në Shqipëri në rrugën e ekonomisë së tregut, për profesionalizmin, devotshmërinë dhe humanizmin e treguar në funksionet drejtuese që i janë ngarkuar si dhe për ndihmesën e dhënë në zhvillimin institucional të Kolegjit Universitar “Qiriazi”. Ndërsa për Rakip Sulin, kryetarin e bashkisë Kamëz, një prej institucioneve të qeverisjes vendore që ka bashkëpunuar ngushtësisht me Kolegjin

Qiriaz, medalja në fjalë u dha “Në vlerësim të kontributit të veçantë dhe gadishmërisë së treguar për ndërtimin e urave të qëndrueshme të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Kolegjit Universitar “Qiriaz”, në drejtim të punësimit dhe aktiviteteve të përbashkëta kulturore e sportive. Për kontributin e spikatur, vizionin dhe përkushtimin e Tij, për zhvillimin e infrastrukturës mësimore, kulturore e sportive për nxënësit dhe të rinjt, në territorin e bashkisë ku ai drejton”.

Pjesa e dytë e kremtimeve vijoi me “Simposiumin historik”, kushtuar 131 vjetorit të themelimit të Institutit Qiriaz në Korçë dhe 100 vjetorit të rihapjes në Tiranë. Prof. Dr. Valentina Duka kishte përgatitur kumtesën “Roli i motrave “Qiriaz” në emancipimin e femrës shqiptare. Prof. Dr. Akademik Shaban Sinani, “Roli i Qiriazëve në Kongresin e Dytë të Manastirit”. Prof. Dr. Nevila Nika “Kontributi i Institutit Qiriaz në fushën e

arsimit kombëtar”. Prof. Dr. Petro Luarasi “Aspekte të bashkëpunimit të familjeve “Qiriaz” e “Luarasi” në interes të çështjes kombëtare”. Gjithashtu referate e kumtesa mbajtën edhe nga Zana Shehu, Prof. Dr. Skënder Asani, Rozi Dako me Robert Dakon, Prof. Dr. Hivzi Muharremi, Bujar Ago etj.

Kjo seancë, si me “qershia mbi tortë”, u mbyll me një diskutante të paplanifikuar: vajza e Lasgush Poradecit, Marie Gusho, u ngjit në podium dhe recitoi vjershën e të atit, “Lavdurim”, kushtuar motrës së madhe, siç e quan Lasgushi, Sevasti Qiriazin, Dako.

Një koktejl dhe një koncert artistik, që do ta konsideroja si pjesë të tretë, të përgatitura nga vetë studentët e Kolegjit Universitar “Qiriaz”, mbyllën veprimtaritë e kësaj dite të shënuar, në pritje të përvjetorit të radhës, që natyrisht (Ruajna Zot prej të marrëve), nuk do të presë më 90 vjet.

I lindur, i ndërkombëtarizuar

*PhD. Viliem Kurtulaj
Zyra e Marrëdhënieve
Ndërkombëtare
dhe Menaxhimit të Projekteve
në Kolegjin Universitar Qiriaz*

Që prej themelimit në vitin 1891 në Korçë, Kolegji Universitar Qiriaz, atëkohë “Instituti Kyrias” ose, siç njihej ndryshe, Shkolla e Vashave, lindi si një krijesë e vogël, por me vullnet dhe dashuri të madhe, të cilat e bënë këtë institucion arsimor të shënjohej në historinë e arsimit shqiptar si një gur i rëndësishëm themeli. Edhe pse me qëllime dhe objektiva të forta kombëtare si luftimi i analfabetizmi, emancipimi, zgjimi kombëtar, etj. botëkuptimi i institucionit ishte ndërkombëtar që në krye të herës. Me hapjen e këtij instituti, Sevasti Qiriaz po sillte përvojën e saj studimore nga Kolegji Amerikan i Stambollit ku kishte kryer studimet. Shkolla e Vashave u krijua edhe duke marrë si model shkollat e vajzave të vendeve të tjera në të cilat kishte kontribuar kryesisht Bordi Amerikan. Institucione dhe individë nga vende të ndryshme dhanë kontributin e tyre për vazhdimësinë e kësaj shkolle fillimisht në Korçë e më pas, në Tiranë. Diaspora shqiptare e kohës, misione të vendeve të ndryshme, “Shoqëria Biblike e Ndihmës”, “Shkolla e së Dielës për Fëmijët e Bebekut”, “Bordi i Grave të Misioneve të Brendshme”, etj. janë disa nga kontribuesit kryesorë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e këtij institucioni arsimor. Veçanërisht, miqtë amerikane kanë qenë ndër vite mbështetësit kryesorë të cilët kanë kontribuar në mënyrë të vazhdueshme për këtë institucion. Vlen të përmendet se kontributi i tyre ka pasur si qëllim përhapjen dhe zhvillimin e arsimit shqiptar duke pasur si referencë shkollat amerikane.



Megjithatë, miku më i madh i institucionit arsimor "Qiriazit" mbetet Charles R. Crane, një amerikan nga Çikago. Mbështetja e Crane për fuqizimin e Shkollës së Vashave ishte i paçmuar për kohën. Kontributi i Charles R. Crane, por edhe i miqve të tjerë, kryesisht amerikanë, ishte aq domethënës saqë Sevasti Qiriazit-Dako shprehej, se i detyrohej Amerikës një borxh të madh.

Edhe sot, pas më shumë se 130 vitesh nga themelimi i Shkollës së Vashave në Korçë, dhe më shumë e një shekull nga rihapja e këtij institucioni në Tiranë më 1922, Kolegji Universitar Qiriazit vazhdon ta ruajë me fanatizëm misionin e vet arsimor dhe frymën ndërkombëtare që e ka karakterizuar që prej themelimit. I rivitalizuar në një institucion arsimor bashkëkohor, duke patur si udhërrëfyes kolegjet dhe universitetet më të mira amerikane dhe evropiane, Kolegji Universitar Qiriazit vazhdon t'iu shërbejë studentëve me cilësi të lartë akademike dhe profesionale. Qasja ndërkombëtare e universitetit vazhdon të ketë një rol thelbësor në orientimin dhe funksionimin e universitetit. Në fakt, kjo frymë nuk ka munguar asnjëherë te "Qiriazit" por, me zhvillimet e dekadave të fundit, ku globalizmi po bëhet gjithnjë dhe më i prekshëm, ndërkombëtarizimi i institucioneve të arsimit të lartë është bërë një kusht i pashmangshëm për zhvillimin e institucionit.

Në këtë kuadër, Kolegji Universitar Qiriazit po punon në disa drejtime njëkohësisht. Programet dhe kurrikulat e studimit në gjuhën angleze janë një nga fushat në të cilat po punohet. Literatura akademike dhe shkencore bashkëkohore; përthithja e studentëve të huaj; afrimi i lektorëve ndërkombëtarë; shkëmbimet ndërkombëtare të studentëve, pedagogëve, dhe stafeve administrative; etj. e bëjnë të domosdoshme implementimin e gjuhës angleze në mësimdhënie dhe kërkim shkencor në universitet. Gjithashtu, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Menaxhimit të Projekteve në Kolegjin Universitar Qiriazit ka arritur tashmë disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete në rajon, Evropë dhe më tej, dhe është gjithmonë në kërkim të partnerëve të rinj, sa më cilësor dhe me përvojë. Deri më tani, Kolegji Universitar Qiriazit ka pasur marrëveshje

bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë nga Austria, Gjermania, Italia, Kroacia, Azerbajxhani, Kosova, Maqedonia e Veriut, etj. Por partneriteti nuk ka qenë vetëm me universitete por edhe me akademi dhe agjenci punësimi të cilat i mundësojnë studentëve të "Qiriazit" të kryejnë praktikat e tyre mësimore, si dhe të punësohen, në vende të BE-së si p.sh. në Gjermani, Itali, etj. Bashkëpunimi në fushën e inovacionit dhe teknologjisë, dhe programet studimore të përbashkëta me universitete të shquara në Evropë janë gjithashtu drejtime të rëndësishme në të cilat Kolegji Universitar Qiriazit është fokusuar.

Projektet ndërkombëtare janë një tjetër fushë në të cilën është i përfshirë Kolegji Universitar Qiriazit. Programe të Bashkimit Evropian si Erasmus+, Horizon Europe, Jean Monnet, etj. janë disa nga kanalet ku është përqendruar puna e institucionit. Gjithashtu, Kolegji Universitar Qiriazit ka marrëdhënie të shkëlqyera me shumë partnerë ndërkombëtarë në vend siç janë ambasadat e vendeve mike dhe organizatat ndërkombëtare. Marrëdhënia e fortë dhe e qëndrueshme me këto institucione, dhe bashkëpunimi me ta, i ka dhënë universitetit një dimension edhe më ndërkombëtar.

Gjithsesi, pavarësisht frymës ndërkombëtare, kontributit ndërkombëtar në themelimin dhe mbarëvajtjen e "Qiriazit", marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve me institucioneve, universitete, akademi, dhe kompani nga vende të ndryshme të botës, Kolegji Universitar Qiriazit ka qenë gjithnjë një institucion arsimor shqiptar me kontribut në shoqërinë shqiptare. Megjithatë, në kuadër të zhvillimeve të fundit në fushën e arsimit të lartë në botë, tashmë është koha që ky institucion arsimor ta zgjerojë kontributin dhe aktivitetin e tij përtej kufijve kombëtarë nëpërmjet projekteve ndërkombëtare, kërkimit shkencor, afrimit të studentëve dhe lektorëve ndërkombëtarë, programeve të përbashkëta studimore, konferencave dhe simpoziumeve ndërkombëtare, etj. Kolegji Universitar Qiriazit, si institucioni i arsimit të lartë më i vjetër në vend, ka detyrimin dhe përgjegjësinë të jetë një nga udhëheqësit në zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë shqiptar.

Kryetari Xhaferi, pranues i titullit "Doctor Honoris Causa"

-Sipas faqes se web-it, të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut-



Sot në Tiranë, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, mori pjesë në shënimin e "Përvjetorit të artë" të Kolegjit Universitar "Qiriazit" me ftesë të Kryetarit dhe Rektorit të Kolegjit Universitar a pas vendimit të Senatit të tyre Akademik t'ia ndajë atij titullin më të lartë akademik, gjegjësisht titullin "Doctor honoris causa". Në shënim ishin të pranishme fytyra të shquara të botës akademike. Ky titull, siç shkruan në arsyetimin e vendimit, i ndahet Kryetarit Xhaferi për "kontributin e Tij të veçantë për zyrtarizimin e gjuhës shqipe, për lirinë dhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, për mençurinë dhe vlerat e larta intelektuale dhe shtet formuese në mbrojtje të identitetit kombëtar, për lidhjet e Tij shpirtërore me ikonat e arsimit kombëtar Sevasti dhe Parashqevi Qiriazit dhe Kristi Dako, që janë trashëgimi historike dhe vazhdimësi e Kolegjit Universitar "Qiriazit".

Kryetari Xhaferi, në fjalën e tij të rastit për të

shprehur falënderim u shpreh si vijon: "Është emocion i veçantë, është nder i veçantë që gjithë jeta të kurorëzohet me një çmim, me një mirënjohje që është kjo sot nga Kolegji Universitar "Qiriazit". Është njohje për gjithë atë plejadë të njerëzve që kanë bërë me përkushtim përpjekjet për ruajtjen, ngritjen dhe sendërtimin e statusit tonë, qoftë politik, qoftë shoqëror, në viset ku ne jetojmë jashtë hapësirës së Republikës së Shqipërisë dhe, s'do mend që ky çmim, fillimisht u dedikohet të gjithë atyre bashkudhëtuesve të mi me të cilët bashkë kemi bashkëvepruar për të arritur aty ku jemi sot, për të mund të vazhduar më tutje drejt sfidave që gjenden para nesh..."

Natyrisht se Kryetari shprehu falënderim të veçantë edhe për familjen e tij të ngushtë që është përkrahja e tij më e madhe.

Në suazat e shënimit u mbajt e dhe simpozium historik për nder të 131 vjetorit të themelimit të institutit Qiriazit dhe 100 vjetorit të rihapjes në Tiranë.

“Arsimi-një mjet i fuqishëm për përparimin e komunitetit”

Prof. Dr. Gordana Nikoliç, dekane e Kolegjit Universitar PAR, Kroaci, firmos marrëveshjen e bashkëpunimit me Kolegjin Universitar Qiriaz



Gordana Nikoliç

Partneri më i ri i Kolegjit Universitar “Qiriaz” është Kolegji Universitar PAR, në Rijeka të Kroacisë. Është institucioni i parë dhe i vetëm privat i arsimit të lartë në qarkun e Primorjes – Gorski Kotar. Ai është themeluar në vitin 2011 dhe që nga viti 2012 ka një program bachelor në Menaxhim Biznesi, me qëllim edukimin e të rinjve me orientim drejt sipërmarrjes, një program që “Qiriaz” po e synon. Një institucion arsimor model dhe i manovrueshëm. Një numër jo i madh studentësh, por edhe me kuota të limituara me synime për cilësi të lartë. Që nga viti 2020 zhvillon edhe një program master në Menaxhim Biznesi. Nuk ka hallka të tepërta drejtuese dhe personel akademik të rënduar, gjë të cilën e favorizon edhe ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Kroacisë. Me synimin për t’u bërë qendër arsimore ndërkombëtare lider në rajon, PAR kombinon mirë drejtimin akademik me tregun e punës dhe arsimin inovativ. Ky kolegji synon realizimin e marrëdhënieve më të mira mes sistemit arsimor dhe subjekteve ekonomike; pjesëmarrjen e vet aktive në zhvillimin e shoqërisë; përgatitje më të mirë të të rinjve për tregun e punës apo edhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme, duke parandaluar largimin e fuqisë punëtore nga vendi.

Me ndërmjetësimin e deputetes shqiptare të pakicave kombëtare, në parlamentin kroat, zonja Ermina Lekaj (Prlaskaj), në mjediset e Kolegjit Universitar Qiriaz, u realizua firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy universiteteve. Marrëveshja u firmos nga Prof. Dr. Gjokë Uldedaj, president i Kolegjit Universitar Qiriaz dhe Prof. Dr. Gordana Nikoliç, dekane e kolegjit PAR.

Zoti Uldedaj e vlerësoi marrëveshjen si një rrugë të domosdoshme për të ecur të sigurt në ndërkombëtarizimin e institucionit të arsimit të lartë, kemi synuar për të patur një institucion të hapur, tha ai. Gjatë këtij udhëtimi kemi nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi në Evropë e më gjerë. Këto marrëveshje janë kthyer në projekte konkrete shkëmbimi, për ngritjen e kapaciteteve, për trajnime e kualifikime të vazhdueshme. Marrëveshjen me Kolegjin universitar PAR, e konsiderojmë një ndër më të rëndësishmet, për vet natyrën dhe misionin që ka ky universitet.

Ndërsa zonja Nikoliç u shpreh: Ishte një kënaqësi e madhe për Universitetin e Shkencave të Aplikuara PAR për të nisur një partneritet me institucionin tuaj të nderuar në 100 vjetorin e themelimit tuaj. Si rektore e këtij universiteti, jam e emocionuar për këtë aleancë të re, e cila padyshim do të jetë një aset në ndjekjen tonë të vazhdueshme të përsosmërisë akademike.

Arsimi është një nga mjetet më të fuqishme që kemi për të nxitur rritjen dhe përparimin në komunitetet tona. Njëpërmjet edukimit, ne mund të frymëzojmë gjeneratën e ardhshme të liderëve, novatorëve dhe zgjidhësve të problemeve që do të formësojnë të ardhmen e shoqërisë sonë. Kjo është arsyeja pse partneritetet midis universiteteve janë kaq jetike, pasi ato na lejojnë të ndajmë njohuritë dhe ekspertizën dhe t’u ofrojmë studentëve tanë një përvojë të vërtetë të të mësuarit ndërkombëtar. Jam pozitiv që bashkëpunimi ynë do të kontribuojë në edukimin e ekspertëve të ardhshëm në fushat e studimit që ofrojnë universitetet tona.

Ne presim me padurim mundësitë e shumta emocionuese që na presin. Ju ftoj të bashkoheni me mua në festimin e këtij kapitulli të ri emocionues në historinë e universiteteve tona dhe të mbështesni përpjekjet tona për të promovuar arsimin dhe bashkëpunimin përtej kufijve partneritetet midis universiteteve janë kaq jetike, pasi ato na lejojnë të ndajmë njohuritë dhe ekspertizën dhe t’u ofrojmë studentëve tanë një përvojë të vërtetë të të mësuarit ndërkombëtar. Jam pozitiv që bashkëpunimi ynë do të kontribuojë në edukimin e ekspertëve të ardhshëm në fushat e studimit që ofrojnë universitetet tona.

Medalja: “Mirënjohja e Përvjetorit të Artë” i jepet

Zonjës Ermina Lekaj (Prljaskaj),

Anëtare e Parlamentit të Kroacisë.

Me këtë motivacion:

Për kontributin e çmuar në përkrahjen dhe promovimin e vlerave gjithëpërfshirëse mbarëshqiptare në Kroaci. Për përfaqësimin dinjitoz në nivelet më të larta të politikës si deputetja e parë shqiptare në parlamentin e Kroacisë, duke përfaqësuar jo vetëm pakicat shqiptare, por edhe pakicat e tjera. Për kontributin real në krijimin e lidhjeve të qëndrueshme ndërmjet “Kolegjit Universitar Qiriaz” dhe universiteteve kroate.




Shkollat amerikane të vajzave në ish Perandorinë Turke

Dr. Gjovalin Gjeloşi

Sipas librit “Duke lënë

Levantin” të Jozef Greene



Kolegji i grave në Konstandinopojë

Hapja e shkollës së vajzave në Korçë, në fillim të dekadës së fundit të shek. 19-të, përkon me periudhën më të vrullshme të misioneve amerikane, të cilat kontribuan në formimin e zgjerimin e rrjetit arsimor të femrave në ish Perandorinë Osmane. Por në dallim prej të gjitha shkollave të kësaj periudhe, vetëm Shkolla e Vashave e Korçës, u jetësua nga mësuesë shqiptar, siç qenë Gjerasim Qiriazi me motren e tij, Sevastinë. Në të gjitha shkollat e tjera, themelues qenë misionarët amerikanë, burra, por kryesisht gra e vajza, të cilat me një vullnet të pashoq, punuan pa u kursyer për arsimimin e femrave në këtë pjesë të Lindjes.

Më poshtë do të paraqesim një panoramë të shkurtuar të rrjetit të këtyre shkollave, bazuar në librin “Duke lënë Levantin”, një libër i shkruar mbi Turqinë, ku ne gjejmë produktin e një mendjeje mjeshtërore, të gërshetuar nga më shumë se gjysëm shekulli jetë brenda vetë vendit. Dr. Greene jo vetëm që jetoi brenda Turqisë, gjatë asaj periudhe më kritike dhe revolucionare të historisë së saj moderne, por ai vetë ishte një faktor i rëndësishëm në atë histori. Ai banonte në vende të ndryshme, fliste gjuhën e popullit, ishte mik dhe i afërt i liderëve të racave historike që përbënin Turqinë (shpesh herë kundërshtarë), vëzhgonte në dorë të parë transformimet e popujve dhe merrte frymëzim te atmosfera që kishte Lindja. Fillojë të gërshetojë me të renë, elementet që kishin filluar të futeshin në shoqërinë turke dhe ishte në gjendje t'i interpretonte ato ndryshime në terma perëndimor.

Qëllimi im, thotë ai, nuk është të shkruaj një histori të punës së Bordit Amerikan në Turqi, por të parashtoj qëllimin e tij në dërgimin e misioneve në atë vend dhe të tregoj agjencitë dhe metodat që janë përdorur, për të çuar përpara punët, me skicimet e disa prej personazheve kryesore. “Lavdërimi është i Zotit, për sukseset e mëdha që kanë pasur veprimtaritë e 95 viteve të fundit” – e mbyll realizimin e objektivit, ai.

Përveç ndihmës në organizimin e shkollave amëtare për djem, misionet e hershme amerikane u përpoqën më së shumti të krijonin shkolla të veçanta për vajza. Sipas Jozef Greene, në maj të vitit 1832, një çift, Mr. dhe Mrs Goodell, ftuan familjet greke me të cilat ishin njohur në Kostandinopojë, të dërgonin vajzat e tyre në një shkollë ditore të cilën e kishin hapur në shtëpinë e tyre. Njerëzit me kënaqësi iu përgjigjën ftesës dhe në pak ditë ata kishin në shkollën e tyre të improvizuar, 25 nxënës. Por nga ana tjetër, shkolla për vajzat ishte një risi e tillë sa që zgjoi nga gjumi kishtarët konservatorë grekë dhe brenda katër muajve, Sinodi grek urdhëroi prindërit, nën kërcënimin e shkishërimit, që të tërhiqnin vajzat e tyre nga shkolla. Kështu përfundoi përpjekja e parë për të krijuar një shkollë për vajzat.

Pas 13 viteve u bë një përpjekje e dytë. Në tetor të vitit 1845, një shkollë për vajza me konvikt u hap në shtëpinë e po të njëjtëve persona, Goodell. Në këtë kohë, në Konstadinopojë dhe rrethina kishte shumë familje, prindërit e të cilave ishin të lumtur që i dërgonin vajzat e tyre në një shkollë me konvikt. Kjo shkollë vazhdoi me sukses, pasi erdhën edhe mësues të tjerë nga SHBA, deri në vitin 1862, kur u mbyll. Sidoqoftë shkolla kishte përgatitur gra të shkolluara për pastore të seminarit “Bebek” si dhe një numër të mirë për mësuese të shkollave. Megjithatë kërkesa për arsimimin e femrave në Konstadinopojë ishte e tillë sa që çoi në hapjen edhe të një shkollë tjetër “Shkolla e shtëpisë për vajza”, më 1871. Në 45 vjet (1871-1916), kjo shkollë ka pasur një rritje të dukshme dhe në vijim u bë “Kolegji i Konstadinopojës”. Suksesi i kësaj shkolle i ka dhënë fund të gjitha kundërshtimeve ndaj arsimimit të femrave dhe të gjitha kombësitë në Konstandinopojë, përfshi

edhe turqit, kanë hapur shkolla për vajza. Kur erdhën në pushtet Turqit e Rinjë më 1908, aq e etur ishte qeveria e tyre për të promovuar e nxitur arsimimin në turqisht të vajzave turke, sa që edhe Pallatin Perandorak në Candilli, që ishte përball Kolegjit Robert në Bosfor, menduan ta bëjnë shkollë me konvikt për vajzat. Por kjo ishte një punë e vështirë, sepse nuk gjendeshin mësuese për këtë shkollë. Për të plotësuar këtë mangësi, me shpenzimet e qeverisë u zgjodhën disa të reja turke dhe u dërguan në Kolegjin e Konstandinopojës për t'u trajnuar si mësuese.

Një ndodhi që tregon ndryshimin e mentalitetit të turqëve me ndikim në çështjen e arsimimit të femrave: Dy muaj pas krijimit të qeverisë së Turqëve të Rinjë, më 18 shtator 1908, u mbajt një takim i jashtëzakonshëm në kopështin publik “Bebek” të Bosforit. Greene kujton se “Në 50 vitet e qëndrimit tim të Turqi, nuk ishte mbajtur kurrë një asamble e tillë dhe unë mora pjesë në mbledhje, kurioz të shoh se çfarë mund të ndodhte. Ishte ndërtuar një tendë për folësit dhe kopështi ishte ndarë në dy pjesë: për burra dhe për gra. Seksioni për gratë ishte mbushur me një shoqëri të madhe zonjash turke dhe për habinë time, i kishin hequr vllot të gjitha dhe fytyrat e zonjave kishin një pamje më tërheqëse. Folës ishte Princi Sabah. Princi, ndonëse ishte nipi i tiranit, Sulltan Hamidit, ishte një mik i Turqëve të Rinjë. Ky, me një turqishte të thjeshtë, bëri një fjalim të mrekullueshëm. Ai filloi duke deklaruar, se “qeveria është për popullin dhe jo populli për qeverinë; se qeveria e re duhet të mbështetet me zell për sa kohë që ministrat tregohen të denjë për besim, nëse ministrat gabojnë është privilegj dhe detyrë e një shtypi të lirë të vinte në dukje gabimet; të drejtat dhe privilegjet civile ishin një dhe të njëjta për të gjithë në të tërë Perandorinë Osmane, pa lidhje me fenë apo racat. Dhe në fund, ai tha: mirëqenia e vendit varej nga trajnimi që nënat turke u bënin fëmijëve të tyre dhe si rrrjedhim, gratë turke duhet të arsimohen”.

Përfshirë kolegjin e Konstandinopojës, më 1914 në Turqi ishin 3 kolegje dhe 16 shkolla me konvikt për vajza, të gjitha nën menaxhimin amerikan. Në pamje të parë, numri i



Kolegji i Anatosisë në Mersifon (Kolegji Amerikan në Mersovan)

shkollave me konvikt për vajza, mund të duket i madh, por të mos harrojmë se edhe Turqia ishte një vend i madh: vetëm nga Konstandinopojë në Van ka 1500 km dhe shkollat, me disa përjashtime të vogla, janë disa qindra km larg njëra tjetrës.

Shkolla e vajzave në Adabazar, dallon prej çdo shkolle tjetër me konvikt në Turqi, për faktin se për 30 vjet, drejtohej prej një Bordi të besuarish vendas. Ndërsa shkolla e vajzave në Marsovan, që u thirrë më vonë si "Shkolla e vajzave të Anadollit", është pasardhësi i shkollës së parë me konvikt për vajza të hapur në Turqi: është themeluar në Konstandinopojë më 1845 dhe transferohet në Marsovan më 1865. Gjatë 50 viteve të funksionimit pati një rritje të jashtëzakonshme. Mësimi u dha fillimisht në një dhomë të errët me tetë nxënëse, të gjitha armeniane. Në periudhën 1913-1914 numëroheshin 269 nxënëse që vinin nga pesë nacionalitete, duke përfshirë edhe 6 vajza turke.

Në vitet e para mësimi kufizohej vetëm në një degë të shkollës fillore. Me kalimin e viteve u shtua numri i lëndëve si: anglisht, greqisht, armenisht matematikë, histori, fizikë, gjeologji, botanikë, filologji, shkenca vendase, punime

me gjilpërë dhe muzikë. Lëndët u shtuan vit pas vitit. Pas vitit 1890, të gjitha vajzat, ndryshe nga zakonet turke, nuk i mbulonin fytyrat e tyre kur dilnin në rrugë. Shkolla, për një kohë të konsiderueshme ka pasur dy mësues: një amerikan dhe një Armeanian.; më 1913-1914 kishte 27 instruktorë: 6 amerikanë, 7 grekë dhe 14 armeanianë. Deri në vitin 1914, shkolla kishte përgatitur 276 maturantë.

Eliza Fricher, drejtoresha e parë e shkollës së vajzave me konvikt në Marsovan. E lindur në Nju York më 1831, ajo shkoi në Turqi më 1863, pas diplomimit. Për 30 vjet, ajo ishte një bekim për shkollën. Ja se si e përshkruan Joseph Greene, këtë pioniere të civilizimit: "Mendërisht e mprehtë, vigjëlente, e gjallë, e pjekur dhe e fortë në karakter, një këngëtare e ëmbël, me përkushtim absolut dhe inteligjente ndaj punës, ajo hodhi themelet e kësaj ngrehine që ka bërë të mundur rezultatet e shkëlqyera të viteve të sukseshme". Ky përshkrim ngjanë me fizionominë që i përshkruan Durham, Sevasti Qiriazit: "Zonjusha Kyrias (Sevasti Qiriazit), një grua shumë e përgatitur dhe kurajoze,.... Sevasti përdorte tekste shkollore amerikane dhe jepte mësim në gjuhën shqipe... Shkolla e

Vashave ishte kaq moderne sa që më dukej se isha kthyer papritur në Europë".

Në Harpout, shkolla kishte 50 nxënëse, 33 prej të cilave ishin gra të reja të martuara. Caroline Bush, mësuesja amerikane e kësaj shkolle, e cila më vonë u kthye në kolegji, kujton: Ne kishim shumë rreziqe dhe sprova në ato turne misionare, duke fjetur në dysheme, shpesh në mes të një familjeje të madhe me fëmijë që qanin e na shqetësonin. Ose flinim në stalla ku gjelat këndonin e gomerët pëllitnin e gërvishteshin pas murit dhe kandili i vajit rrëzohej në mes të natës. Jetonim në familjet e misionarëve të martuar dhe kësajsoj lidhjet midis nesh ishin më të forta se sa marrëdhënie të thjeshta kolegësh. Megjithë lodhjen, një nga gëzimet tona më të mëdha ishte në kohën e Pashkëve, kohë në të cilën shkonim gjithë ditën nga njëra shtëpi në tjetrën dhe në çdo shtëpi kishte praktikisht nga një mbledhje dhe në mbrëmje njerëzit mblidheshin në dhomën tonë për të folur, kënduar dhe lutur. Ne kishim nga 50-100 e nganjëherë edhe 150 gra në takimet tona.

Në Bitlis, për më shumë se 45 vjet, punuan motrat Charlotë e Mary Eli, të njohura si "motrat Eli". Një periudhë kjo më e gjata e çdo shërbimi tjetër zonjash të pamartuara në Turqi. Qyteti

Bitlis, të cilat i dhanë jetën e tyre, ishte në disa aspekte, vendi më i vështirë në Perandorinë Osmane. Ndërsa zonja Meri Reynolds punoi në Smirna nga viti 1832 e deri në vitin 1915, duke u dalluar për punë vetëmohuese në shërbim të kominitetit femëror.

Ndër shumë misionare të tjera të pamartuara që kontribuan në Turqi, që kanë merituar njohje të veçanta, asnjë nuk ka fituar më shumë admirim se sa zonja Corinna Shattuck, një tjetër mësuese e palodhur. Në moshën 4 vjeçe humbi nënën dhe babain dhe u dërgua në shtëpinë e gjyshërve. Qysh në moshë të re ajo ja fal veten Krishtit dhe në moshën 16 vjeçe ishte mësuese. Pak pas mbërritjes në Aintab, në Turqi në vitin 1873, ajo shkruan: "Unë jam pothuajse e padobishme derisa të mësoj gjuhën, por shkoj çdo ditë në shkollë për të studiuar dhe për të parë vajzat, pasi dua që ato të ndjejnë se kam interes për to".

Kolegji Qëndror Turk për vajza, u ngrit në Marash. "Përpara se të vinte dorë misioni, njerëzit e këtij vendi ishin proverbialisht injorantë, barbarë dhe fanatikë", - shkruan Greene. Këtu në vitin 1865 u ngrit një ndërtesë për shkollë vajzash dhe zonja Josephinë Coffing, burri i së cilës ishte vvarë më 1862 prej gra-

Shkolla dhe konvikti i vajzave në Turqinë Qendrore në Marash





Kolegji amerikan në Aintab

bitësve, mori drejtimin e saj. Me punën e saj ajo ndihmoi që të hiqte paragjykimet e burrave që ishin kundër arsimimit të vajzave dhe shumë shpejt ajo kishte në klasën e saj, 30 nxënës. E ndihmuar edhe nga një zonjë e diplomuar në kolegjin e Aintabit, ajo gjeti kohën që të mbikyrte edhe katër shkolla të zakonshme. Në vitin 1872 shkolla priti edhe vajza nga fshati. Në vitin 1874 nga 25 mësues në shkollën e Marash, 19 ishin gra. Kolegji në Marash u hap në vitin 1882 në shtëpinë e një misionari dhe një vit më vonë mes entuzazimit u inagurua godina e re. Në vitin 1904, një ndërtesë e dytë edhe më e madhe, prej guri u ngrit nga Bordi i Grave.

Ndërsa Sivas (rreth 750 km në lindje të Konstandinopojës), një qytet në mes të Marsovanit dhe Harpount, aty nga viti 1850 u bë stacion misionarësh dhe deri më 1915, rreth 40 misione kanë punuar në qytet dhe provincë. Dy tiparet e veçanta të përpjekjeve të këtyre misioneve kanë qenë: shkolla e së dielës dhe puna edukative. Ndër misionarët zoti dhe zonja Hubbert ishin shumë të interesuar për punën e shkollës. Ndërkohë Dr. Perry, që ishte aktiv në çdo formë të përpjekjeve misionare, iu përkushtua posaçërisht edukimit. Që nga fillimi i

punës në Sivas, vëmendje iu kushtua hapjes së shkollave të përbashkëta. Në këtë kohë u krijuan 20 shkolla me 700 nxënës. Më 1880, Perry përuroi një system shkollash me nota, që u kulmua me një shkollë normale. Djemtë mësonin për biznes, por detyra e veçantë e shkollës normale ishte përgatitja e të rinjëve më premtues, për t'u bërë mësues. E njëjta formë dominonte edhe në shkollat e vajzave, sepse në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të siguroheshin mësues të tyre mirë, për shumë shkolla që po hapeshin në mbarë krahinën.

Më 1881, shkolla normale kishte 20 studentë dhe më 1887 u diplomua klasa e parë prej pesë vetash. Më 1888, shkolla normale diplomoi 10 të rinjë dhe shkolla me konvikt e vajzave, pesë të reja. Të gjitha këto ishin kontigjentë për të shtuar numrin e mësuesve. Në këtë kohë në Sivas kishte 19 shkolla të zakonshme nën kujdesin e misionarëve, me 1262 nxënës, ndër të cilët ishin rreth 300 jetimë. Kishte edhe 10 shkolla të së dielës me 1415 anëtarë.

Arsimi është nevoja më e madhe e Turqisë, nënvizon autori, - dhe pa arsim nuk ka shpresë për racën turke. Arsimi megjithatë, duhet të nënkuptojë jo vetëm edukimin e mendjes, por edhe të ndërgjegjes. Dhe si fetar i krishterë që

ishte, i lejon vetes të shkruaj: Njohja e Zotit, , e Zotit të Jezu Krishtit dhe bindja ndaj tij- kjo është kërkesë supreme e orës. Djemtë dhe vajzat turke janë tërheqës dhe të zgjuar, le të trajnohen tërësisht nga ana intelektuale, morale dhe shpirtërore. Kështu, djemt kur të bëhen burra o të jenë në gjendje t'i trajnojnë fëmijët, djemt e vajzat në mënyrë që të gëzojnë shtëpitë e tyre dhe të bekojnë vendin e tyre.

Shumë intelektualë turq tani njohin nevojën absolute për arsimimin e femrave dhe janë duke u përpjekur të themelojnë shkolla të larta për vajzat turke. Qeveria pranoi gjithashtu, të njëjtën nevojë dhe duke mos qenë në gjendje që të kishte gra të arsimuara që të menaxhojnë shkollat e vajzave, dërgoi vajza të reja turke, me shpenzimet e saj, në Kolegjin Amerikan të Vajzave në Konstandinopojë, që këto vajza, pasi të kenë marrë një arsim në kolegjin Amerikan, të bëhen drejtoresha të shkollave të vajzave në shkollat turke.

Jemi të lumtur të shtojmë se që nga revolucioni i Turqëve të Rinj më 1908, fëmijët muhamedan, djem e vajza, janë lejuar të ndjekin shkollat e të krishterëve, edhe në Kolegjet amerikane që gjenden në Azinë e Vogël, Siri dhe Egjipt. Për disa kohë janë regjistruar me mijëra fëmijë muhamedan çdo vit.

Shkolla e parë bullgare u hap nga një bullgar në Grabovë më 1835. Pas kësaj pasuan shkolla të tjera, meqë turqit nuk ndërhyjnë. Objektivi i parë i patriotëve bullgarë ishte që të hiqnin qafe sundimin e patolerueshëm të Patriarkut grek dhe të peshkopëve. Pas 22 vitesh polemikë me Patriarkanën greke, më 1870, u njoh nga turqit pavarësia e kishës kombëtare bullgare dhe u caktua administrator ekzarku bullgar, për punët kishtarë të atyre bullgarëve që ishin ende nën sundimin turk. Bordi Amerikan filloi punë mes bullgarëve më 1858, ndërsa vendi ishte akoma nën sundimin turk. Kjo vinte si rezultat edhe i ndikimit të Kolegjit Robert në Konstandinopojë i cili gjatë 50 viteve të fundit i ka dhënë qeverisë

bullgare shumë nga zyrtarët më të lartë të saj. Në Siri, puna e misioneve ishte për 50 vjet nën kujdestarinë e Bordit Amerikan, ndërkohë që në Egjipt, Misioni Amerikan u inagurua më 1854 dhe u punua jo vetëm në Kajro, por edhe në deltën e Luginën e Nilit. Ndërsa në Armeni, Misioni Amerikan, veç arsimimit, ndihmoi edhe në rehabilitimin e fëmijëve jetim dhe të grave vejusha, produkte të luftravë, sëmundjeve dhe urisë.

Puna e këtyre misioneve pati arritje të konsiderueshme në rritjen e numrit të shkollave dhe në masivizimin e popullsisë për të mësuar në gjuhën amtare. Nëse në vitin 1845, viti i parë i ngritjes së shkollave të para, në të gjithë ish perandorinë kishim vetëm 7 shkolla me 135 nxënës, në krye të 68 viteve, më 1913 kishte 450 shkolla me mbi 25 mijë e 900 nxënës. Por rritje të konsiderueshme pati edhe numri i mësuesve vendas: nëse në fillim kishte vetëm 12 mësues, në vitin 1913 kishte 1300 mësues vendas. Misionarët amerikanë, përveçse u shtuan vetë gjatë kësaj periudhe, kishin shërbyer edhe si "fara" e mirë për të shumëzuar numrin e mësuesve vendas.



Kur korren frytet

Nga ceremonia e diplomimeve

Në Kolegjin Universitar "Qiriazi" u organizua Ceremonia e Diplomimit të studentëve që përfunduan studimet në vitin akademik 2021-2022.

E veçanta e kësaj ceremonie ishte sepse u organizua në atmosferën e kremtimeve në kuadrin e 100 vjetorit të Kolegjit Universitar "Qiriazi". Në këtë ceremoni u diplomuan 146 studentë që përfunduan studimet në programet bachelor, master i shkencave dhe ato profesionale.

Rektori i Universitetit, Prof. Maksim Meço, përshëndeti studentët dhe të ftuarit, duke inkurajuar të rinjtë e sapodiplomuar që të punojnë fort duke investuar në dije për të realizuar ëndrrat e tyre.

Ndërsa presidenti i institucionit, Prof. Dr. Gjokë Uldedaj, në mes të emocioneve që ngjall kjo ngjarje, tha: Dëshiroj t'ju them se kjo festë na emocionon të gjithëve, jo vetëm Ju të diplomuarve, por edhe ne pedagogëve Tuaj. Kjo ditë, më shumë se çdo ditë tjetër në profesionin tonë, na bën të ndihemi krenar për ju, që do jeni, promotori i ndryshimit dhe i zhvillimit aty ku do të punoni.

Rrugëtimi ynë i përbashkët nuk ishte i lehtë, por më lejoni gjithashtu të falënderoj çdo pedagog, efektiv dhe të ftuar, që ka kontribuar në formimin tuaj, autoritetet dhe strukturat dre-

jtuese të KUQ, si dhe çdo punonjës ndihmës akademik dhe administrative, për angazhimin me përkushtim ndaj Jush dhe për mbarëvajtjen e punëve në Universitet. Gjithashtu, respekt dhe mirënjohje të thellë dëshiroj të shpreh për prindërit dhe të afërmit tuaj, të cilët ju kanë mbështetur pa asnjë kusht për përfundimin me sukses të studimeve.

Universiteti jonë ofron gjithësejt 13 programe studimi ose e thënë thjesht 13 diploma. Këto programe studimi janë strukturuar në mënyrë të tillë, që ti lejojnë studentëve një formim akademik e praktik, duke fokusuar prioritetet mbi formimin tuaj praktik dhe didaktik.

Ju urojë shumë suksese në rrugëtimin tuaj profesional dhe mos harroni se shpërblimi më i madh, për ne është suksesi dhe lumturia juaj. Por Ju kërkoj, që sukseset tuaja ndajini me ne, ejani na vizitoni sa më shpesh, sepse KUQ do t'i mbajë dyert të hapura për ju. Stafet akademike dhe ato ndihmëse do të jenë kurdoherë të gatshme e të përkushtuara për t'ju ofruar gjithçka që do t'ju nevojitet për të studiuar e bashkëpunuar në kuadër të projekteve dhe të veprimtarive shkencore, për të thelluar e zgjeruar dijet dhe për të ngjitur shkallët e karrierës profesionale dhe akademike.



Politikani dhe filantropisti amerikan Charles R. Crane, pjesë e historisë së Kolegjit Qiriazi

Salla kryesore e Kolegjit Universitar “Qiriazi” emërtohet “Salla Charles R. Crane”



Politikani dhe industrialisti nga Çikago Charles Crane, 1858-1939 ishte miku personal i Kristo Dakos. “Kumbara” i kësaj miqësie u bë profesori i Kolegjit në Oberlin E.I. Bosworth, i cili kishte pasur Dakon student. Kur Krejn i shfaqti atij dëshirën për të vizituar Shqipërinë në vitin 1911, Bosworth i dha atij emrin dhe adresën e Kristo Dakos, si të përshtatshëm për ta shoqëruar në këtë mision. Vizita që bëri në Shqipërinë e Veriut, në kohën kur kishte filluar kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911, kundër Perandorisë Osmane, e bëri atë një përkrahës të devotshëm të çështjes shqiptare. Sipas E. Durham, ai dha edhe një kontribut të konsiderueshëm financiar në ndihmë të familjeve që ishin shpërngulur në Malin e Zi si rezultat i reprimentëve të ushtrisë turke. Më pas, ai u bë nxitësi kryesor që ndikoi në marrjen e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913, që Korça e lakmuar nga

grekët, të jetë pjesë e Shqipërisë. Për këtë ai arriti t’i argumentojë sër Edward Grey, përkatesinë shqiptare të qytetit të Korçës me rrethinat e tij.

Krejn bëhet përkrahësi financiar kryesor si në shkollën e vashave në Korçë ashtu edhe në Institutin Kyrias në Tiranë, në Kodër-Kamëz, por edhe në ndihma të tjera nëpërmjet Kryqit të Kuq Amerikan. Krejn që i kudondodhur dhe ndihmat financiare që ai dhuroi qenë më të paktat, krahasuar me ndihmën e madhe që ai i bëri çështjes së Shqipërisë në periudhën kur ajo akoma nuk që njohur ndërkombëtarisht dhe kufijtë e saj nuk kishin marrë ende formë të plotë. Krejn është miku më i mirë që mund të kishte Shqipëria në ato kohë, edhe sepse pas tij ishte vetë Presidenti i SHBA, dhe ky mik është dhuratë nga Kristo Dako.

Herë pas here, ai nëpërmjet Dakos financonte për arsimimin e djemve dhe vajzave shqiptare në kolegjet amerikane të Stambollit, si Robert Kolegj etj. Synimi i tij ishte që edhe Shqipëria t’i kishte drejtuesit e udhëheqësit e nesërm, “për të ndrituar e për të naltësuar kombin...”. Sevasti Qiriazi-Dako, në relacionet e saj, shprehej: “...kemi qenë vërtetë me shumë fat që kemi pasur mundësi të blejmë një sasi prej rreth 40 ha tokë, me ndihmën bujare të Z. Charles Crane, ndaj të cilit institucioni është nën një borxh të veçantë për ndihmën e tij në këtë kohë dhe të vlefshme për ekzistencën e tij”. Gjatë kohës që ndërtohej kampusi i institutit, në vitet 1925-1927 Kristo Dako bën bilancin e shpenzimeve të ndërtimit si dhe deklaroi burimin e të ardhurave. Bie në sy fakti, se tre janë burimet e të ardhurave për pronën në Kamëz: Familja Dako-Qiriazi, Charles Crane dhe Qeveria Shqiptare.

Si një fole që gumëzhinë

Klubet aktive të studentëve

*Marina Dyli,
studente e Programit
“Kujdes Social e Shëndetësor”
Presidente e Këshillit Studentor
Kryetare e Klubit letrar*

Kolegji universitar “Qiriazi” ka arritur të bashkojë shumë studentë nga krahina të ndryshme të vendit, duke na bërë bashkë në një institucion historik të arsimit shqiptar për një qëllim të vetëm, formimin profesional-akademik. Motoja e universitetit, “Në qëndër studentit” ka bërë që ne studentët të ndihemi më konfidencial, më të lirshëm, vetëvetja, ambiciozë, sipërmarrës dhe bartës të vlerave akademike e qytetare. Jeta jonë studentore shkon përtej formalitetit akademik dhe provimeve. Përmes klubeve studentore, konkurseve, aktiviteteve, konferencave, seminareve të hapura, ndeshjeve sportive jo vetëm mësojmë dhe përforcojmë njohuritë tona, por dhe argëtohem. Të gjithë ne studentët kemi gjetur habitatin tonë për të shpalosur aftësitë, prezantuar idetë dhe propozimet. Në këtë pikë, për të lehtësu-

ar drejtimin dhe të shprehurit për realizimin e tyre është vendosur në dispozicion të çdo studenti “Qeveria Studentore”, ku bëjnë pjesë të gjithë senatorët e secilit program dhe viti akademik ku dy prej tyre gëzojnë edhe statusin e presidentes së “Këshillit Studentor” Marina Dyli dhe zëvendës presidentja Erseda Kurmekaj. Të qënurit pjesë e qeverisë studentore si pjesë e përditshme e jetës tonë studentore, nxit zhvillimin e aftësive sociale, lidhshpimit. Kjo është një mundësi ku secili prej nesh edhe në vazhdimësi mund të bëhet një lider i zoti dhe një organizator i aftë. Ne e kemi ndërtuar jetën tonë studentore mbi bazën e ndryshimeve cilësore siç janë njohja e miqve të rinj, eksplorimi i interesave personale, argëtimi dhe përforcimi akademik. Të gjithë ne studentët, tashmë pjesë e familjes së madhe “Qiriazi”, kemi arritur të zhvillojmë një jetë të shëndetshme studentore, kjo falë dhe faciliteteve që zotëron dhe na ofron Kolegji Universitar “Qiriazi” duke nisur nga: biblioteka, salla e kompjuterave, laboratorët, kabineti i sportit, salla e konferencës, infrastruktura e përgjithshme... Jeta e studentëve të “Qiriazit” është e mbushur me organizime, ku bëjnë pjesë edhe aktivitetet.





Këto aktivitete ne i ndërtojmë duke kujtuar çdo ditë festive dhe jo vetëm. Nuk e njohim harresën: çdo ditë e shënuar festohet dhe kujtohet nga ne përmes organizimeve në grupe, punëve vullnetare, krijimit, mesazheve etj. E vecanta është se edhe në aktivitetet formale dhe joformale të organizuara nga vetë stafi i universitetit, përsëri ne studentët jemi ata të cilët na lihet "stafeta" e përfaqësimit si ambasadorë të universitetit.

Aktivizimi i studentëve dhe nxitja e tyre për t'u angazhuar, është prioritet i rëndësishëm i përditshmërisë studentore. Aktivizimi jonë dhe organizimet tona realizohen edhe përmes pjesëmarrjes në klubet studentore. Më së shumti vlen për t'u përmendur "Klubi i Librit", me tutor, shkrimtarin e ri, ish student i universitetit tonë, Liridon Mulaj dhe dy bashkëdrejtuesit, studentët Marina Dyli dhe Stiven Vriani. "Klubi i librit" ka si synim promovimin dhe përfaqësimin e studentëve të apasionuar mbas letërsisë e kulturës si dhe ata që vijnë nga cdo sferë e jetës, të interesuar për të ndarë diskutime.

Një ndër këto aktivitete ishte edhe takimi me shkrimtarin dhe publicistin shqiptaro-amerikan Shefqet Meko. "Viza amerikane" novela që sjell në fokus raportin e emigrantit shqiptar me Amerikën, tokën e premtuar ishte dhe tema e bashkëbisedimit mes autorit, studentëve dhe pedagogëve.

Takimin e përshëndetën dhe presidenti i Kolegjit Universitar "Qiriazi" Prof. Dr. Gjokë Uldedaj, shkrimtari dhe juristi Z. Ahmet

Prenci, publicistët Martin Lekaj dhe Dr. Gjovalin Gjeloshi, Prof. Eugen Pepaj etj. Autori iu përgjigj pyetjeve dhe interesimit të studentëve, jo vetëm për tematikën e librit, por edhe më gjerë.

Në fund presidenti i Universitetit, Prof. Dr. Gjokë Uldedaj, e nderoi Shefqet Mekon me medalionin e 100 vjetorit të Kolegjit Universitar "Qiriazi". Z. Meko është autor i disa librave artistik dhe publicistik. Novela "Viza amerikane" është libri i tij më i ri.

Bashkëbisedimi u përcuall nën moderimin e shkrimtarit Liridon Mulaj, ish student i Kolegjit Universitar "Qiriazi".

"Klubi i librit" në kohë të ndryshme ka organizuar edhe diskutime të veprave letrare me shkrimtarët e kritikët Besnik Mustafaj, Rita Petro, Alda Bardhyli, Ylljet Aliçka etj.



Ylljet Aliçka dhe Alda Bardhyli

Drita që sjell një dokumentar filmik

Shefqet Meko
Shkrimtar dhe publicist

Minneapolis, 3 Mars 2023

Kur në vitet 2000 do kthehesha nga Amerika për herë të parë, pas "stazhit" fillestar të ikana-kut shqiptar në "Kontinentin Tjetër", Gjokë Uldedaj, miku im konstant qysh në vitet 1970, do të më thoshte me një krenari malësore të admirueshme "Ju ikët, por ne do ta bëjmë Shqipërinë, o Shefqet Meko... Ne që nuk ikëm jemi Atdheu, ani pse na duhet "romantizmi juaj patriotik", si oksigjen që qiriu të mos fiket..." Ato vite Gjoka ishte kryetar i Dhomës së Tregëtisë së Shqipërisë dhe më kishte ftuar në një pritje zyrtare. Instiktivisht u bëra xheloz duke pyetur veten "Pse ika!?!..." edhe pse nuk kisha asnjë dëshirë për të qëndruar. "Pesha" ime specifike ishte tashmë në Amerikë. Nga së brendshmi ndjeva një krenari, që miku im kishte gjetur rrugën e qëndresës, zhvillimit dhe qytetërimit. Vitë më vonë, Behar Malaj do më thoshte të njëjtën gjë "Pse ike Shefqet, këtu mund të ishe një Shefqet Meko..." Të dy miqtë e rinisë sime, vijnë nga një "gjeografi shqiptare" ku kishin jetuar prindërit e mi pas çlirimit. Nëna do më thoshtë sa e sa herë "Nuk ka si komshijtë përmetarë" ndërsa për Shkodrën "nuk ka si e qeshura shkodrane"... Jo më kot Behar Malaj shënohet ndër të parët që ka investuar në fushën e diturisë, duke ndërtuar një sallë leksionesh moderne në Fakultetin e Ekonomisë që mban emrin e tij "Salla Behar Malaj", ndërkohë më vonë Gjokë Uldedaj do ishte në një "agresion" arsimor duke ringjallur një nga kolegjet që gati ka bashkëlindur me mëvetësinë shqiptare... Këta janë dy kontributorë të veçantë të brezit tim, që e kanë parë arsimimin shqiptar si fushë ku "duhet investuar"...

Rreth dokumentarit "Përvjetori i artë", realizuar nga Gjovalin Gjeloshi dhe Tom Therçaj, kushtuar shekullit të parë të Veprës Arsimore "Qiriazi", që Prof. Dr. Gjokë Uldedaj e ka "ringjallur" me një pasion akademik të spikatur. "Xhelozia" ime përkthehet në këto radhë të ndjera krenarisht



Prof. Dr. Nevila Nika



Këto lloj kujtimesh më vërshuan në mendje, ndërsa ndoqa dokumentarin filmik “Përvjetori i Artë” një kontribut profesonist i gazetarit “të lindur”, Gjovalin Gjeloşi dhe lezhjanit tjetër Tom Therçaj, ose “njeriut me kamerë në dorë”, kushtuar 100 vjetorit të shkollës “Qiriazi”. Edhe pse duken të largëta kujimet e mia të trazuara, në fakt sjellin në mendje Një Shqipëri: Atë të dijes dhe traditës në një Jug-Veri të kurrëndashëm. Pak e dinë psh, se Hasan Prishtina nuk ishte thjesht “i pushkës”, por edhe i mendjes së ndritur shqiptare në vitet e stuhishme të pavarësisë sonë kombëtare. “Do të rrojë Shqipëria/ Do të rrojë Shqipëria...” këto vargje janë sipari i dokumentarit në fjalë që depërton thellë në pasionin shqiptar të ekzistencës përmes diturisë shqip. Autorët e dokumentarit e sjellin këtë këngë patriotike si himn të gjuhës shqipe që nuk u tret dhe nuk u zhduk falë së pari qëndrestarëve intelektualë si Parashqevi Qiriazi, që shënohet të jetë e vetmja “gjini tjetër” në Kongresin e Manastirit me shumicë absolute “burrash shqiptarë”. Kënga patriotike korçare “Do të rrojë Shqipëria” nga unë është dëgjuar edhe më parë. Nuk ishte një timbër i panjohur më parë, por autorët e dokumentarit i kanë dhënë një kuptim lirie vargjeve “Do të rrojë Shqipëria...”. Dje kur të njëjtat vargje melodike pushtonin publikun, ato sikur ishin “vargje ngushtice” që çdo gjë së fundmi ja dedikonim vetëm

“Partisë dhe Shokut Enver...”. Konotacioni i kësaj kënge në dokumentarin në fjalë, merr një hapësirë të re kuptimore: Shqipëria rron pavarësisht “kulteve” tona. Shqipëria është shumë më e madhe se një individ, se një person, se një intelektual. Shqipëria është një univers i llojit të vet që në themel të ekzistencës ka “Gjuhën Shqipe”, ku investuan Motrat Qiriazi, Kristo Dako e shumë të tjerë... Dokumentari në falë është një “gur kilometrik” në qëndresën shqiptare ndaj zhbërjes dhe asimilimit gjuhësor. A nuk është gjuha “themeli” i çdo kombi? A mund të ishim ende shqiptarë nëse do flisnim greqisht apo serbo-kroatisht? Gjuha është dhe mbetet “kollona” e betontë e çdo kombi që nuk ka “tërmet” ta groposë. Pa të nuk ka kombe, qëndresë dhe ekzistencë. Motrat Qiriazi janë shembulli më i madh i qëndresës shqiptare, që për fatin tonë të madh, sot është “ringjallur” dhe rigritir në piedestalin e merituar. Besoj se autorët e këtij dokumentari, Gjovalin Gjeloşi dhe Tom Therçaj, që do të mbetet në “Arshivën Shqiptare”, kanë mundur të gërmojnë thellë në shumë të vërteta historike, që e shkuara jonë me “Partinë në ballë” na kishte verbuar aq dhimbshëm. Unë jam një “i verbuari” i kohës që iku, dhe ndiej dhimbje, dëshpërim, mëkat...Nuk e shkruaj për të “larë gjynahet”, e them se më dhemb pamundësia për ta njohur një të vërtetë të madhe që mund



Prof. Dr. Valentina Duka

të ishte Drita drejt së ardhmes sonë më të ndritur, më të shkëlqyer, më premtuese... Unë ndihem me fat që të kem njohur nga afër, më mirë se kushdo tjetër, Gjokë Uldedaj, njeriun që qysh nga vitit 2016, “ndërroi kursin” e biznesit duke investuar tek “Ëndrra Qiriazi”. Në këtë mënyrë shkodrani “devijoi” nga linja normale e çdo biznesi që është fitimi dhe fitimi. Në të vërtetë fitimi është “oksigjen” i çdo lloj sipërmarrje, por Uldedaj ka veshur “kostumin” e një intelektualit që shikon fitimin në “dakadat që vijnë”. Vetëm fakti që ai ka ringjallur një institucion arsimor historik, siç ishte “Shkolla e Dakës” është kontributi më i çmuar që një biznesmen mund t’i ofrojë Shqipërisë së sotme. Autorët e dokumentarit kanë mundur të krijojnë një “skeleton” gjithëshqiptar ku flet gati “Gjithë Shqipëria”. Aty ka zërin e vet Frashër Demaj, historian i ri nga Kosova; Prof. Valentina Duka, historiane; Prof. Shaban Sinani, sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave; Mal Berisha, ambasador; Prof. Et’hem Ruka, ish ministër Arsimit dhe Rektor i Universitetit Luarasi; Prof. Nevila Nika, historiane; Prof. Myqerem Tafaj, ish ministër i arsimit; Genc Pollo, ish ministër i arsimit; Robert Dako, nip

i Sevasti Qiriazit dhe Kristo Dakos; Prof. Maksim Meço, rektor i Universitetit Qiriazi etj. Aty mund të flisnin edhe shumë të tjerë, por një dokumentar ka “kufijtë e vet”. Në tërësinë e vet “Përvjetori i artë” është një sukses i autorëve që kanë mundur të futin këtë dokumentar në “Arshivën” shqiptare, që nesër me siguri do shfletohet dhe kujtohet për të kuptuar të shkuarën tonë të koklavitur. Është për të veçuar kujtesa e shënueshme e Prof. Dr. Shaban Sinani kur në mënyrë të qartë thotë se emigracioni ynë në Amerikë, shekullin që shkoi ka një “Kuartet shqiptar” të pandashëm siç është Noli-Konica-Dako-Çekrezi. Këtë do ta quaja unë, një ndër risitë e dokumentarit në fjalë. Është mania shqiptare që të bëjmë “lojë me lavdinë” e këtij apo atij personi. Nëse plejada e emigrimit shqiptar në shekullin e shkuar shihet si “Kuartet” intelektual që plotëson njëri tjetrin, ky është në të vërtetë një “vështrim ndryshe” i historisë ku shpesh, ne shqiptarët “harrojmë dikë” për t’i dhënë “lavdi tjetrit”. Nuk ka komb në botë që t’i përkasë vetëm “një personi”. Kombet janë përherë kontribute të bashkësive intelektuale e mendjeve të ndritura. Në këtë plan dokumentari në fjalë hedh dritë mbi një vështrim të ri të historisë sonë të kontributeve dritëshqiptare nga Amerika. Vetëm kur të mundim të kuptojmë vlerën e “orteqeve” intelektuale, vetëm atë moment “kombi lëviz” dhe ecën përpara. Ndryshe kultet e veçanta jo vetëm janë dobësi, por rrezikojnë shumë më tepër se sa vetë “bashkimet intelektuale”. Për fatin tonë të keq, ne ende nuk ndahemi dot nga “kulti i njëshit” që realisht ka qënë mallkimi më i madh i shekullit që shkoi. Sot është koha e “perëndimit” të kulteve duke pasur si kult të vetëm dijen, dritën intelektuale shqiptare që është përherë më shumë se “njëshi- zero dhe fyl...” siç shkruante Majakovksi. Si mundet ende shqiptarët mbahen pas “Zeros dhe Fylit” të neveritshëm? A nuk na mjaftoi gjysëmshkulli i Enverit Absolut?... Mjafton të shohësh thjesht të tashmen e Kolegjit Universitar “Qiriazi”. Aty nuk është vetëm Gjokë Uldedaj. Ai pati guxim për të investuar në një “kollonë” shekullore të traditës arsimore, por nuk është i vetëm: Aty është Maksim Meço, Abdyl Sinani, Vejsel

Rizvanolli dhe shumë intelektualë të tjerë që do sjellin dritë dhe arsimim profesional. Unë uroj që ëndrra “Qiriazi” të vijojë të ndritë mendjet shqiptare, jo thjesht si “shpresë e një kombi, por si një vektor zhvillimi arsimor... Të gjithë të intervistuarit në dokumentarin e “Ringjalljes Qiriazi” evokojnë një urgjencë shqiptare: “Nuk ka Shqipëri pa gjuhë dhe dituri”. Dokumentari “Përvjetori i artë”, ka vlera të qëndrueshme të së sotmes dhe të ardhmes. Autorët realizues meritojnë përgëzime në këtë kontribut gjithëinformues. Çdo fjalë e thënë nga të intervistuarit ka peshën e vet të së vërtetës. Nuk dua të veçoj kënd, sepse të gjithë që thonë diçka janë një prurje Veri-Jug, ashtu siç është Shqipëria jonë një “Meridian Veri Jug”. Sidoqoftë, unë mendoj se realizuesit e këtij dokumentari me vlera gjithësuese shqiptare, mund të kishin arritur kuota të reja nëse aty do kishim Prof. Dr. Xhevat Lloshin apo akademikun Rexhep Qosja apo edhe “fjala Kadare” si një pasues e pasurues i shqipes që ëndërronin Qiriazët dhe Plejada e tyre e Rilindjes Kombëtare. E veçoj këtë sugjerim, sepse kjo do t’i kishte dhënë këtij dokumentari një dimension të ri. Aq më e dobishme do ishte kjo, nëse Kosta Çekrezi dhe Kristo Dako do kishin më shumë hapësirë në këtë disaminutash dokumentar apo edhe kontribues të tjerë të shkollimit shqiptar. Unë e kuptoj kufizimin që të jep koha në ekran. Duke thënë këtë, nuk mendoj se ul ndonjë vlerë të këtij kontributi

historiko-kombëtar.

Petro Lati, publicist dhe autor i qindra dokumentarëve televizivë me vlera të thekshme kulturore e historike, pasi e kishte parë “Përvjetorin e Artë”, do të më thoshte në telefon nga Kalifornia: “Është një punë e plotë që meriton lavdërime dhe përgëzime...Mision i arritur profesionalisht”. Nuk mund të them se një dokumentar i ka thënë të gjitha. Nëse autorët do t’i rikthehen pas disa vitesh, jam i sigurt që ata do ta pasurojnë edhe më shumë, jo thjesht duke kujtuar “ndonjë harresë”, që është në natyrën e kësaj pune, por duke e pasuruar me fakte dhe të vërteta të tjera që do t’i nxjerrë “në breg” vetë jeta në progres e Kolegjit Universitar “Qiriazi”... Autorët me siguri e kanë hapur “bllokun e shënimeve”.

I kthehem ndjesive të mia më vitet 2000 kur kthehesha në Shqipëri për herë të parë si “ikanak shqiptar”. Kurrë nuk e kisha imagjinuar veten time kaq larg vendlindjes që dua. Por kur shoh se çfarë punëra të mira janë bërë dhe do bëhen nga ata që “shikojnë të nesërmen” pyes veten: Pse mbetemi kaq të përçarë në jetën e përditshme ku flet “vetëm politika”, si shigjetë e helmatisur?...Pse na mungon “dashuria për zhvillim” sikurse ëndërronin plejada e Rilindjes Kombëtare?...Kolegji Universitar “Qiriazi” më duket një “monument” dije që mund dhe duhet të përbashkojë idetë dhe të ardhmen shqiptare.

Nxitje për projekte të përbashkëta

Ambasadori brazilian João Tabajara de Oliveira Júnior, vizitë në Universitetin Qiriazi



Më datë 15.06.2023, ambasadori i Brazilit, z. João Tabajara de Oliveira Júnior, vizitoi Kolegjin Universitar Qiriazi. Ai u mirëprit nga presidenti i institucionit, Prof. Dr. Gjakë Uldedaj dhe drejtuesi i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare, z. Viliem Kurtulaj. Ambasadori u njoh nga afër me programet e studimit dhe mjediset e universitetit. Në takim u bisedua mbi mundësitë e bashkëpunimit midis Kolegjit Universitar Qiriazi me universitete nga Brazili, objektivi të cilin ambasada do ta vinte në planet e saj të punës. Gjithashtu, temë e diskutimit ishin dhe bashkëpunime dhe projekte të përbashkëta midis

universitetit dhe vetë Ambasadës së Brazilit në Tiranë. Ambasadori i nxiti bashkëbiseduesit që të mos nguronin të merrnin inisiativa të tilla, për të cilat ambasada do të investohej maksimalisht. Po atë ditë, ambasadori brazilian pati mundësinë të vizitonte panairin e punës të organizuar në Universitetin Qiriazi ku merrnin pjesë mbi 30 biznese dhe ente shtetërore e private, një përvojë dhe praktikë tashmë e njohur e këtij institucioni të arsimit të lartë, ku takohen e ballafaqohen studentët që presin të diplomohen në fusha të ndryshme me institucionet e bizneset punëdhënëse.



“Emblema e Institutit tonë në Maqedoninë e Veriut”

Drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Skënder Asani, vizitoi Kolegjin Universitar Qiriazhi



Skënder Asani dhe Maksim Meço

Prof. Dr. Skënder Asani, drejtor i ITSHKSH, bëri një vizitë pune në Kolegjin Universitar Qiriazhi, ku u takua me rektorin e Universitetit Prof. Dr. Maksim Meço. Në këtë udhëtim ai shoqërohej nga specialisti i këtij institucioni, gazetari dhe botuesi Dr. Emin Azemi -Jemi epiqendër e albanologjisë në Maqedoni, tha ndër të tjera, Z. Asani. Instituti jonë tashmë është pranuar si subjekt serioz në korpusin e institucioneve shkencore të vendit tonë. Megjithatë trashëgimia jonë në Maqedoninë e Veriut, e veçmas në Shkup, përgjatë viteve është tjetërsuar dhe dëmtuar mjaft, përsëri kujtoj se ka hapësirë të punohet në kultivimin, mirëmbajtjen dhe afirmimin e saj, në mënyrë që të prodhohet diçka më të mirë për gjeneratat që vijnë pas nesh në kuptim të shkencës dhe mbrojtjes së trashëgimisë. Dhe, këtë po përpiqemi ta bëjmë. Çdo vit organizojmë së paku dy konferenca shkencore dhe një numër të konsiderueshëm botimesh. Ne kemi bashkëpunim të mirë me thuaja të gjitha institucionet simotra të vendit dhe jashtë

Maqedonisë. Deri tash kemi nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi me institucione shkencore shqiptare në Kosovë e Maqedoni, por edhe të tjera në Maqedoni. Fjala bie, kemi bashkëpunim shumë të mirë me Institutin Albanologjik të Prishtinës, por edhe me Institutin e Historisë e Akademinë e Shkencave në Prishtinë. Pastaj kemi bashkëpunim edhe me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë etj. Megjithatë, ne kemi bashkëpunim edhe me institucione vendore, si Instituti i Historisë Nacionale në Shkup, por edhe të gjitha universitetet vendore. Në këtë mes ne na intereson edhe një memorandum bashkëpunimi me Universitetin tuaj, si një institucion i arsimit të lartë që mban një emër të nderuar për ne. Motrat Qiriazhi janë emblema e institutit tonë në Maqedoninë e Veriut. Rektori, z. Meço u shpreh entuziast për një bashkëpunim të tillë. Ne së shpejti, tha ai, do të përcaktojmë edhe modalitetet e memorandumit të bashkëpunimit mes dy institucioneve tona dhe fushat e bashkëpunimit.

“Mosha e artë e një Universiteti”

Një libër me titullin që na vë në mendime



“Mosha e artë e një Universitet” me autor Dr. Gjovalin Gjeloši, është libri i promovuar në ambjentet e bibliotekës shkencore të Kolegjit Universitar “Qiriazhi”. Aktiviteti u organizua nga Klubi i Librit “Qiriazhi”, një organizëm i studentëve letrar të këtij universiteti. Promovimi mund të konsiderohet edhe si një bashkëpunim i Klubit letrar të studentëve të “Qiriazhit” me Klubin Letrar “Ndoc Gjetja” të Lezhës, pasi në këtë bashkëbisedim për vlerat e këtij libri, merite pjesë si i ftuar edhe poeti e prozatori Viktor Gjokolaj, i cili është njëri prej drejtuesëve të këtij klubi. Ndërkohë z. Gjokolaj mbajti edhe diskutimin kryesor rreth vlerave të spikatura të këtij botimi, të cilin ai e konsideroi jo vetëm “një botim serioz e me vlera shkencore-historike, por edhe si një pasaportë e këtij universiteti, i cili tashmë ka fituar “të drejtën e të qenit universiteti më i vjetër në Shqipëri”, si institucioni që hodhi themelet e arsimit të lartë në vendin tonë. “E arta e moshës së artë”, i quajti poeti lezhjanë, studentët të cilët kanë fatin të studjojnë në këtë universitet me histori që e kalon shekullin. Meqenëse në takim shumica e studentëve qenë vajza, ishte një rast i volitshëm për të evokuar traditën e Institutit Femëror Qiriazhi, i cili u ngrit në këtë godinë përpara 100 viteve vetëm me funksionin për të shkolluar këtë gjini, prej shekujsh të skllavëruar. Studentja Marina Dyli, kryetare e Klubit Letrar dhe njëkohësisht kryetare e Këshillit Studentor të universitetit, foli për traditën e Klubit të Letrarëve në promovimin e veprave dhe autorëve të ndryshëm dhe e cilësoi librin “si një udhërrëfyes për ne studentët”. Pasi lexon këtë libër, u shpreh ajo, të rritet krenaria që studion në bankat e këtij universiteti me histori shekullore dhe me tradita të spikatura në arsimimin e femrës shqiptare. Këto tradita ne i



shohim sot të përtërirë dhe të ngritura në një stad akoma edhe më të lartë.

Përveç studentëve, në promovimin e librit muarën pjesë edhe pedagogë e drejtues të këtij universiteti. Prof. Dr. Maksim Meço, rektor i Kolegjit Universitar “Qiriazi”, duke folur edhe si ish student i “Shkollës së Dakës”, siç emërtohej dikur Instituti i Lartë Bujqësor (sot UBT), tha se autori, kolegu ynë na ka sjellë një libër me të vërtetat historike që për vite me radhë na janë mohuar ne brezit tonë. Ne ishim studentë të shkollës së Dakës dhe nuk dinim se kush ishte Dako. Ne merrnim leksione në këtë godinë dhe nuk dinim se këtu ishte themeluar kolegji më i vjetër i arsimit në vendin tonë. Ne e mësuaam të vërtetën përnjëherë me ju- u tha ai studentëve.

Më herët, akademiku Gjovalin Shkurtaç, duke e paraqitur librin në përvjetorin e 100-të të universitetit, ka thënë: Libri ka tematikë e parashtrim që rreket të tregojë e të dëshmojë, po edhe të përcaktojë vendin që i takon një institucioni të rëndësishëm arsimor si “Shkolla shqipe e vashave”, prandaj, nderi e kënaqësia e të qenit paraqitës e vlerësues, teratisen e zbehen dhe zotëruese bëhen ndjenja e përgjegjësisë dhe droja se mos nuk ia del t’i parashtrosh, t’i tumirosh e t’i përthekosh të gjitha ato prurje që ka sjellë autori nga hulumtimet, kundrimet e qëmtimet e tij, mesa duket

të kryera për një kohë bukur të gjatë, jo vetëm në biblioteka, po edhe në arkivin e shtetit e në arkivat vetjake të Qiriazëve, Dakovë etj. Kemi në dorë një libër që jo vetëm rrefen e pohon, po edhe që ju vë në mendime, që na fton të gjykojmë me mendje të kthjellët për të gjitha bëmat, të mira e të vështira, për të gjitha ato vepra e veprimtari të së shkuarës, në fushën e arsimit e të arsimimit, duke nxjerrë në pah sidomos kahun e mbarë të përpjekjeve për shkollimin e grave shqiptare e ku, natyrisht, vihet në dukje roli i pavdirë i motrave e vëllezërve Qiriazi si dhe i Kristo Dakos. Libri i sjell lexuesit historinë e vjetër dhe të re të kolegjit universitar Qiriazi, nëpër të gjithë rrugëtimin e tij. Aty paraqitet madhështia e këtij institucioni arsimor, që filloi para 131 vitesh në një “odë shpi” me pesë banka e me tri harta të varura në mure e deri te ky kampus i vërtet universitar, (arkitekturën e të cilit do ta kishin zili edhe sot shumë universitete) që i dha emrin kësaj kodre të bukur të falur nga natyra dhe të lulëzuar nga dora e njeriut. Në libër del qartë mbijetesja e kësaj shkolle unike në Shqipëri megjithë sulmet e pareshtura që i bënë asaj Patriarkana greke dhe qeveria osmane. Këtë fakt, autori e argumenton mes të tjerave, edhe me këshillën e Gjerasim Qiriazit që i dha motrës së tij, në orën e vdekjes: “Udha jote është mbushur me ferra. Por asnjë punë

e mirë nuk arrihet pa lot e pa mundime. Dy janë forcat që do të pengojnë në udhën tënde kombëtare: hyqymeti turk dhe kleri grek. Hapi sytë e mos i kundërshtoj këto forca përnjëherësh, sepse janë të tmerrshme kur janë të bashkuara...”. Pas këtij momenti, shkolla u bë një “amanet i shenjtë” për Sevastinë. Gjetje e bukur e domethënëse është “Mosha e artë e universiteteve”. Fatëkeqësi është se ne nuk kemi disa universitete të kësaj moshe. Do t’i kishim. Rilindasit e patriotët tanë punuan, françeskanët e jezuitët tanë sakrifkuan- hapën shkolla e kolegje të niveleve evropiane, të cilat sot do të ishin universitete po më këtë nivel dhe me moshë të artë- siç shprehet Gjovalin Gjeloçi-, të moshës së pjekurisë mësimdhënëse e akademike. Monografia “Mosha e artë e një universiteti” është shkruar e nyjetuar në mënyrë të atillë që nuk mungojnë edhe paraqitjet apo kundrimet kritike, por zotëruese është fryma pohuese e vlerave të ruajtura dhe që kanë qenë meritore për kohën kur u themelua shkolla e vashave, si dhe në vijim për atë institucion të rëndësishëm të arsimit shqiptar. Janë interesante

dhe të veçanta, vlerësimet që personalitetet e kohës i kanë bërë këtij institucioni: Mbretër e kryeministra, ministra, deputetë e intelektualë të shquar, ikona të arsimit tonë kombëtar dhe burra të shquar të Rilindjes, shkrimtarë e publicistë shqiptarë e të huaj e kanë vlerësuar këtë shkollë si arritja më e madhe e Rilindjes dhe e kanë emërtuar: “Fole Kombëtare” apo “Fonar ndriçues i Shqipërisë”, “Ndera e Mbretërisë”, “Rubin e diamant”, “Tempull i shenjtë”, “Altar kombëtar i shqiptarizmit”, “Far i bregdetit”, “Një shkollë e formës amerikane”, “Fidanishte mësuesesh” etj, etj. Këto vlerësime të shumta janë gjetur kudo ku kanë qenë të strukturuar: në libra, arkiva, gazeta të kohës dhe me elegancë është sjellë ekstrakti i tyre nën tituj grishës. Keni në dorë një libër elegant, të shkruar me një stil që të josh për ta lexuar (stili i njohur i autorit), ku 130 vite histori vijnë pothuaj në 150 faqe libri, foli ndër të tjera Akademiku Shkurtaç. Pasi të pranishmit i përshëndeti edhe autori, Dr. Gjovalin Gjeloçi, i cili i falenderoi ata për pjesëmarrjen, promovimi i librit u kthye në një bashkëbisedim me studentët.



Elmi Berisha, President i Federatës Panshqiptare “Vatra”, nderohet me Medaljen “Mirënjohja e Përvjetorit të Artë”



Zoti Elmi Berisha është një personalitet i shquar, me vizione dhe rol të spikatur në drejtimin e Federatës Pan-Shqiptare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “VATRA”, me një rol të veçantë për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Ai ka kontribute të njohura në evidentimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të qëndrueshme institucionale ndërmjet VATRA-së dhe Kolegjit Universitar “Qiriazi”, si dy institucione që kanë të përbashkëta ikonat patriotike dhe të arsimit tonë kombëtar, Sevasti & Parashqevi Qiriazi dhe Kristo Dako, figura të cilat janë trashëgimia historike e Kolegjit Universitar “Qiriazi”.

Në prag të kremtimit të “Përvjetorit të Artë”, në sallën “Charles R. Crane”, të Kolegjit Universitar “Qiriazi”, në Kodër-Kamëz, u organizua ceremonia e dhënies së Medaljes “Mirënjohja e Përvjetorit të Artë”, z. Elmi Berisha, President i Federatës Panshqiptare “Vatra”, në SHBA. Medalja me motivacionin: “Në vlerësim të kontributit të Tij të çmuar dhe vlerat e treguara në drejtimin e Federatës Pan-Shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “VATRA”. Personalitet i shquar, me vizione dhe rol të spikatur për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Shteteve të




Bashkuara dhe Shqipërisë. Për konsolidimin e lidhjeve institucionale ndërmjet VATRA-së dhe Kolegjit Universitar “Qiriazi”, si vazhdimësi historike me ikonat e arsimit tonë kombëtar, Sevasti & Parashqevi Qiriazi dhe Kristo Dako, që janë trashëgimia e Kolegjit Universitar “Qiriazi”, por edhe pjesë e historisë së Federatës Pan-shqiptare “Vatra”, e akorduar nga Senati Akademik, iu dorëzua nga Presidenti i këtij Kolegji, Prof. Dr. Gjokë Uldedaj. Në ceremoninë e dekorimit të z. Berisha, merrnin pjesë studentë dhe pedagogë të këtij universiteti. Të pranishëm ishin edhe Dr. Naim Dedushaj, drejtor i Rrjeteve të Bizneseve të Diasporës Shqiptare dhe Hazis Vardar, biznesmen, kryetar i Rrjetit të Bizneseve në Francë, të cilët shoqëronin kryetarin e “Vatrës” në turneun e Tij. Gjithashtu ishin të pranishëm edhe Robert Dako, nipi i Sevasti e Kristo Dakos dhe themelues i “Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Sevasti e Parashqevi Qiriazi”; Irfan Hysenbelliu, President i “Hysenbelliu Group”; Maksim Meço, rektor i Kolegjit Universitar “Qiriazi”; Kadri Morina, president i INSIG, biznesmen e humanist dhe të tjerë.

Z. Berisha duke përshëndetur të pranishmit tha, se ndihet i nderuar që pikërisht nga Kolegji Universitar “Qiriazi”, merr një vlerësim të tillë. “Vatra” me “Qiriazin”, u shpreh ai, kanë të përbashkët kontribuesit: motrat Qiriazi dhe rilindasin Kristo Dako, i cili në një kohë ka qenë kryetar i kësaj Federate dhe redaktor i “Diellit”, organit legjendar të “Vatrës”. Miku nga Shtetet e Bashkuara, tha në vijim se, dy institucionet tona, “Vatra” dhe “Kolegji Universitar Qiriazi”, mund të bëjnë më shumë për vlerësimin e këtyre figurave emblematisht të Rilindjes dhe të arsimit kombëtar shqiptar. Përpara se të hapnin Institutin Femëror “Qiriazi” në Kodër-Kamëz, në afërsi të Tiranës, të tre themeluesit dhanë një kontribut të çmuar në organizimin e mësimit të gjuhës dhe të shkrimit shqip, në mesin e diasporës në Shtetet e Bashkuara.

Presidenti Uldedaj e garantoi kryetarin Berisha, se institucioni Tij, do të jetë gjithmonë e më tepër në krah të Federatës Panshqiptare “Vatra”, për përmbushjen e misionit të saj edhe si kontributore në realizimin e projekteve të përbashkëta.

OMGJ-të: Pro dhe kundër



Prof. Dr. Klementina Puto
Departamenti i Bioteknologjisë
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Universiteti i Tiranës

Histori e shkurtër e kulturave OMGJ

Organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ) janë organizma të gjallë që kanë ndryshuar gjenet e tyre e njohur sot si "bioinxhinieri" apo inxhinieria e gjeneve.

OMGJ-të mund të jenë kafshë, bimë ose baktere, por më shpesh ato janë kultura bujqësore si misri, patatet etj. që janë modifikuar në laborator për të rritur sasinë ose cilësinë e produktit për të cilin ato kultivohen.

Por çfarë janë kulturat OMGJ? Pas përcaktimit nga James Watson and Francis Crick se ADN-ja është mbartëse e informacionit gjenetik në qelizë, revolucioni në bioteknologji ka ardhur duke u sofistikuar. Aplikimet teknologjike klasike të cilat përdorin sisteme biologjike të gjalla apo derivate të tyre, në bioteknologjinë moderne përfshihen teknika "in vitro" të acidit nukleik.

Kështu inxhinieria gjenetike bëri të mundur që të shfrytëzojë organizmat e gjalla për të prodhuar produkte të tjera më të vlefshme. Pra, bioteknologjia moderne ka të bëjë me ndryshimin e ADN-së së një qënieje të gjallë për të ndryshuar karakteristikat e saj.

Pas përcaktimit të ADN-së, më 1953, si mbartëse e informacionit gjenetik, shkencëtarë të ndryshëm mundësuan kalimin e gjeneve të zgjedhur për një tipar të caktuar në organizma.

- Kështu më 1973: Biokimistët Herbert Boyer dhe Stanley Cohen zhvilluan inxhin-



ierinë gjenetike duke futur ADN nga një bakter në një tjetër.

- Më 1982: FDA miratoi produktin e parë të konsumit OMGJ të zhvilluar përmes inxhinierisë gjenetike: insulinën njerëzore për trajtimin e diabetit.
- Më 1986: Qeveria federale e SHBA, krijoi Kornizën e Koordinuar për Rregullimin e Bioteknologjisë. Kjo politikë përshkruan se si Administrata e Ushqimit dhe Barnave e SHBA (FDA), Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të SHBA (EPA) dhe Departamenti i Bujqësisë i SHBA (USDA) punojnë së bashku për të rregulluar sigurinë e OMGJ-ve.
- Më 1992: Politika e FDA-së thotë se ushqimet nga bimët OMGJ duhet të plotësojnë të njëjtat kërkesa, duke përfshirë të njëjtat standarde sigurie, si ushqimet që rrjedhin nga bimët e rritura tradicionalisht.
- Dhe më 1994: Prodhimi i parë OMGJ i krijuar përmes inxhinierisë gjenetike - një domate OMGJ - bëhet e disponueshme për shitje pasi studimet e vlerësuara nga agjencitë federale vërtetuan se është po aq e sigurt sa domatet e prodhuara tradicionalisht.
- Pas viteve 1990: Një numër produktesh OMGJ, të krijuara përmes inxhinierisë gjenetike u bënë të disponueshme për konsumatorët, si: kungulli veror, soja, pambuku, misri, papajat, domatet, patatet dhe kanola. Por edhe sot jo të gjitha janë ende në dispozicion për shitje.^[13]

Pyetja që lind është: si përftohet një bimë OMGJ?

Hapave që duhet për të krijuar bimë OMGJ, rezistent ndaj insekteve (marrim si shembull), i cili quhet edhe "misri Bt" janë si më poshtë:



Bacillus thuringiensis

a. Identifikimi

Fillimisht identifikohet tipari që duam të ketë ajo bimë, rasti konkret rezistenca ndaj insekteve. Pastaj, kërkohet një organizëm (bimë, kafshë ose mikroorganizëm) që e ka atë tipar në gjenet e tij. Është identifikuar kohë më parë se bakteri i tokës *Bacillus thuringiensis* (Bt), prodhon një insekticid natyral që ka qenë në përdorim për shumë vite në bujqësinë tradicionale dhe organike. Duke e futur këtë gjen arrihet të krijohet misër rezistent ndaj insekteve. Në këtë mënyrë merret një bimë e cila tashmë nuk spërkatet me pesticide të cilat lënë mbetje në produkt e njëkohësisht ndot ambientin.

b. Kopjo

Pasi shkencëtarët gjejnë gjenin me tiparin e dëshiruar, gjenin për rezistencën ndaj insekticideve, ata e kopjojnë atë gjen. Ky gjen prodhon një proteinë që vret insektet dëmtuese, duke ndihmuar në mbrojtjen e misrit nga dëmtimi.

Për misrin Bt, kopjohet gjeni Bt që siguron tiparin e rezistencës ndaj insekteve (krimbave të misrit).




(Gjeni me interes)

c. Fut

Më pas, ky gjen i përzgjedhur futet në ADN-në e bimës, pra gjenin Bt në ADN-në e misrit.

Misri fiton tiparin e rezistencës ndaj insekteve.



(Gjeni që futet në bimë)

10 ushqimet kryesore të modifikuara gjenetiki



d. Rritja e bimës

Fillimisht bima rritet në laborator e më pas në fushë.

Ky tipar i ri nuk ndryshon tiparet e tjera ekzistuese. Thëksojmë se proceset për krijimin e një bime, kafshësh ose mikroorganizmi OMGJ mund të jenë të ndryshme.

Përfitimet e bimëve OMGJ

Në vitin 2018, rreth 92% e misrit dhe 94% e sojës të rritur në SHBA, vinin nga farat e modifikuara gjenetiki.

Ka shumë përparësi të kulturave OMGJ, por disa grupe kanë ngritur shqetësime se OMGJ-të mund të kenë efekte negative shëndetësore. Po cilat janë mendimet pro dhe kundër, apo të mirat dhe të këqijat e ushqimeve OMGJ dhe nëse duhet t'i shmangim ato.

Mendimet pro dhe kundër

Në rastin që morëm si shembull mendimet, pro do të ishin:

1. Mendimet pro kulturave OMGJ, sot theksojnë faktin se ato madje rrisin sigurinë e ushqimeve të zakonshme. Bima është më e shëndetshme dhe si e tillë mund të ketë më shumë lëndë ushqyese. Ky konkluzion vjen nga provat dhe testimet të bëra për

gati 30 vjet pune në laborator, por edhe në kërkime në terren. Nuk ka raste që këto produkte të kenë sjellë shqetësime apo probleme. Madje Martina Newell-McGoughlin, Drejtore e Programit të Kërkimit dhe Edukimit të Bioteknologjisë në Universitetin e Kalifornisë, tha se "OMGJ-të janë testuar më mirë se çdo produkt i prodhuar në historinë e bujqësisë".^[1]

2. Studimet e shumta në mbarë botën nuk kanë konfirmuar apo verifikuar asnjë rast të një sëmundjeje që të ketë origjinën nga ushqimet OMGJ.^{[2][3]}
3. Madje sot po punohet për të prodhuar bimë apo produkte të inxhinieruara gjenetiki për të reduktuar alergjenët dhe toksinat natyrore. Kështu biologu molekular Hortense Dodo, inxhinieroi gjenetiki një kikirik hipoalergjik, i cili inhibon apo shtyp proteinën që mund të çojë në një reagim vdekjeprurës të njerëzit me allergji ndaj kikirikut.^[4]
4. Shpesh kostua është më e vogël, për efekt të mospërdorimit të pesticideve etj. Kulturat OMGJ jo vetëm sigurojnë një çmim më të ulët të produktit, por përmirësimi i cilësisë dhe rritja e sasisë së ushqimit ndihmon në zbutjen e urisë në botë. Programi Botëror i Ushqimit, ndihmohet nga këto produkte, në kushtet kur ka miliona njerëz të varfër në botë, të ngrohjes globale, rritjes e shpejtë e popullsisë, pakësimit të ujit në tokë etj.

5. Përdorimi i më pak pesticideve të cilat lënë mbetje dhe ndotin mjedisin, madje dhe emetim më i ulët i karbonit. Më shumë se 80% e misrit të rritur në SHBA është misri OMGJ Bt, i cili prodhon insekticidin e tij *Bacillus thuringiensis* (Bt). Kjo ka reduktuar nevojën për spërkatje të insekticideve mbi fushat e misrit me 35%, dhe dhjetëra studime kanë treguar se nuk ka shqetësime mjedisore apo shëndetësore me misrin Bt.^{[5][6][7][11]}
6. Mendohet se popullsia globale pritet të rritet me dy miliardë deri në vitin 2050. Pra rritja e popullsisë është shumë më e shpejt se sa produktet ushqimore në përdorim. Lind pyetja: nga do të sigurohet ushqimi shtesë? Nuk mund të sigurohet nga sipërfaqe më të mëdha toke, pasi toka në dispozicion në planetin tokë aktualisht është pothuaj e shfrytëzueshme. Atëhere nevojitet të hapim toka të reja. Kjo realizohet nëpërmjet shpyllëzimeve. Në kohën kur flitet për ngrohje globale, shpyllëzimi do të ndikontë edhe më në rritje të temperaturave. Pra, ajo që do t'i duhet njerëzimit është, më shumë prodhim. Dhe kjo, sipas të gjitha gjasave, do të kërkojë kultura OMGJ.^[11]

Mendimet kundër (rreziqet dhe paragjykimet)

1. Mund të krijojnë efekte alergjike. Një artikull në Food Science and Human Welfare tha: "Tre rreziqet kryesore shëndetësore që mund të lidhen me ushqimet GM janë: toksiciteti, alergjia dhe rreziqet gjenetike".^[9]
2. "Kulturat tolerante ndaj herbicideve reduktojnë shumëllojshmërinë e barërave të këqija brenda dhe përreth fushave, por kjo gjë që mendohet se redukton habitatin dhe ushqimin për specie të tjera të rëndësishme, apo prishja e ekuilibrit të zinxhirëve ushqimor në një habitat".^[10]
3. Mund të rritin rezistencën ndaj antibiotikëve. Kjo nuk mund të jetë e drejtëpërdrejtë, por mund të formohen super bakteret që bëhen më agresive dhe rezistente ndaj

antibiotikëve.

4. Edhe vetë shkencëtarët ende nuk e dinë se cilat mund të jenë efektet afatgjata të konsumit të konsiderueshëm të kulturave OMGJ. [8] "Kushdo që di për gjenetikën e di se ka shumë gjëra që ne nuk i kuptojmë. Ne gjithmonë zbulojmë gjëra të reja ose zbulojmë se gjërat që besuam nuk ishin në të vërtetë të drejta." Për shkak të mungesës së testimit, ne mund të mos kemi gjetur ende rreziqe të veçanta në ushqimet OMGJ, por kjo nuk i bën ato të pasigurta për t'u konsumuar.^[11]

Referenca:

1. Best Food Facts, "GMOs and Human Health," best-foodsfacts.org, Apr. 18, 2018
2. Alan McHughen, "GMO Safety and Regulations," geneticaliteracyproject.org, Dec. 16, 2014
3. David H. Freedman, "The Truth about Genetically Modified Food," scientificamerican.com, Sep. 1, 2013
4. Becky Ferreira, "This Food Scientist Wants to Save Lives with a Hypoallergenic Peanut," vice.com, Jan. 26, 2018
5. Genetic Literacy Project, "Which Genetically Engineered Crops and Animals Are Approved in the US?" gmo.geneticaliteracyproject.org (accessed July 22, 2019)
6. United States Department of Agriculture Economic Research Service, "Recent Trends in GE Adoption," ers.usda.gov, July 16, 2018
7. Michael S. Koach, Janson M. Ward, Steven L. Levine, James A. Baum, et al., "The Food and Environmental Safety of BT Crops," ncbi.nlm.nih.gov, Apr. 29, 2015
8. Consumer Reports, "GMO Foods: What You Need to Know why Is There So Much Fuss Over Genetically Modified Ingredients? This will Help You Sift Through the Facts.," consumerreports.org, Feb. 26, 2015
9. Chen Zhang, Robert Wohlueter, and Han Zang, "Genetically Modified Foods: A Critical Review of Their Promise and Problems," sciencedirect.com, Sep. 2016
10. Canadian Biotechnology Action Network (CBAN), "Are GMO Crops Better for the Environment?" gmoenquiry.ca, May 2015
11. Jennifer Kahn, "Learning to Love G.M.O.s," ny-times.com, July 20, 2021
12. written by Madeline Kennedy an evidence-based comparison of genetically modified foods. Updated Oct 24, 2022,
13. www.fda.gov/feedyourmindScience and History of GMOs and Other Food Modification Processes. FDA, U.S. FOOD & DRUG

Auditori, laboratori dhe praktika-çelësi i suksesit të studentëve

*Prof. Dr. Abdyl Sinani
Drejtor i Kolegjit të Lartë
Profesional*



Në Kolegjin Profesional të Lartë, të Universitetit “Qiriazi”, i kushtohet një vëmendje e cilësuar gërshetimit të mësimit me punët laboratorike dhe praktikat në entet e përpunimit të produkteve ushqimore.

Teknologjia e përpunimit të ushqimit është një koncept që ka të bëjë me aplikimin e shkencës së ushqimit, në përzgjedhjen, konservimin, përpunimin, paketimin, shpërndarjen dhe përdorimin e një ushqimi të sigurtë. Shkenca e ushqimit studion përbërjen fizike, biologjike dhe kimike të ushqimit, studion shkaqet e prishjes së ushqimit si dhe koncepte të përpunimit të ushqimit. Teknologët ushqimorë dhe studiuesit e ushqimit aplikojnë disiplina të tilla si: kimi, inxhinieri, mikrobiologji apo edhe aspektin ushqyes për të përmirësuar sigurinë ushqimore, vlerat ushqyese si dhe disponueshmërinë e ushqimit në çdo kohë.

Ushqimi që ne konsumojmë...

Ushqimi është thelbësor në jetën e gjithësecilit. Ai siguron lëndë ushqyese jetësore për mbijetesë dhe ndihmon trupin të funksionojë dhe



Profesor Abdyl me studentë të programit Teknologji Ushqimore

të mbetet i shëndetshëm. Ushqimi përbëhet nga makroelementë siç janë proteinat, karbohidratet dhe yndyrnat të cilat jo vetëm ofrojnë kalori për të furnizuar trupin dhe për t'i dhënë energji, por luajnë role specifike në ruajtjen e shëndetit. Ushqimi gjithashtu furnizon organizmin dhe me mikroelementë (vitamina dhe minerale) dhe fitokimikate që nuk japin kalori, por shërbejnë për një sërë funksionesh kritike për të siguruar që trupi të funksionojë në mënyrë optimale. Ushqyerja është procesi me anë të të cilit trupi përdor ushqimin për rritjen dhe mbajtjen e tij të shëndetshëm. Objektivi i ushqyerjes është të nxisë rritjen dhe zhvillimin fizik mendor të qenies njerëzore, të ndërtojë dhe riparojë indet dhe qelizat e dëmtuara nga infeksionet, të sigurojë energji për kryerjen e punëve, të mbrojë organizmin e njeriut nga infektive apo çrregullime të ndryshme.

Cilësia dhe siguria ushqimore ...

Shpeshherë konceptet “cilësi dhe siguri ush-

qimore” ngatërrohen me njëri-tjetrin. Edhe pse siguria dhe cilësia janë shumë të lidhura, ndërmjet tyre ka një ndryshim të madh. Siguria ushqimore mban të sigurtë shëndetin e konsumatorit ndërkohë që cilësia ushqimore mban konsumatorin të kënaqur. Siguria ushqimore i referohet aplikimit të praktikave dhe kushteve të mira gjatë përgatitjes, përpunimit apo ruajtjes së ushqimit, në mënyrë që të pengohet kontaminimi si dhe sëmundjet me burim ushqimin. Ushqimi i përpunuar sipas praktikave të sigurta, siguron që ushqimi nuk do të jetë një risk për shëndetin e konsumatorit. Cilësia e ushqimit i referohet veçorive dhe karakteristikave të një produkti ushqimor të cilat duhet të jenë:

- Të pranueshme nga konsumatorët dhe të përmbushin pritshmëritë e tyre
 - Raporti çmim/cilësi brenda normave
 - Përputhshmëri me specifikimet e kërkuara nga konsumatori
 - Fitimprurëse për kompaninë
- Teknologët e ushqimit, zhvillojnë dhe

mbikëqyrin prodhimin e lëndëve bujqësore, blegtorale e ushqimore. Ata studiojnë vetitë fizike, kimike dhe biologjike të ushqimit dhe nëpërmjet diagramave të përpunimit, realizojnë prodhimet ushqimore sipas kërkesave të konsumatorit, nga vlerat ushqyese deri te kushtet e ruajtjes. Ata sigurojnë që produktet ushqimore të prodhohen në mënyrë të sigurt, të ligjshme dhe të jenë të cilësisë së dëshiruar, konform rregullave e ligjeve në fuqi. Ata gjithashtu mund të punojnë në laboratorë eksperimentalë për të bërë të mundur krijimin e recetave të reja, për produkte të reja ushqimore dhe të përmirësojnë cilësinë e produkteve ekzistuese. Ata gjithashtu mund të zhvillojnë ose përmirësojnë përpunimin, paketimin, ruajtjen dhe sigurinë e ushqimit në përputhje me standardet e qeverisë dhe industrisë. Teknologët e Ushqimit janë përgjegjës për sigurinë dhe cilësinë e produkteve që mijëra njerëz mund të hanë çdo ditë. Kjo është një përgjegjësi e madhe, në kushtet e sotme për t'iu përshtatur kërkesave specifike dietike. Teknologët e ushqimit gjithashtu siguro-

jnë përbërës për produktet, si dhe gjetjen e mënyrës më të mirë për të kombinuar, përpunuar, ruajtur ushqimin në mënyrë që të ruhet shija dhe vlera ushqyese.

Histori e shkurtër suksesi: Si e ngritëm programin e TU

Teknologët e Ushqimit përdorin një larmi pajisjesh teknologjike, kërkimore laboratorike dhe shkencore, për të bërë të mundur analizën e lëndëve të para dhe produktit të gatshëm. Si u zhvilluam programin e studimit “Teknologji Ushqimore” në Kolegjin Universitar Qiriazi? Së bashku me Profesor Gjokën, (Presidentin e Universitetit), menduam se duhet të punonim në tre drejtime:
Së pari, të kishim pedagogët e kualifikuar dhe të zotëronim një literaturë të pasur.
Së dyti, duhej laboratorit i Teknologjisë, Kimisë dhe Baktereologjisë
Së treti, duheshin kontratat me fabrikat prodhuese, ku të bënin praktikant mësimore studentët.



Në laboratorin e Teknologjisë Ushqimore

Për përzgjedhjen e pedagogëve, nga ana jonë u bashkëpunua me Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ku plotësuam të gjithë numrin e pedagogëve. Për fillimin e mësimit, përgatitëm sillabuset për secilën lëndë. Pengesë në këtë kohë ishte mungesa e laboratorit. Me një punë dhe bashkëpunim me industrinë ekzistuese në Tiranë, ngritem laboratorin Teknologjiko-kimiko-biologjik. Me lidhjen e disa kontratave dhe marrëveshjeve (kemi mbi 20 kontrata bashkëpunimi e marrëveshje të ndërsjellta) me disa nga entet më të mira të kësaj industrie, ne përfunduam të tri pikat e nevojshme që studentët të merrnin njohuritë e domosdoshme për një teknolog ushqimor. Të gjitha këto bënë të mundur që programi Teknologji Ushqimore, si pjesë e Kolegjit Profesional të Lartë, të akreditohej nga Ministria e Arsimit.
Në këtë zinxhirë studimi dhe kualifikimi, laboratorit është hallka më e rëndësishme. Ai jep mundësinë e lidhjes së njohurive teorike me praktikën. Ndaj edhe ishte detyrë kryesore e jona, projekti për ndërtimin dhe sigurimin e tij. Në këtë sipërmarrje patëm ndihmën e disa prej drejtuesëve të fabrikave ushqimore që operojnë në Tiranë. Fillimisht siguroam mullirin bluarës të drithrave, një peshore hektolitrike dhe nga një firmë greke, një Aparat Petron që bënë gjashtë analiza si: proteinat, gluteni, falling number, lagështinë, peshën hektolitrike etj. Pastaj plotësimi i mëtejshëm i laboratorit vijoi me paisjet e brumrave, si: brumgatuesen, fermentuesen dhe gjithë pajisjet që duheshin. Për cilësinë reologjike të miellrave morëm Farinografin, përcaktimin e alfaamilazës. Për analizat e qumështit u pajisëm me aparatit që bënë 5 analiza. Po kështu u pajisëm me aparatit krioskopik ku përcaktohet pika e ngrirjes së qumështit. Pajisje të tjera: furrë mufel, ku bëhen analizat e hirit të produkteve ushqimore e sidomos të fallsifikimit të miellit integral. Refraktometër për alkoolin dhe për kripën, Pehash metër për aciditetin, paisjet e laboratorit bakterologjik etj.
Aftësimi i studentëve, për kryerjen e analizave të tilla si: përcaktimi i papastërtive në drithëra, përcaktimi i peshës hektolitrike, përcaktimi i qelquritit me Farinotom, përcaktimi i

lagështisë me thermostat dhe me Aparatin petron, përcaktimi i sasisë së hirit me Furrë Mufel, përcaktimi i Ph me pehashmetër, përcaktimi i aciditetit të titullueshëm, përcaktimi i glutenit, përcaktimi i proteinave, përcaktimi i cilësisë së miellit me Farinograf, përcaktimi i alfaamilazës apo praktikimi në funksionimin e brumgatueses, fermentueses, furrëpjekies, refraktometrit për matjen e sheqerit e kripës; analizatorit për qumështin me 6 tregues, Aparatit të Krioskopisë për fallsifikimin e qumështit, peshoreve të ndryshme, aparat-eve për përcaktimin e mikroorganizmave, mikroskopëve etj, bëhet brenda laboratorit të Kolegjit Profesional. Studentët e diplomuar tek ne në programin e Teknologjisë Ushqimore, kanë qenë konkures seriozë në të gjitha rastet e punësimeve në fabrikat e përpunimit. Ku punojnë të diplomuarit tanë? Teknologët e ushqimit kryesisht punojnë në fabrikat e përpunimit, për të drejtuar prodhimin e ushqimit dhe, varësisht nga roli i tyre specifik, punojnë në laboratorë, zyra ose fabrika. Në varësi të rolit, ata kalojnë shumë kohë jashtë laboratorit duke kryer testime të pavarura në burimin e përgatitjes së ushqimit. Atyre mund t'u kërkohej të punojnë në ambiente, ku në të vërtetë mbahen ushqime dhe produkte ushqimore, të cilat duhet të jenë të pastra, sterile dhe të ndriçuara mirë. Ata zakonisht punojnë me orar të rregullt, por mund të pritët që të punojnë me orë më të gjata për të përmbushur afatet. Ndonjëherë nga ata mund të kërkohej që të kryejnë teste laboratorike në kohë jashtë pikut, siç janë netët ose fundjavat. Atyre gjithashtu mund t'u kërkohej të udhëtojnë për të provuar produkte ose për të marrë pjesë në konferenca. Ndër përgjegjësitë dhe aftësitë e teknologut, mund të përmendim:

- Përmirësojnë ose zhvillojnë ushqime dhe pije të reja.
- Bëjnë mostrat e testeve të produkteve ushqimore dhe kryejnë prova.
- Përmirësojnë efikasitetin e proceseve prodhuese.
- Sigurojnë që produktet ushqimore të plotësojnë specifikat dhe standardet e cilësisë dhe të sigurisë
- Hetojnë vlerat ushqyese të ushqimeve.

EKONOMIA INFORMALE DHE EVAZIONI FISKAL - PROBLEME DHE SFIDA



*Prof. Dr. HALIT XHAFI
Dekan i Fakultetit të Ekonomisë,
Kolegji Universitar Qiriazi*

Sektori informal ofron mundësi mbijetese, startimi në ecurinë e bizneseve për individë, të varfër dhe sipas statistikave botërore, ka rritje të ndjeshme pas viteve 60-të. Formalizimi i këtij sektori konsiderohet sfidë, proces që kërkon hapa e angazhim ligjor, institucionale dhe mbarë shoqërore.

Literatura dhe praktikat botërore sugjerojnë disa metoda të matjes së ekonomisë informale, mbi bazën e të cilave ndërtohen strategji, politika apo hapa institucionale e ligjor për formalizimin e saj, mbajtjen nën vëzhgim, menaxhimin e saj brenda parametrevë të gjykuar si të arsyeshëm.

Historiku i ekonomisë informale në vendin tonë lidhet me të gjitha hapat e zhvillimit ekonomik gjatë tranzicionit. Në vitet e para pati mbyllje masive të vendeve të punës. Në vijim u pasua nga lëvizje demografike drejt qyteteve të mëdha, ku mbijetesa ishte e lidhur në masë të madhe me iniciativat biznese

individuale. Pati politizim të administratës shtetërore e ndërhyrje në vendimarrjen e bizneseve, që detyruan shumë prej tyre të marrin vendime jashtë kontrollit shtetëror e tatimor; krijimi një legjislacioni të ri të brishtë, por që lë hapsira për nivel të lartë ekonomie informale; strukturat institucionale e fiskale të pakonsoliduara si dhe investimi në teknologji që vështirëson punën për evidentimin dhe mbylljen e shtigjeve të informalitetit; kultura fiskale e dëmtuar rëndë nga sistemi ekonomik që kaluam etj.

Duke mos bërë kritizerin për çdo iniciativë e fenomen informaliteti, në periudha të caktuara gjykojmë se ekonomia informale ka qenë një valvul shkarkimi dhe mbijetese ekonomike për një sërë familjesh, pasi starti nga u nisën mjaft biznese dhe niveli i pabarabartë i çmimeve, sidomos nga importi, linte pak hapësira për rentabilitet të kënaqshëm e nxitës për bizneset, kjo për shkak të fuqisë blerëse të vogël në Shqipëri, si rrjedhojë e pagave të ulta. Mjaft shërbime apo edhe prodhime në përmasa të vogla në treg, kanë qenë e janë objekt informaliteti

Ka një ligjësi mbarëbotërore: vendet me tatime e taksa më të ulta kanë prirje të ulin informalitetin. Po ashtu, edhe lehtësimi i procedur-

ave burokratike për regjistrimin e bizneseve dhe lehtësimet në fushën fiskale. Qeveritë e pastranzicionit kanë bërë hapa në këtë drejtim e ka edhe përmirësime. Sidoqoftë niveli i lartë i informalitetit, sipas organizmave ndërkombëtare në mbi 35 përqind, flet shumë për mangësi dhe eficiencë të pamjaftueshme të politikave të ndërmarra dhe hapave institucionale e ligjor.

Ndërkohë ka një lidhje të fortë midis informalitetit dhe shkallës së korrupsionit në vend, në të gjitha hallkat. Vendet me korrupsion të lartë, sipas vrojtimeve e përlogaritjeve nga institucione të specializuara, kanë më shumë informalitet. Lufta ndaj korrupsionit, forcimi institucioneve shtetërore e ligjzbatuese, rritja e ndërgjegjes qytetare, modernizimi i administratës publike, funksionimi i saj mbi baza ligjore e jo klienteliste, sidomos në tatime e dogana, çojnë në ulje graduale të informalitetit.

Sipas FMN, ekonomia informale lidhet edhe me produktivitetin e ulët, varfërinë, papunësinë e lartë dhe rritjen e ngadaltë ekonomike. Ulja e kostove të të bërit biznes, trajtimi i korrupsionit dhe përmirësimi i aksesit në financa e shërbime, janë hapa ku ambjenti ekonomik shqiptar kërkohet të lëvizë. Shpesh herë parashikimet makroekonomike kompromentohen nga faktorë informal dhe evazioni fiskal, që prishin ekuilibrat dhe vështirësojnë manaxhimin e financave publike, buxhetit të shtetit dhe klimën e biznesit në tërësi. Mjafton të përmendim luhatjet e kursit të këmbimit, uljen e dukshme të kursit të këmbimit të euros e dollarit ndaj lekut këta muaj të 2023, e të gjykojmë se krahas faktorëve tashmë të konsoliduar, si industria e turizmit që ka shënuar rritje, ka një dozë informaliteti të pakontrolluar në industrinë e ndërtimit, qiradhënien e kapaciteteve turistike individuale, hyrje të pamatur si duhet të valutës nga remitancat etj. Nga fundviti i kaluar deri më 25 qershor 2023, pra duke përfshirë edhe fushatën elektorale, kursi i euros ndaj lekut, ra në 107 lekë/euro nga mbi 120 lekë që ishte pak muaj më parë dhe dollari po ashtu nga rreth 115 lekë/dollar në 98 lekë. Prej vitesh, vendi po ndesh një nivel të lartë informaliteti dhe hyrje të

valutës nga burime të panjohura, që po nxjerr jashtë kontrollit treguesit makroekonomik tradicional. Në plan makroekonomik kjo situatë ka favorizuar importuesit dhe ka goditur eksportet tona. Në një plan disi të mëvonshëm, rrit varësinë ekonomisë nga importet dhe dekurajon prodhimin vendas, e çon në pasoja në bilancin e pagesave. Informaliteti është “de facto” përgjigje ndaj mangësive në ambientin institucionale. Korrupsioni paraqitet në kufijtë mes ekonomisë formale dhe joformale, ku bizneset dhe individët paguajnë ose kapin institucionet për të mbetur të fshehur dhe/ose për të mos patur detyrime, ose për të patur një legalizim më të lirë dhe më të lehtë, në rastet kur ai është i pashmangshëm

Evazioni fiskal përfshin fshehjen apo shmangien me dashje të detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosevidentimit të shitjeve e shpenzimeve për efekt deklarimi në sistemin fiskal, falsifikimin e dokumentacionit kontabël dhe tatimor, krijimit fiktiv të dokumentave të falsifikuara për rritjen fiktivisht të shpenzimeve të biznesit ose të TVSH-së së zbritshme, fshehja e të ardhurave, me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi i detyrimeve tatimore.

Të gjithë flasin për “taksat e ulëta”, por në fakt problemi tek ne nuk janë taksat e larta, problem ngelet pabarazia fiskale (taksim i punës i lartë dhe taksimi i kapitalit i ulët). Pasi, falë reduktimit të tyre do të zgjidheshin të gjitha problemet. Përtej kësaj, politikat fiskale nuk mund të funksionojnë përderisa ka evazion fiskal të lartë e në të tilla kushte rritja e punësimit, shëndetësia, arsimit dhe investime të tjera, janë të vështira për t’u realizuar, në momentin që mungojnë paratë.

Nisur nga fakti që evazioni është problem mbi problemet, lindin natyrshëm pyetjet: Politikat e ndërmarra ndër vite, a kanë dhënë efektet e dëshiruara?

- Sa është shkalla e evazionit fiskal në vendin tonë?

- Çfarë ndikimi ka çdo faktor në evazionin fiskal? Sa nga ky ndikim vjen nga faktorët tradicional dhe sa nga ato institucionale? Nga hulumtimet e deritashme rreth evazionit

fiskal, a është rritur apo zgjeruar lista e faktorëve që ndikojnë në uljen e tij?

Studimet nga autorë më në zë dhe mbështetur edhe në të dhëna historike, statistika apo sjelljet i bizneseve në situata të ndryshme, i kategorizojnë faktorët e evazionit në:

Probabiliteti i auditimit dhe probabiliteti i zbulimit. Mjaft autorë e konsiderojnë probabilitetin e auditimit të barabartë me atë të zbulimit. Për të realizuar mbledhjen e taksave/tatimeve, shtetet krijojnë organet e posaçme brenda institucioneve të tyre si: doganat, administratat e tatimeve si dhe drejtori të tjera lokale apo qendrore për të mbledhur të hyrat për arkën e shtetit nga personat, subjektet apo bizneset në dobi të buxhetit të shtetit.

Masa e ndëshkimit pas zbulimit të evazionit. Edhe në këtë drejtim autorë të ndryshëm të evazionit dhe sjelljes fiskale kanë pikpamje të ndryshme. Gjobat më të mëdha çojnë në përmbushje më të lartë të objektivit të zbutjes së evazionit fiskal. Ato ndikojnë më shumë se sa shpeshimi i auditimeve, i friksojnë e stepin më shumë autorët apo subjektet evazore. Të dhënat krahasuese sugjerojnë se gjobat e larta, qoftë edhe me probabilitet më të ulët zbulimi, kanë efekt më të madh se sa gjobat e ulta me probabilitet me të lartë zbulimi. Ato orientojnë subjektet evazore për më pak mashtrime dhe me “dhunën” e ligjit dhe ndëshkimit diktojnë një sjellje më racionare e të pastër ndaj sistemit fiskal dhe ligjeve.

Mundësia për ndjekje penale. Autorë të tjerë kanë studiuar ndikimin relativ të ndëshkimeve ligjore, ndjenjën e përgjegjësive para ligjit dhe presionin social, si masë që parandalon krimin fiskal, evazionin. Nga evidencat empirike dhe studimet në një plan kohor të caktuar për një numër biznesesh në kontroll, ata arritën në përfundimin se, lidhja apo marrëdhënia midis kërcënimit për ndëshkim ligjor, deri penal dhe iniciativës, prirjes dhe veprimeve konkrete për shmangien nga tatimet e taksat është e fortë. Ndikimi i normave të tatimeve e taksave në evazion. Kurba e Laffer-it, një qëndrim e përfundim shkencor i pranuar gjerësisht nga shkenca ekonomike dhe që gjen vend në çdo trajtim shkencor makroekonomik e mikroekonomik, për raportin midis nivelit të tatimeve

Ekonomia informale ose ekonomia gri, përfaqëson atë pjesë të ekonomisë që nuk kontrollohet, e për rjedhojë nuk tatohet nga shteti. Qëndrimi ndaj tij në shoqëri të ndryshme, ka ngritje uljet e tij. Për vendet e varfëra, ku ekonomia informale është më e lartë, ajo konsiderohet hera herës shkak dhe pasojë.

dhe evazionit apo shmangies fiskale, sugjerojnë se rritja e normës së tatimeve apo barrës fiskale përtej një pike të caktuar, shkakton efektin e kundërt në evazionin fiskal, e rrit atë, pra rrit përpjekjet për shmangie fiskale e evazion. Përkundrazi, mbajtja e saj në nivele optimale është ajo që për një nivel të caktuar ngarkese fiskale, eficienta e normës tatimore në rritjen e të ardhurave maksimizohet. Natyrisht, ky përfundim jo gjithnjë dhe në çdo vend ka efekt të njëjtë. E thënë ndryshe, në vende si Shqipëria, ku ka munguar tradita fiskale dhe niveli i jetesës, fuqia blerëse e konsumatorit apo faktorë të tjerë makroekonomik, ulin ndjeshëm fuqinë konkurrese e mbijetuese të bizneseve, edhe nën këtë pikë të artë të normës apo ngarkesës fiskale, mund të ketë përpjekje për evazion fiskal. Disa studime empirike mbështesin idenë se një normë më e lartë e taksave inkurajon evazion, të tjera e vënë në dyshim këtë lidhje shkakësore. (Maria Jesus

Freire-seren, Judith Pamades, 2013) Ndërgjegjësimi i tatimpaguesit përballë evazionit fiskal. Ndërgjegjësimi fiskal lidhet me perceptimin individual, ndërgjegjen dhe kulturën e çdo qytetari në lidhje me etikën fiskale dhe me moralin fiskal të shoqërisë në të cilën ai ose ajo jeton. Ndërgjegjësimi fiskal kërkon një shkallë të dijes reflektuese në emër të qytetarit. Pra si përdoren të ardhurat publike, të krijuara nga kontributi i gjithsecilit në dobi të tij, familjes së tij, nevojave ekonomike e sociale etj. Për fat të keq Shqipëria është një shembull problematik në këtë drejtim, kjo e referuar edhe nga organizmat ndërkombëtare monitoruese. Emërimet nepotike në tatime, dogana apo administratë publike, fryrja e tyre, tenderimet publike tepër problematike përta i përket kostos, krahasuar me projekte analoge ndërkombëtare, supervizimi i papërgjegjshëm e i korruptuar i tyre etj, kanë krijuar mosbesim të qytetarit ndaj shtetit e mungesën e rregullit e ligjit. Tanzit (1993), ka formuluar marrëdhënien midis etikës sociale, raportit të shoqërisë dhe evazionit fiskal. Sipas tij, evazoni fillon atëherë kur shoqëria të fal për atë, respektivisht në ato vende ku shoqëria e miraton evazionin fiskal, ai përhapet dhe zgjerohet sepse gjithnjë e më pak njerëz shqetësohen për ekzistencën e tij. Prandja shoqëria apo qytetarët duhet të kenë përgjegjësi në parandalimin e evazionit fiskal, duke e parë evazionin si një e keqe e madhe shoqërore dhe me ndikim në ekonominë, jetën shoqërore dhe moralin e shoqërisë në tërësi.

Aspekte të politikave të administrimit fiskal në Shqipëri

Politikat fiskale në Shqipëri pas viteve 90-të, kanë qënë subjekt dhe objekt i programeve të çdo qeverie dhe herë pas here kanë pësuar ndryshime e përsosje, me synim plotësimin e funksioneve të shtetit nëpërmjet buxhetit të tij, rritjes së vetveprimit në qeverisjen lokale dhe mbështetjes së zhvillimit ekonomik, pa anashkaluar programet e mbështetjes sociale. Trajtimi i politikës fiskale është temë e gjerë, ka filozofi të ndryshme zhvillimi midis blloqeve politike, por që në fund maten me disa

parametra makroekonomik e mikroekonomik zhvillimi

Do të nënvizoj këtu disa dukuri shqetësuese: Informaliteti dhe evazoni fiskal sipas matjeve të institucioneve konsultuese e monitoruese të Shqipërisë, arrin në rreth 40 përqind të ekonomisë që është mjaft shqetësuese. Hapat fiskal fatkeqësisht kanë çuar në favorizim të më të pasurve dhe barra fiskale është spostuar drejt të varfërve. Ata janë tatim paguesit e fundit që e përballojnë. Politikat ekonomike të ndjekura, politika e koncesioneve apo partineriteteve, nuk është orientuar drejt industrive përpunuese, si rrjedhojë nafta, mineralet, gurët dekorativë eksportohen si lëndë e parë, të punësuarit shqiptarë punojnë 48 orë në javë dhe paguhen mesatarisht vetëm 40-45 mijë lekë në muaj. Paga të tilla janë nën nivelin e dinjitetit, ku nuk stimulohet konsumi dhe nuk gjenerohet zhvillim. Këtu duhet të ndërhyjë politika fiskale që ajo të jetë sa më ndikuese, në shërbim të shmangies së evazionit fiskal.

Gjykoj se ka nevojë për politika fiskale të favorshme për investitorët e huaj. Të gjitha vendet e rajonit kanë lëvizur në këtë drejtim, ndërsa ne si gjithmonë mbetemi mbrapa. Vazhdojmë të mbajmë nivelin e tatim fitimit në masën 15%, si për bizneset dhe për investitorët vendas apo të huaj, ndërkohë që Bullgaria, Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut e kanë 10%, Mali i Zi 9%, Hungaria për investimet e huaja e ka ulur tatim fitimit në masën 9%, ndërsa Serbia subvencionon një pjesë të investimit dhe pagat e investitorëve të huaj. Kroacia dhe Sllovenia japin subvencione për kompanitë që investojnë në fushën e IT etj. Njëkohësisht duhet parë dhe klima e përgjithshme, si në fushën e infrastrukturës, arsimit, korrupsionit, stabilitetit politik etj. Luftën kundër ekonomisë informale dhe evazionit fiskal duhet ta shikojmë në kushtet e Shqipërisë edhe nga pikëpamja social-kulturore dhe psikologjike. Po t'u referohemi shifrave dhe burimeve të ndryshme, për vitin 2021-2022, Shqipëria për 1 milion banorë prodhon dhe mbledh më pak të ardhura publike për të njëjtën bazë krahasimi me vendet e tjera. Për shembull Kroacia prodhon 13,4



mld e mbledh 1.3 mld usd. Shqipëria renditet e fundit në rajon duke përjashtuar vetëm Kosovën.

Nëse luftën kundër ekonomisë informale dhe evazionit fiskal do ta shohim pastër vetëm nga perspektiva e politikbërjes dhe politikave administrative, atëherë këtë luftë do ta ngremë mbi katër elemente që janë: marrëdhëniet shtet-biznes; vlerësimi i detyrimit tatimor të bizneseve dhe zbatimi i drejtë i tyre; dokumentimi i veprimtarisë së biznesit dhe modeli i administrimit me standarte dhe teknologji të përparuar dhe të integruar me trekëndëshin Doganë-Tatime-Kasë (Konsumator).

Sfida e administrimit dhe luftës kundër informalitetit e evazionit fiskal në trekëndëshin Doganë-Tatime-Konsumator, veç të tjerave kërkohet nëpërmjet teknologjisë së informacionit të fiskalizimit. Në perspektivë duhet menduar për heqjen e TVSH në doganë etj. TVSH në doganë që e paguan biznesi në formë paradhënie duhet të paguhet sipas kuptimit të këtij tatimi, kur malli krijon vlerë të shtuar, pasi shitet. Kjo mënyrë e të paguarit të TVSH-së në doganë, me argumentin se nuk mblidhet dot gjatë procesit të krijimit të vlerës, e rëndon gjendjen financiare të biznesit, sepse ai paguan një tatim që nuk

e ka realizuar. Kjo ka dhe kosto shtesë për biznesin, i cili në disa raste për të paguar këtë tatim në doganë detyrohet të marrë kredi ose overdraft.

Që të mbyllet skema e pagimit të TVSH, pagimi i saj duhet të shtrihet deri në konsumatorin përfundimtar. Nuk mund të pranojmë në heshtje si deri tani, që hallka e fundit të jetë biznesi i madh, para atij të vogël, duke regjistruar shitje fiktive me para në dorë, me kasë të improvizuar, sepse bizneset e vogla operojnë pa faturë fiskale. Që ky fakt të mos shkaktojë rezistencë si deri tani, kërkohet diferencimi me synim uljen e TVSH për artikujt e konsumit bazik e të gjerë, praktika këto të zbatuara prej vitesh në mjaft shtete të rajonit e më gjerë. Kështu kuponi përfundimtar me TVSH-në e përfshirë, do të thotë kontroll nga qindra mijëra konsumatorë, pra skema e tvsh bëhet efiçente.

Rrjedhja më e madhe fiskale është pikërisht në TVSH. Gjykojmë se tashmë që informatizimi po shtrihet në çdo fushë apo subjekt dhe janë investime të vazhdueshme në këtë fushë, kjo sfidë është e arritshme. Po ashtu, duhet studiuar heqja dhe reduktimi i mëtejshëm i referencave në doganë, për një grup të caktuar mallrash, të cilat rritin koston e

biznesit. Dogana duhet të veprojë me vet-deklarimin që bën biznesi dhe dokumentet shoqëruese që disponon, për importet nga vende të ndryshme.

Sot, kompanitë që bëjnë afro 80% të xhiros totale të bizneseve, janë në numër të kufizuar dhe ato operojnë dukshëm joformale. Informaliteti për to arrin deri në 50% të shitjeve të tyre totale. A mund të konceptohet një kompani që bën 200 milionë euro në vit dhe nuk regjistron mbi 30% të xhiros për të shmangur tatimet? Kjo po ndodh! Nuk mund të vendosen forca policie në çdo biznes për të paguar taksat! Kjo nuk është as e mirë dhe as e realizueshme. Mund të shihen hapa në një administrim e mbikqyrje të këtyre kompanive. Kërkohet rregullore për t'i bërë bizneset e mëdha të paguajnë më shumë tatime me mënyra të zgjuara gjithëpërfshirëse. Kjo mund të jetë Rregullorja e Menaxhimit të Koorporatës në vend që do të bëhet një "efekt ligjor". Sipas kësaj rregulloreje apo ligji të munguar, kompanitë e mëdha të kategorisë A, do të duhet të kenë administrim 3 nivelor: 1) bordi drejtues, 2) niveli i drejtimit ekzekutiv (CEO) dhe 3) niveli i Bordit Mbikëqyrës, që do të inspektojë e miratojë ecurinë e arritjet e manaxhimit dhe do të bëjë që biznesi të funksionojë në përputhje me rregulloret. Një bord i tillë mbikëqyrës duhet të jetë nga përfaqësues të kompanive të nivelit jo-ekzekutiv dhe të mos ketë lidhje me nivelin e aksionerëve të shoqërisë. Ata mund të jenë të huaj, nga akademja, nga sistemi ligjor, kontabilistë apo ekspertë të certifikuar, pse jo, në nivel ndërkombëtar.

Së fundi, kompani të tilla të mëdha duhet patjetër të auditohen nga ekspertë të pavarur të jashtëm të njohur ndërkombëtarisht që i raportojnë Bordit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Aksionarëve. Në këtë mënyrë do të promovohet regjistrimi i aktivitetit, qarkullimi i parasë do të jetë nën regjistrim dhe me informalitet minimal, si dhe kompanitë do të mendojnë të hyjnë e operojnë edhe në tregjet e kapitalit dhe institucionet financiare kredituese, do të marrin pjesë me dëshirë në kreditim me norma dhe kushte më të mira. Si rezultat, raporti i informalitetit do të ulet, kompanitë

do të gjejnë mënyra të tjera për të rritur fitimet e tyre, pra më shumë efikasitet, do të jenë në konkurrencë për të paguar më shumë tatime, shteti do të konsiderojë norma më të ulta tatimore për të mbledhur më shumë tatime e taksa, do të prezantojë më shumë mekanizma monitorimi "hands free" për të minimizuar konfliktet ligjore dhe arbitrazhet; grupet e interesit do të përfitojnë nga koorporatat, nëpërmjet investimeve në aksione, sistemit të karrierës dhe nivelit të performancës, më shumë paga. Biznesi do të prodhojë më shumë vlerë të shtuar e do të japë sinjale pozitive tek investitorët vendas e të huaj për të konsideruar investime të reja për zgjerim, rikonstrukcion. Sfida e luftës kundër informalitetit e evazionit mbetet e hapur.

Literatura:

1. Maria Jesus Freire-Seren, Judith Pamedes (2013). Do Higher Tax Rate Encourage/Discourage Tax Compliance. Modern Economy, 2013, 4, pp 811;
2. Vito Tanzi and Parthasarathi Shome, A Primer on Tax Evasion, 1993, vol. 40, issue 4, 815.,
3. Tomas K. Papp and Elod Takats. (2008). Tax Rate Cuts and Tax Compliance – The Laffer
4. Curve Revisited. IMF Working Paper Wp / 08/07;
5. World Customs Organisation, Customs Manual on Valuation, Updates May 2016, <http://www.wcoomd.org>
6. Ekonomia informale si barrierë për një zhvillim të qëndrueshëm nga: Prof. Asoc. Dr.Fatmir MEMA, Pedagog në
7. Abdixhiku, Lumir Determinants of business tax evasion in transition economies, . Doctoral thesis, Staffordshire University. (2013)
8. Fakulteti i Ekonomisë , UT dhe Dr. Zef PRECI, Drejtues I Q
9. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Attax>. Al, Ekonomia informale, administrate tatimore dhe minimizimi i informalitetit. 2023
10. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Altax> Al, Matja e ekonomisë informale dhe dixhitalizimi- një nevojë e menjëherëshme kundër evazionit fiskal, 2023
11. D.P.Tatimeve Tiranë, Komentari: Evazioni tatimor dhe pagesat ose arkëtimet me para në dorë.
12. Kur ekonomia informale "mposht" atë reale! Editorial i revistes Monitor, 1082, qershor 2023.
13. Prof.Dr. Agim Binaj, Fahri Dari, ekspert ekonomie: Letër publike për gabimet që çuan në tranzicionin 30 vjeçar

Qiriazët mbollën dritën e iluminizmit shqiptar



*Prof. Dr. Skender ASANI
Drejtor i Institutit të
Trashëgimisë Shpirtërore e
Kulturore të Shqiptarëve Shkup*

Në veprimtarinë time shkencore e intelektuale jam munduar të kem gjithmonë udhërrëfyes figura të shquara të Rilindjes Kombëtare, dhe nuk kam gabuar kur këtë pikë orientuese e kam gjetur te motrat dhe vëllezërit Qiriazit, të cilët mbollën dritën e iluminizmit shqiptar. Parashqevi dhe Sevasti Qiriazit bashkë me vëllezërit Gjergji dhe Gjerazimi, kishin thyer tabutë e krijuara rreth imazhit të shqiptarëve dhe me kontributin e tyre ata lartësuan historinë dhe lavdinë e shqiptarëve. Ata shpluhurosën “fotografitë” e vjetra mbi shqiptarët dhe sollën të reja, me plot pamje që ishin lajtmotivi i një zgjimi kombëtar që po trokiste në dyert e Europës.

Pikërisht, duke risjellë pak dritë më shumë në këto ‘fotografi’ të reja, ne si Institut i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, ditë më parë në Manastir kemi themeluar Departamentin rajonal të trashëgimisë kulturore, që do të mbajë emrin e familjes fisnike shqiptare Qiriazët, e që do të drejtohet nga njëri prej pinjollëve të kësaj familje. Themelimi i këtij departamenti do t’i ketë dy objektiva: në njërin anë, do të rikthehet lavdia e humbur e një qyteti siç është Manastiri, ku një shekull më parë u bë bashkimi gjuhësor i shqiptarëve, me një kontribut të jashtëzakonshëm edhe të Qiriazëve dhe në anën tjetër, rajoni i Pellagonisë të përfshihet në “radarët” e hulumtimit tonë shkencor, duke shpëtuar nga

Qiriazët shpluhurosën “fotografitë” e vjetra mbi shqiptarët dhe sollën të reja, me plot pamje që ishin lajtmotivi i një zgjimi kombëtar që po trokiste në dyert e Europës në kapërcyell të shek. 19-20.

harresa një sërë dëshmish materiale mbi të kaluarën e popullit tonë. Si pjesëmarrës direkt në disa ngjarje me interes të jashtëzakonshëm për shqiptarët, siç ishte Kongresi i Alfabetit si dhe Konferenca e Paqës në Versajë, Qiriazët vendosën themelet e oksidentalizmit kulturor të shqiptarëve. Duke u nisur nga kjo aksiomë civilizuese, edhe në Shkup u munduam të sjellim frymën e Qiriazëve, me emërtimin e disa rrugëve me emrin e Gjerasimit, Gjergjit, Parashqevi dhe Sevasti Qiriazit. Tash e tutje adresat e shk-upjanëve do të kenë rrugëtregues këta emra që paraqesin gurthemelin e ndërgjegjës sonë kombëtare në fund të shek. 19 dhe në fillim të

shek. 20, duke i dhënë frymë europiane kësaj ndërgjegje. Dhe këtë më së miri e ka përshkruar Edit Durham, pas vizitës së Shkollës së Vashave në Korçë në vitin 1903. “Shkolla e Vashave ishte kaq moderne, saqë më dukej se isha kthyer papritur në Europë”.

Ky ka qenë me një mënyrë edhe diskursi im shkencor e intelektual, kurse Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup ishte dhe mbetet promovuesi kryesor i këtij diskursi, qoftë duke organizuar konferenca tematike shkencore, qoftë duke kryer hulumtime arkivore, qoftë duke botuar vepra të veçanta, siç ishte edhe “Ditari i Parashqevi Qiriazit - Ditët e mia në Konferencën e Versajës”, i cili u botua më rastin e 50 vjetorit të vdekjes së Parasheqevi Qiriazit. Ky ditar i lënë në dorëshkrim, dëshmon për punën e palodhshme të kësaj iluministe shqiptare, e cila kësaj radhe na paraqitet si dëshmitare e gjallë e një prej ngjarjeve më vendimtare për fatet e popullit shqiptar, siç ishte Konferenca e Versajës e vitit 1919/20.

Figura emblematike e Parashqevi Qiriazit këtu ndriçohet dhe plotësohet me detaje fare të panjohura, përmes të dhënave autentike që ajo na i prezanton në ditarin e saj dhe ajo përlligj zërin më përfaqësues të gruas së shquar shqiptare, e cila, siç mund të shihet nga dëshmitë e ofruara, del të jetë edhe themeluese e diplomacisë



Për të nderuar dhe respektuar kontributin madhor të Qiriazëve, ne si ITSHKSH do të përfshijmë Manastirin në “radarët” e hulumtimit tonë shkencor, duke shpëtuar njëherësh nga harresa edhe një sërë dëshmish materiale mbi të kaluarën e popullit tonë në këtë rajon

shqiptare. Parashqevi Qiriazë ishte delegate e Konferencës së Versajës dhe ditari i saj zbulon dritë-hijet e kësaj konference përmes syrit vëzhgues dhe mjaft aktiv të saj. Ditari i Parashqevi Qiriazit nuk është thjeshtë kujtim personal i një gruaje që spikati shumë anë të njohura e të panjohura të kësaj Konference, por është edhe fryma dhe konteksti i kohës, të shqiptarëve në raport me Fuqitë e Mëdha, sidomos me SHBA-të, ku shqiptarët, me të drejtë kishin varur të gjitha shpresat. Pjesëmarrja e saj në Konferencën e Paqes në Paris shpërfaq fuqinë dhe zotimin e saj intelektual e kombëtar në arritjen e qëllimeve madhore, për të cilat Rilindësit tanë ishin përpjekur dhe flijuar. Ishte pikërisht Parashqevi Qiriazë që gjithë synimet dhe ëndrrat e Rilindësve i barti në sallonet diplomatike të kohës dhe u bë zëdhënëse e denjë e kauzës shqiptare në momentet më dramatike. Ditari i Parashqevi Qiriazit erdhi në kohën kur figura e kësaj iluministe të shquar kishte frymëzuar edhe drejtuesit e UNESCO-s për ta përfshirë atë në kalendarin e jubileve të mbështetur nga kjo organizatë për vitin 2020. Kur jemi te botimet vlen të përmenden edhe tri vepra të tjera të botuara nga ITSHKSH, “Pengu i kaçakëve” të autorit Gjeriasim Qiriazë, “Jeta

ime” të autores Sevasti Qiriazë – Dako si dhe libri dyvëllimësh monumental i autorit Xhevat Lloshi, me titull: “Gjergj Qiriazë në Kongresin e Manastirit”. Përmes kësaj veprë kuptojmë se Gjeriasim Qiriazë jetoi vetëm 35 vite, deri më 24 janar 1894, kur i mbylli sytë për të fundit herë, por porositë që ai ia la të motrës Sevastisë dhe mbarë familjes, për të vazhduar përpjekjet iluministe në emancipimin dhe edukimin e popullit në frymën e shkronjave shqipe, dhanë fryte disa vite më vonë, konkretisht më 1908 kur në Manastir u mbajt Kongresi i Alfabetit, një ngjarje kjo e madhe kombëtare që kishte kaluar nëpër dyert e shtëpisë së Qiriazëve. Gjeriasimi edhe pse nuk e arriti ta përjetojë këtë ngjarje, fryma e tij megjithatë kishte ngulur, madje e gdhendur me shkronjat shqipe në varrin e tij disa vite para Kongresit të Alfabetit. Pra, Gjeriasimi nuk ishte dëshmitar i ngjarjeve të bujshme që do të ndodhin më vonë, mirëpo nderimi ndaj tij u bë pikërisht ashtu siç e meritonte ai. Sepse vetëm kështu do të shkonte në vend amaneti i tij për një përparim iluminist, mbi baza të tolerancës me fqinjët dhe mbi vizionin për një të ardhme pa barriera dhe paragjykime në mes të popujve me diversitete fetare e etnike. Të gjitha këto vepra, përpos që sjellin histori të bujshme mbi Qiriazët, ato skicojnë edhe tabllon nga jeta sociale, kulturore e arsimore e shqiptarëve në periudha të caktuara. Dhe të ndjekësh nga afër këto histori, në fakt ke krijuar një imazh më të plotë mbi udhëtimin e vështirë dhe plot të papritura të popullit tonë. Derisa po e shkruaja këtë tekst, e kisha të freskët takimin e para disa ditëve me drejtuesit e Kolegjit Universitar “Qiriazë” në Tiranë dhe zotimin për një bashkëpunim të frytshëm në të ardhmen, edhe për faktin se familja fisnike shqiptare Qiriazët për të dy institucionet tona vazhdon të mbetet hallka që bashkon shumë ide e projekte të përbashkëta në të ardhmen. Shpresoj që mbi favorët e këtij bashkëpunimi të vendosim një rend të mirëfillt në vlerësimin e figurave tona kombëtare, të cilat jo rrallë, padrejtësisht, kanë mbetur nën hijen e inercive që sjellin zhvillimet e ditës.

Shkup, qershor 2023

Një bibliotekë në Manastir



Kolegji Universitar “Qiriazë” ju bashkua nismës së dhurimit të një sasive librash në gjuhën shqipe, për të krijuar fondin e bibliotekës që do të emërtohet “Sevasti e Parashqevi Qiriazë”

Kolegji Universitar “Qiriazë” ju bashkua nismës së dhurimit të një sasive librash në gjuhën shqipe, për të krijuar fondin e bibliotekës me libra në gjuhën shqipe, në qytetin e Kongresit të Alfabetit shqip. Dhurimi i librave u realizua në ambjentet e Universitetit, ku të pranishëm në këtë takim ishte inicitatoria e kësaj nisme, studentja Emira Selimi, e cila u shpreh se jo krejt rastësisht ndodhej në Universitetin Qiriazë, si qyteti lindjes së dy themeluesëve të Kolegjit Universitar Qiriazë, motrat Sevasti dhe Parashqevi Qiriazë, por dhe për një fakt të rëndësishëm që Biblioteka e parë Shqip do mbajë emrin e tyre. Emira Selimi është një vajzë nga Shkupi. Studion në Universitetin e Evropës Juglindore, për Shkencat Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Po ashtu merret edhe me gazetari dhe është aktiviste e shoqërisë civile. Studentja Selimi, rrëfen për sfidat me të cilat përballen shqiptarët në Manastir, duke thënë se në statistikat e regjistrimit të popullsisë, shqiptarët ishin 5 për qind, ndërsa vetëm 2 për qind prej tyre janë shqiptarë që kanë mbiemra të shqipëruar. Ideja lindi kur unë fillova të hulumtoj për shqiptarët ortodoks atje, konkretisht familjen Qiriazë. Në Manastir akoma nuk ka një shkollë të mesme në gjuhën shqipe. Ajo ka treguar se, shqiptarët atje flasin shqip me shumë pengesa, kjo si pasojë edhe e mungesës së literaturës shqipe. Një problem tjetër që Samira përmendi, është se atje nuk kanë shkollë


të mesme shqipe, dhe, sipas saj, fëmijët shqiptarë shkojnë dhe regjistrohen në shkollat maqedonase, dhe se shkolla e vetme fillore atje ku mësonin shqiptarët tash po boshatiset nga shqiptarët. Kësaj nisme tashmë i janë bashkuar shumë donatorë dhe numri i librave ka vërsuar duke u shtuar çdo ditë e më shumë. Të gjithë ato që duan të ndihmojnë mund të dhurojnë qoftë edhe vetëm një libër. “Qyteti i Alfabetit” ka nevojë për ndihmë më shumë se kurrë, thotë Emira. Ajo nuk i ka mohuar tentativat për ta penguar hapjen e bibliotekës, por, sipas saj, po dështojnë, sepse pas saj janë të gjithë shqiptarët. Z. Adriatik Kurti, kordinatori i kësaj nisme u shpreh se ishte mirënjohës për bashkëpunimin që kishte gjetur dhe solidarizimin e shqiptarëve në këtë nismë. Ndërsa pedagogu Zylfi Shehu, i cili ndihmoi së bashku me Universitetin Qiriazë në grumbullimin e këtyre librave, shprehu dhe vëndosmërinë e tij për të vazhduar edhe më tej këtë mision. Rektori i Universitetit “Qiriazë” Prof. Dr. Maksim Meço, e përgëzoi Znj. Selimi për iniciativën e ndërmarrë dhe u bë pjesë e kësaj nisme më të gjitha botimet e tij! Studentët, stafi akademik dhe administrativ, kontribuan në këtë nismë duke dhuruar libra për bibliotekën e parë shqipe, ku ndër librat e dhuruar është dhe botimi i fundit i Universitetit “Moshë e artë e një universiteti”.

Mendimi pedagogjik i Hannah Arendt (1906-1975)



PhD. Lekë Pepkolaj
Drejtues i Departamentit TIK në
Kolegjin e Lartë Profesional

Do të provoj diçka jo të lehtë: të paraqes në mënyrë sintetike një filozofe (përkufizimi asaj nuk i pëlqen), autore e shkrimeve filozofike, politike dhe sociologjike që kanë ndryshuar paradigmat në panoramën kulturore të shekullit XX. Historia e saj njerëzore, jashtëzakonisht e mbushur me ngjarje dhe takime, na përcjell mendime gjallëruese dhe entuziaste që e karakterizuan deri në fund të jetës, me qendrim të thella për vëzhgim që e shoqëruan që në vitet e para të studimit. Ajo nuk pushoi asnjëherë së bëri pyetje, ndërhyri në çështjet më të nxehta (Origjina e Totalitarizmit 1951 dhe Banaliteti i të keqës 1963), studioi dhe hulumtoi për të gjetur përgjigjet që vinin nga një vepër intelektuale e bazuar në origjinalitetin e kërkimit të motivimeve në realitet dhe në lirinë e mendimit. E konsideruar si teoricienja më e madhe politike e shekullit të njëzetë, ajo iu përkushtua reflektimit filozofik dhe politik, duke marrë në konsideratë analizën antropologjike të shoqërisë, veprimit shoqëror dhe politik, duke u nisur nga “pluralizmi” si një fakt thelbësor i jetës njerëzore, tema të zhvilluara në librin “Gjendja njerëzore 1958”, një tekst kompleks dhe shumë aktual për analizën e tij shumëformëshe të shoqërisë masive, për zgjerimin e vizionit të saj që arrin të identifikojë procese të pa përcaktuara ende në kohën në të cilën u



shkrua. Arendt, edhe pse nuk e quante veten një pedagogjiste të mirëfilltë, na la një mendim pedagogjik mjaft të rëndësishëm edhe për kohën e sotme.

Politika dhe arsimit

Për Arendt, arsimit ndodhet në një nivel parapolitik që pengon mbivendosjen e tij mbi politikën. Kthimi i arsimtarëve për të qeverisur ka pasur pasoja shumë të rëndësishme. Në sajë të këtij kthimi, ata që qeverisnin morën qëndrimin e arsimtarëve, ndërsa arsimtarët akuzoheshin se ushtronin dominim. Atëherë si sot, rëndësia në politikë e shembujve të trajtuar nga situata tipike të sferës pedagogjike-arsimore është shumë e diskutueshme: në politikë kemi të bëjmë gjithmonë me të rritur që kanë kaluar moshën e arsimimit të duhur. Politika, domethënë e drejta për të marrë pjesë në trajtimin e çështjeve publike, fillon pikërisht kur përfundon faza e vertetë e arsimimit. Përkundrazi, në procesin arsimor përfshihen gjithmonë individë të cilët ende nuk mund të pranohen në politikë apo në të drejta të barabarta sepse nuk janë ende gati t'i shërbejnë asaj (Arendt, 1956).

Nëse arsimit karakterizohet nga autoriteti, politika është nga bindja: në rastin e parë mar-

rëdhënia që krijohet është vertikale dhe hierarkike; në të dytën, horizontale dhe i barabartë. Funkcioni i arsimit është, ai i ruajtjes së autoritetit dhe traditës, garantimi i vazhdimësisë së tyre, ndërsa qëllimi i politikës, është ruajtja e pa parashikueshmërisë së veprimit dhe transformimi i rendit të pararendosur. Rëndësia që i jepet arsimimit publik nga të gjitha uto-pitë politike, që nga lashtësia, dëshmon se sa e natyrshme është të mendosh për fillimin e një bote të re duke u nisur nga qeniet “të reja”, nga të lindurit dhe nga natyra. Në kuptimin politik, kjo ide zbulon një keqkuptim serioz: në vend që të merret përsipër barra e bindjes së njerëzve, duke rrezikuar të dështosh me ta, ndërhyr në mënyrë diktatoriale i bindur për epërsinë absolute të të rriturit, me pak fjalë, tentohet të “prodhohet” e reja si një fakt i kryer, pra sikur të ekzistonte tashmë (Arendt, 2017). Edukimi nuk mund të gjejë vend në politikë, i cili shikon vetem ata që e kanë mbyllur shkollimin. Duke qënë i pamundur një “edukim” i të rriturëve, në politikë kjo fjalë tingëllon shumë keq: kushdo që dëshiron të “edukojë” të rriturit, në realitet ai dëshiron të jetë tutori i tyre, duke ua mohuar hyrjen në politikën aktive. Edukimi është preteksti: qëllimi autentik është një shtrëngim që nuk përdor forcë (Agnese 2013).

Kriza e Arsimit – Dashuria për botën

Edukimi është momenti që vendos nëse e duam mjaft botën, për të marrë përgjegjësinë për të dhe për t'a shpëtuar atë nga rrënim, që është e pashmangshme pa rinovim, pa ardhjen e qenieve të reja, të rinjëve. Në edukim vendoset nëse i duam mjaft fëmijët tanë, aq sa (Arendt, 2017):

- Të mos i nxjerrim jashtë botës duke i lënë ata në mëshirën e tyre.
- Të mos ua heqim mundësinë për të ndërmarrë diçka të re, diçka të pa parashikueshme.
- T'i përgatisim ata për detyrën e rinovimit të një bote që do të jetë e përbashkët për të gjithë.

Momenti që vendos nëse e duam botën mjaftueshëm: dashuria është pasioni i nevo-

jshëm, erosi që na çon në përfshirje dhe përkushtim, na dërgon përtej vetes, duke na nxjerrë nga bota jonë personale dhe egoiste për të vepruar në jetë dhe për jetën së bashku, sepse jemi në botë me djem dhe vajza, burra dhe gra me të cilët ndajmë jetën tonë. Dashuria bashkon realitete të copëtuara, të cilat, pasi janë ndarë, janë shkëputur, siç ndodh kur marrëdhënia midis atyre që mësojnë/edukojnë dhe atyre që nxënë, është rralluar deri në zhdukje (Nanni, 2015).

Të marrësh përgjegjësinë dhe kështu të shpëtohet nga rrënimi: përgjegjësia, ajo vetëdije që bëhet veprim me kujdesin e nevojshëm për vetë ekzistencën. Arsimi është një marrje përgjegjësie, jo një profesion që duhet kryer pak a shumë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale. Jo, nuk mjafton, sepse mund të kapet kuptimi dhe në mënyrë të vetëdijshme mund ta vendosim veten në një marrëdhënie edukuese dhe formuese me ata që shpesh nuk janë në gjendje të dinë ose të kërkojnë atë që u nevojitet. Përgjegjësia për të qenë, ka nevojë për veprime, nuk mund të thuhet se merret përgjegjësi për diçka, për çdo gjë, pa kryer në atë mënyrë që veprimet të bëhen me përgjegjësi, gjë që ka efekte në realitetin përreth (Nanni 2015).

Të mos i nxjerrim jashtë botës duke i lënë ata në mëshirën e tyre: vëmendje ndaj fëmijëve, për edukimin dhe formimin e tyre për të siguruar qëndrueshmërinë e një qytetërimi në të vetmen mënyrë të mundshme: domethënë duke u ofruar “gjeneratës së sotme” një udhërrëfyes nëpër atë botë tashmë të formuar në të cilën lindin të rejtat. Fëmijët tanë lihen të kujdesen për veten e tyre, kur nuk janë në gjendje t’u jepet atyre ajo që u nevojitet për të formuar hartën e tyre të botës, nga e cila të kuptohet se ku gjenden për t’i orientuar, të zgjedhet me vetëdije pa u rrëmbyer nga një e panjohur e pa deshifrueshme (Arendt 2017).

Tradita - ajo që mund të duket konservatorizëm, është e kuptuar si një transmetim jolinear, subjekt i mohimeve dhe ripërpunimit radikal. Ajo është një dëshirë për të siguruar së bashku me njohuritë e realitetit, mjete që mund të strukturojnë mendjen në mënyrë që të jenë në gjendje të orientohen, duke njohur në



atë që ndeshen, kuptimet dhe arsyet e qenies së tyre, dhe të mos e pranojnë atë ashtu siç është (Nanni, 2015).

Për të mos u rrëmbyer nga duart mundësinë për të ndërmarrë diçka të re, diçka të pa parashikueshme dhe përkundrazi t’i përgatisë ata për detyrën e rinovimit të një bote që do të jetë e përbashkët për të gjithë: kushti që procesi i formimit të përfundojë dhe të ketë një rezultat është liria. Ajo i mundëson personit të ri të shprehet dhe të krijojë, në mënyrë që të ndërmarrë diçka të re, të pa parashikueshme, sepse kjo është e nevojshme për vazhdimësinë e ekzistencës së një bote që ndryshon dhe që gjithmonë duhet të vëzhgohet dhe përfshihet në bërjen e saj, e cila ka nevojë për novacionin që mund të sjellë çdo njeri, në mënyrë që çdo herë, bota të rikuptojë dhe ripërfshijë jetën në të gjitha manifestimet e saj. Krijueshmëria njerëzore është shfaqur gjatë historisë në shkencë, art, teknologji dhe në çdo veprimtari njerëzore. Çdo qenie ka karakteristika të veta dhe duhet të sigurohemi që çdo origjinalitet të mund të zhvillohet dhe të shprehet në krijueshmëri, sepse ky është qëllimi i çdo njeriu, dhe ajo që vjen nga një person, sapo të shfaqet, bëhet trashëgimia e një bote që është e



përbashkët për të gjithë. Në fakt, edukimi lejon ruajtjen e fillit që lidh zinxhirin e brezave, duke e bërë atë të aftë të mirëpresë ardhjen e qenieve të reja të afta për ta modifikuar atë së bashku me historinë dhe traditën (Agnese, 2013).

Kurimi dhe Arsimi

Janë tre pika që theksohen në vendosjen e kurimit në “rendin e ditës” në lidhje me temën Arsim-Edukim (Nanni 2015):

Pluralizmi: është një burim mjaft i rëndësishëm në një botë pluraliste në të cilën dallimet perceptohen si pjesë e një pasurie të përbashkët në jetë. Është e natyrshme që dallimet ideologjike dhe të mendimit mund të jenë problem. Por kjo ndodh për shkak të pamundësisë për të menduar se jeta merr formë të ndryshme dhe se ajo duhet respektuar si vlerë, edhe kur është e pa pajtueshme me mënyrën tonë të ekzistencës. Në fakt, e kundërta e këtij respekti mund të jetë vetëm shkatërrimi.

Brishtësia: si qenie njerëzore është e nevojshme të kuptohet se është pjesë përbërëse e vetes sonë, është një karakteristikë e gjithçkaje që ekziston, e të tërës që është pjesë e jetës. Forca me të cilën veprohet për të reaguar ndaj gjendjes së brishtësisë të përkohshme nuk është mohimi i kësaj brishtësie të formuar. Nuk do të ishim në gjendje të perceptonim me ndjeshmërinë tonë, me të gjitha shqisat tona, nëse nuk do të përbëheshim edhe nga brishtësia e formuar. Vetëdija për brishtësinë tonë, e cila mund të minojë guximin, rresën tonë, na afron dhe na bën të shikojmë njëri-tjetrin me sy që shkon përtej ndryshimit. Na lejon të kuptohet humanizmi tek njerëzit e tjerë, pikërisht në momentet kur dallimet dhe kontrastet mund të çojnë në mosmarrëveshje. Ndjenja: ajo nënkupton marrëdhënien themelore me botën dhe me veprimet tona. Është pasion, butësi, dashuri, zemërim, gjithçka që mbush dhe ngjyros qenien tonë. Shumë ngjyra janë të mundshme, sa është zhvilluar

aftësia jonë për t'i ndjerë. Dikotomia arsye/ndjenjë në origjinën e disiplinave shkencore dhe filozofike ka kufizuar aftësinë për të sistemuar praktikën pedagogjike-edukative-didaktike, e cila nuk mund të jetë e plotë nëse përjashton përmasën e ndjenjës (dhe emocionet që shkakton) nga marrëdhënia edukuese në procesin e nxënies. Situata në trurin tonë, mendja, është e orientuar nga emocionet dhe kjo bëhet një parim përzgjedhës i përvojës tonë në jetë dhe për rrjedhojë edhe në zgjedhjen e pavetëdijshme që bëjmë kur jemi në një situatë të nxëni.

Autoriteti-Tradita-Liria, tre gurët e themelit të arsimit

Në mendimet e saj, Hannah Arendt e paraqet treshen Autoritet-Traditë-Liri si thelbësore për mundësinë e vetë ekzistencës dhe realizimit të arsimit. Ato janë elemente thelbësore edhe sot. Kriza e arsimit, organizimi i sistemit arsimor bëhet një problem politik me rëndësi parësore kur është në krizë, krizë kjo e krijuar nga risitë pedagogjike, siç është pragmatizmi. Barazia, si natyrë, është një nga shkaqet e krizës për sistemin arsimor, ku është ajo që pohohet mes të rriturve dhe fëmijëve, mes mësuesve dhe nxënësve, mes shumë e më pak të "të aftëve". Kjo lloj barazie vihet në pikëpyetje nga filozofja, detyra e barazisë minon gjithashtu autoritetin e nevojshëm për marrëdhëniet mes mësuesve dhe nxënësve (Arendt, 2017).

Si në të gjitha utopitë, të riut i është shoqëruar, në mënyrë natyrore, fillimi i diçka të re, duke filluar me të porsalindurin, dhe kjo është arsyeja pse konsiderohet e nevojshme të fillohet me fëmijët, nëse duhet të krijohen kushte të reja. Megjithatë, rreziku është që gjeneratat e reja të edukohen në një botë të vjetër, e cila do t'u hiqte atyre mundësinë për të krijuar botën e tyre të re. Atëherë të menduarit për një botë fëmijësh në vetvete mund të ishte një zgjidhje. Por nuk është kështu, sipas Arendt. Nxënia e vazhdueshme nga mësuesit do të ishte e vetmja mënyrë për të shmangur transmetimin e "tematikave të vdekura" famëkeqe, pikërisht sepse vetë mësuesit do të shfaqeshin para nxënësve gjithnjë duke synuar procesin e prodhimit të dijes.

Hannah Arendt argumenton se vlera e barazisë

dhe pragmatizmit anullojnë rolin e mësuesit në disa kuptime: atë të atij që ka autoritet, që vjen nga njohja e traditës (Arendt 2017), ai që ruan dhe transmeton kujtesën (kultura dhe historia) si traditë. Autoriteti është i nevojshëm për transmetimin e kulturës dhe për rrjedhojë ruajtjen e saj, si traditë dhe si kujtim. Duke cituar Tocqueville: "Pa të kaluarën që hedh dritën e saj mbi të ardhmen, njerëzit prekin errësirën". Ruajtja e traditës, duhet të jetë sepse mund të jetë mundësia që njerëzit të formohen dhe të kenë forcën e nevojshme për të sjellë "të renë". Përballë nxënësit, mësuesi kualifikohet të njohë botën dhe të jetë në gjendje të udhëzojë të tjerët për të, ndërsa ai është autoritar në atë që merr përgjegjësinë për atë botë. Përpara nxënësit ai është një lloj përfaqësuesi i të gjithë qytetarëve të globit që tregon detajet duke thënë: këtu është bota jonë (Arendt, 2017). Pra, përmbledhja është se arsimit bazohet në: traditën, autoritetin, lirinë dhe se kur njëri prej këtyre faktorëve është në krizë, është e pashmangshme që kriza të shtrihet në të gjithë arsimin dhe sistemin e tij.

Tradita krahasohet me testamentin që lidh të mirat e kaluara me një moment të ardhshëm. Pa traditën (që bën një zgjedhje dhe cakton një emër, kalon dhe ruan, tregon se ku janë thesaret dhe cila është vlera e tyre), kohës i mungon një vazhdimësi e dhënë me një akt të qartë vullneti, dhe për rrjedhojë, në terma human, atje nuk është më ndonjë e kaluar apo e ardhme, por vetëm evolucioni i përjetshëm i botës dhe cikli biologjik i krijesave të gjalla (Arendt, 2017).

Bibliografia

- Agnese, D. (2013). Il problema della Bildung nel pensiero di Hannah Arendt. Cultura, politica e identità Tesi di Dottorato. Università degli Studi di Firenze.
- Arendt, H (1956). Was ist Autorität, in «Der Monat», VIII, 89, trad. it, Che cos'è l'autorità, in Tra passato e futuro, cit. pp. 163-164.
- Arendt, H. (2017). La crisi dell'istruzione, in Tra passato e futuro, Garzanti.
- Nanni, L (2015) – Istruzione e Cura del mondo: oltre La crisi dell'istruzione di Hannah Arendt. Atelier Educazione.

Që lumin Buna, të mos e marrë Buena¹

Sa të mbrojtura janë "Peisazhet e mbrojtura"



Msc. Ornela Luka
Pedagoge pranë Kolegjit
Universitar "Qiriazi"



Ujërat sipërfaqësore përbëjnë pasuri të madhe për ekonominë e vendit, edhe në aspektin natyror, për larminë e madhe të florës dhe të faunës. Habitatet ujore janë të rëndësishme për shumë përdorime tradicionale, si vaditje, peshkim, turizëm dhe industri. Pranë lumenjve gjenden shumë qendra të tjera të banuara si dhe mjaft zona industriale, bujqësore dhe blegtorale, ku pothuajse të gjithë lumenjtë, liqenet dhe zonat bregdetare, fatkeqësisht shërbejnë si vend shkarkimi për mbeturinat urbane dhe industriale të lëngëta dhe në disa raste edhe të ngurta. Këto aktivitete, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikojnë në cilësinë e ujërave, si rrjedhojë gati të gjitha mjediset ujore janë pak ose shumë të kërcënuara.

Një ndër to përmendim lumin Buna. Buna është një lum i mrekullueshëm, që buron nga liqeni i Shkodrës dhe derdhet në detin Adriatik, në Velipojë. Për nga sasia e ujit që sjell në det është i treti në Mesdhe. Një ndër veçantitë dhe karakteristikat e këtij lumi është se fundi i shtratit të tij, duke filluar nga gryka e derdhjes dhe në tërë gjatësinë e tij, është nën nivelin e detit. Kemi parasysh rrjedhjen e madhe, ku edhe pranë tij uji i detit depërton thellë e përgjatë shtratit të tij. Pra, në shtratin e tij kemi edhe ujin e detit të kripur dhe ujin e ëmbël të lumit.

¹ Buena- rrjedhë e fuqishme, që merr përpara gjithçka. "Të marrtë buena"- shprehje popullore, që klasifikohet si nëmë ose mallkim.



“Me letra” konsiderohet si “Peisazh i mbrojtur”, nën emërtimin “Lumi Buna-Velipojë”, por realiteti flet ndryshe. Institucionet përgjegjëse nuk ngurojnë të rreshtojnë e madje edhe të bëjnë publike të dhëna për këtë objekt të rëndësishëm. Por harrojmë të nënvizojmë: Peisazhi “i mbrojtur”, sa është i mbrojtur? Ky peisazh ujqor/tokësor me sipërfaqe rreth 23 mijë ha, ku përveç sipërfaqes së basenit ujqor ka edhe sipërfaqe shkurre e pyjore, sipërfaqe lagunore, duna, toka të kripura etj (pa llogaritur sipërfaqen e tokës bujqëore dhe zonat e banuara), është nën kërcënime serioze për shkak të ndotjes së ujërave të lumit.

Të dhënat klimatike, për këtë zonë, janë ndër më të lakmueshmet e të gjithë rajonit. Me një temperaturë mesatare vjetore 16-18°C, me 1600-1800 mm shi në vit dhe me deri 300 ditë me diell, ky peisazh konsiderohet një habitat perfekt për florën dhe faunën e shumëllojshme. Por jo vetëm një habitat: Grykëderdhja e lumit Buna; lagunat e Velipojës, Vilunit, Murtemzës etj; Dunat bregdetare dhe pyjet bregdetare, janë “shtëpitë” e mjaft bimëve dhe kafshëve, pa llogaritur

pasurinë ujore.

Bimësi të shumtë pyjore ka në brigjet e lumit në Rezervatin e Velipojës, Ishullin Ada dhe Franc Jozef, në fshatin Reç, në ishullin e Bahçallekut etj. Bimësia e këtyre sipërfaqeve pyjore përbëhet kryesisht nga disa lloje plepash, shëlgjesh, frashëri, dushqesh e gjithashtu nga rrushkulli, akacia, thana, shkoza, mrina etj.

Pasuria e këtij peisazhi vijon me numrin e madh të shpendëve, që shkon mbi 40 specie. Ligatina është një strehë për shpendët migratorë të detit dhe tërheq shumë lloje zogjsh si kryekuqe, rosa, bajzat, kredharaku, karabullaku, çafka. Zona është gjithashtu një mjedis i rëndësishëm ushqimi dhe migrimi për pelikanët dalmatë. Në pyll jetojnë kafshë të shumta të egra: lepuri, çakalli, derri i egër, fazani etj. Madje në pyllin e Majës së Zezë (Por që lidhet indirekt me këtë peisazh), është regjistruar edhe Ariu i Murmë.

Zemra e peisazhit është vetë lumi Buna. Po të mos ekzistonte lumi, nuk do të kishim kaq shumë komponentë të këtij ansambli natyror. Të gjitha gjymtyrët që përbëjnë këtë peisazh natyror, janë formuar si rezultat i

“lojës” së lumit në shekuj. Edhe ligatinat, edhe dunat, edhe ishujt, edhe lagunat, edhe kënetat, janë krijuar prej “lojës” së ujit të këtij lumi.

Por sa të mbrojtur e kemi ujin e këtij “Peisazhi të mbrojtur”? Kemi të bëjmë me një lum të pastër, siç e reklamojmë duke i rënë gjoksit, se “e kemi në listën e peisazheve të mbrojtura”, apo e kemi kthyer këtë pasuri të shenjtë, në vendabsorbimi të jashtëqitjeve tona?

Fatkeqësisht, në çdo 10 metra ka një vend shkarkimesh të mbetjeve të ndryshme nga bizneset private apo banorëve që banojnë pranë këtij lumi dhe kontribuesi kryesor në ndotjen e Bunës (le të themi, qershia mbi tortën që nuk e han kurrkush), është vetë “SHTETI”. (E shkruajta me germa kapitale, që ta lexoni mirë). Po e lexuat, shteti, i cili ka vite që lejon derdhjen e pa trajtuar të ujërave të zeza të qytetit, duke i shkarkuar ato në lumit Buna, të cilat shpërndahen edhe në ujrat e liqenit. Qytetarët e Shkodrës, këte fatkeqësi “njerëzore” dhe kasaphanë mjedisore e hasin çdo ditë. E pra, ka 18 vjet, qysh prej vitit 2005, që lugina e këtij lumi, kështu po e quaj peisazhin, është shpallur zonë e mbrojtur.

Pyetja më e thjeshtë do ishte: pse shteti e lejon këtë gjë? Përgjigjja do të ngjasonte me një lojë ping pongu midis qeverisjes vendore dhe qeverisë së Tiranës, të cilat shpejtojnë, jo t’i japin zgjidhje problemit, por për t’i lënë “gil-in” njëra tjetërs se kush e ka fajin. E në fakt, fajtori duhet t’i interesojë qytetarit shkodranë që në mbasditen e çdo dite, në vendin më atraktiv, në këmbë apo me një biçikletë për dore, duke shetituar në pedonalen me një peisazh të gjelbër, papritur ballafaqohet me një realitet tjetër: pak metra me tutje nga ura e Bunës derdhen me anë të një kanali (kolektori) gjithë ujrat e zeza të patrajtuara. Kjo nuk është thjeshtë “pamje e shëmtuar”, ndotje peisazhistike apo një aromë e pakëndshme. Është shumë më tepër: ka pasoja të rënda shëndetësore. Një numër i konsiderueshëm njerëzish në botë sëmurën dhe vdesin çdo vit për shkak të ndotjes mikrobiale të ujërave sipërfaqësore të

përdorura për të pirë, për rekreacion, ujitje, akuakulturë apo të konsumimit të qenieve të gjalla që rriten në këtë habitat. Në derdhje të Lumit Buna, në thellësi deri 40 m në det, janë gjetur mbi 60 specie peshqish. Nga ato më dominantet si barbuni, merluci, gjuhëza etj, ashtu edhe specie që zhvillojnë migrime biologjike në rrugën det-lum-liqen si qefulli I verës, qefulli I vjeshtës, ngjala, peshku elektrik, kubla etj, të gjitha specie me rëndësi për peshkimin. Po kështu në këtë areal ujqor janë hasur edhe delfinët (delfini turkishishe), breshka e detit etj. Mbi të gjitha prej këtyre ujërave peshkohet e konsumohet me shumicë krapë, karasi etj. E gjithë kjo pasuri që ne e peshkojmë, edhe nëse do të mbijetonte në këtë “skëterrë ambientaliste ujore”, do të rezultonte shumë e dëmshme nëse ne do ta konsumonim.

Janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen studime shkencore, projekte pa fund në lidhje me ndotjen e lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës, por fatkeqësisht nuk kanë pasur zë të fuqishëm, tip “këmbane alarmi” për të zgjuar institucionet përkatëse. Ka vite që flitet, se projekti për një impiant të trajtimit të ujërave të zeza është gati, por deri atëherë duhet të presim. Duhet të presim akoma që të ballafaqohemi me këtë situatë mjedisore dhe të shpresojmë që peshqit që ne konsumojmë, të mos i kenë drejtuar velat e tyre nga ujrat e kontaminuara, për të na e përcjellë pastaj në trupin tonë këtë infektim. Kur themi, se një ndër zgjidhjet është impianti, kjo nuk do të thotë se, me kaq mbaron çdo gjë. Impianti është pikënisja, pulsimi i zemrës, e cila ka nevojë për përkujdesje që të kapin ritmet e duhura. Pas impiantit ka një sërë detyrimesh dhe angazhimesh të tjera si: trajnimi dhe kualifikimi i stafit, përmirësimi teknologjik në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare, monitorimi i vazhdueshëm i parametrave fiziko-kimik dhe bakterologjik të lumit Buna, me qëllim për të gjetur më saktë burimet e ndotjes dhe të merren ndëshkime ligjore për individët që ndotin ambientin, si një mënyrë ndërgjegjësimi për veprimet jo të duhura.

Përveç pasojave shëndetësore-ekologjike, ndotja e lumenjve sjell edhe probleme të tjera në ekonomi, si përsëmbull në turizëm. Ndikimet negative të turizmit duken në rënien e interesit të turistëve të huaj për ta vizituar këtë qytet apo rrethinë. Rrjedhimisht shkojmë drejt rënies së fuqisë ekonomike për Shkodrën. Askush nuk do të dëshironte të vizitonte një vend të ndotur apo aq më tepër të konsumonte ushqime të ndotura.

Dominimi i njeriut mbi natyrën është katastrofale për botën e gjallë. Mjedisi është pasuria e vetme e përbashkët që gjithë njerëzimi ka

Më poshtë po japim një tabelë ku pasqyrohet, ndikimi i veprimtarisë njerëzore dhe problemet e identifikuar.




Problemet	Shkaqet	Pasojat	Rekomandime
Mbetjet depozitohen në fusha të hapura të pa kontrolluara	Nuk funksionon grumbullimi i mbetjeve. Gjatë sezonit turistik me shtimin e popullatës mbetjet shumëfishohen	Ndotja e lumenjve, detit dhe e rërës	Përdorimi i landfillit ku transporti dhe kostoja financiare është e vogël si pasojë e favorizimit të distancës në Bushat
Ujrat e zeza të patrajtuara që derdhen në lumë	Mungesa e një implantit	Shfaqja e sëmundjeve infektive	Ndërhyrja e bashkisë për lidhjen e kanalizimeve në të gjithë territorin
Ndërtimet pa leje	Mos planifikimi urban nga ana e bashkisë. Lejimi i ndërtimeve pa kriter dhe pa leje, mos zbatimi i ligjit	Zhvillimi i turizmit në mënyrë kaotike çon në shkatërrimin e biodiversitetit dhe habitateve	Hartimi i një plani të zhvillimit turistik
Ndryshimi i vijës bregdetare	Faktori natyror dhe faktori njeri	Zhdukja e shumë bimëve, humbja e shumë hektarve tokë	Ndërgjegjësim nga ana e njerëzve
Gjuetia	Mos kontrollimi nga ana e qeverisë	Zhdukja e specieve endemike	Zbatimi i ligjit
Peshkimi	Peshkimi në periudhën e shumimit dhe mos zbatimi i ligjit	Zhdukja e peshqve të rrallë, pakësimi i peshkut në kohën e shumimit	Ndalimi i peshkimit gjatë kohës së shumimit, ndalimi i peshkimit me dinamit dhe me rrymë elektrike. Krijimi i shoqatave të peshkimit për monitorimin e tyre

Institucione shkencore ndërkombëtare

Shoqata Ndërkombëtare për Shkencën e Hortikulturës




ISHS
International Society for Horticultural Science



Ky organizëm është themeluar në prill të vitit 1959. Funksiononte fillimisht si një "Rrjet global i hortikulturistëve dhe shkencëtarëve të hortikulturës" që kërkonin bashkëpunim ndërkombëtar. Më vonë u emërtua "Shoqata Ndërkombëtare për Shkencën e Hortikulturës (ISHS). Kjo shoqatë ndërkombëtare ka në përbërjen e saj mbi 60,000 individë, universitete, qeveri, institucione, biblioteka dhe kompani tregtare. ISHS është bërë institucioni më madh dhe më i rëndësishëm për shkencën e hortikulturës. Qendra e kësaj Shoqate është në Bruksel, në qytetin Leuven, një nga qytetet më tërheqëse të Belgjikës, ku mes dhjetra vendeve atraktive për të vizituar, ka edhe një Kopësht Botanik, më i vjetri në këtë shtet, ku janë të mbjellura me qindra bimë, të sjellura nga gjithë bota.

Anëtarësimi në ISHS ofron mundësi të pafundme njohjeje dhe kërkimi në shkencat e hortikulturës. Ky organizëm shkencor ka një përzierje unike të divizioneve dhe komisioneve, grupeve të punës, simpoziumeve, publikimeve, listave të postimeve, shërbimeve online etj. ISHS bashkëpunon me institucionet shkencore të fushës së hortikulturës të të gjitha vendeve të botës. Me universitete, Kopësht botanike, institute kërkimore të kësaj fushe dhe me personalitete të veçanta: në të dy hemisferat dhe në shtat kontinentet. Nga viti 1959 e deri më sot



Botim periodik i ISHS, print dhe online

janë organizuar me dhjetra konferenca shkencore, simposiume, kongrese etj, për bimë të veçanta të hortikulturës dhe për grupe bimësh, për të gjitha hallkat e teknologjisë së këtyre bimëve. Të gjitha eventet shkencore organizohen nga ISHS në bashkëpunim me institucionet vendase. Të gjitha këto materiale shkencore janë të publikuara dhe të aksesueshme njëqind përqind vetëm për anëtarësinë e saj, por botimet e printura mund të sigurohen për gjithë kush i dëshiron, kundrejt pagesave.

Anëtarësimi në këtë shoqatë, kundrejt një kuote vjetore, u jep mundësi anëtarëve të interesuar që të jenë pjesë e një rrjeti të përbashkët informacioni me kolegë të të gjithë botës, që kanë interesa dhe shqetësime të ngjashme. Mësohen së pari teknikat dhe zbulimet e reja dhe rritet aksesimi tek një numër shkencëtarësh që mund të kenë zgjidhje për pyetjet që duhet t'u përgjigjemi sot. ISHS u ofron anëtarëve të saj një platformë që i lejon ata të ndajnë njohuritë në shkallë ndërkombëtare.

Përfitimet e të qenit anëtar i ISHS:

Një kopje falas e listës vjetore të anëtarësimit të ISSHS dhe drejtorisë së Divizioneve apo Komisioneve në format elektronik. Kërkim i pakufizuar në drejtorinë interaktive të anëtarësimit në internet ISHS. Një kopje tremujore e revistës "Chronica Horticulturae" në format elektronik si dhe paraqitje falas e abstrakteve në

çdo simpozium apo kongres të ISHS. Anëtar i kësaj shoqate përfiton 20% zbritje në porositë e librave të printuar të Acta Horticulturae. Përfitohen falas një numër shkarkimesh të artikujve me tekst të plotë Acta Horticulturae si dhe një numër shkarkimesh falas të artikujve me tekst të plotë nga botime të zgjedhura të palëve të treta në www.pubhort.org. Titujt përfshijnë: Revista e Hortikulturës, Frutat, Gazeta e Shoqatës Amerikane të Pomologjisë, Gazeta e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën e Kërpudhave etj.

Një zbritje e konsiderueshme kur publikohet në Gazetën Evropiane të Shkencave Hortikulturore (eJHS) ose në Frutat, The International Journal of Tropical & Subtropical Horticulture. Gjithashtu anëtar i ka të drejtën e pjesëmarrjes në Grupet e Punës, Divizionet dhe Komisionet e ISSH-së dhe rrjetëzimi me kolegë studiues. E drejta e votës në divizionet, komisionet, grupet e punës dhe në Asamblenë e Përgjithshme të ISSHS.

Shoqata Nëkombëtare e Shkencës së Hortikulturës ka organizuar me dhjetra simposiume shkencore për të gjitha llojet e bimëve të hortikulturës si dhe aktivitete të tjera si Kongrese të Hortikulturës, qofshin këto kongrese botërore apo të kontinenteve të veçanta.

Jeta studentore

Copëza nga aktivitetet e ndryshme mësimore dhe jashtëkurrikulare që zhvillohen në suazë të Kolegjit Universitar Qiriazi

Përgatiti Marina Dyli dhe Majlinda Prendi



Universiteti Qiriazi organizoi Edicionin e 2-të të Panairit të Punës, ku studentët dhe alumni u njohën me ofertat e punësimit dhe internship-it në kompani nga fusha të ndryshme të ekonomisë, biznesit, hotelierisë, sporteve, drejtësisë, teknologjisë ushqimore, teknologjisë së informacionit etj.



Studentët e programit të studimit "Teknologji Ushqimore" përmblyhen me sukses praktikat profesionale pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), falë marrëveshjes së bashkëpunimit të realizuar nga Universiteti Qiriazi.



Universiteti Qiriazi takon maturantët në qytetin e Tiranës, realizuar për këshillimin dhe informimin e tyre për Studimet e Larta Akadematike. Maturantët u njohën nga afër me programet e vitit të ri akademik 2023-2024



Në mjediset e Kolegjit Universitar Qiriazi u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Akademisë gjermane të Trajnimit & Edukimit "Auxila". Firmoset marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve, e cila u jep akses studentëve të programit Kujdes Social e Shëndetësor.



Mbledhje e Këshillit Studentor Qiriaz, përfaqësuar nga senatorët se bashku me Presidentin e Universitetit Qiriaz Prof. Dr. Gjokë Ulledaj dhe Rektorin Prof. Dr. Maksim Meço. Fokusi i takimit u përqëndrua tek jeta studentore, mbarëvajtja e vitit akademik, konferencat shkencore studentore etj.



Studentët e programit të studimit 2-vjeçar “Teknologji Ushqimore” në Universitetin Qiriaz, nën drejtimin e Prof. Dr. Abdyl Sinani dhe Pedagoges Ornella Luka referuan punimet e përgatitura për prezantim, shoqëruar dhe me produktet e prodhuara në laborator dhe jashtë tij.



Në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi” u mbajt ceremonia e hapjes për Kampionatet Kombëtare Universitare 2023. Studentët e Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit në KUQ garojnë këtë vit në disiplinat futboll, voleyboll dhe basketoll.



Me 6 Prill, në Ditën Ndërkombëtare të Sportit për Zhvillim dhe Paqe, Fakulteti i Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit në Universitetin Qiriaz organizoi inagurimin e palestrës së gjimnastikës.



Ekipi i ndihmës së parë “Qiriaz”, i përbërë nga studentë të programit të studimit “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, por edhe studentë vullnetarë nga programet “Hoteleri-Turizëm” dhe “Teknologji Ushqimore”, nën kujdesin e trajnerit të ndihmës së parë, pedagogut Dr. Edlir Orhani, mori pjesë në konkursin e ndihmës së parë bazike, organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH).



CEO Gladiola Dona, eksperte e komunikimi dhe menaxhimit në fushën e hoteleri-turizmit, themeluese e “Akademisë së Mikëpritjes”, mbajti një leksion të hapur me studentët e programeve “Menaxhim Hoteleri-turizëm”, “Teknologji Ushqimore” si edhe me studentë nga programe të ndryshme, të Universitetit Qiriaz.



Në Ditën Botërore të Sigurisë Ushqimore, Prof. Dr. Klementina Puto, shefe departamenti në Bioteknologji, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, jep një leksion të hapur në Kolegjin Universitar Qiriaz.



Një nga programet më të reja profesionale në Kolegjin Universitar Qiriaz, është programi “Kujdes social dhe shëndetësor”. Qëllimi i programit profesional “Kujdes Social dhe Shëndetësor”, është t’i shërbejë sistemit të Kujdesit Social dhe Shëndetësor.



Universiteti Qiriaz organizoi kompeticionin “Future Business Idea 2023”, konkurs vjetor i idesë së biznesit, ku na ofron ne studentëve të të gjitha disiplinave mundësi për të eksploruar idetë tona kreative dhe inovative të biznesit! Ky konkurs kishte si qëllim inkurajimin dhe nxitjen e studentëve tanw të të gjitha programeve, rritjen e kreativitetit dhe shndërrimin e një ideje biznesi nga teorike në një projekt konkret.



Akademia e Studimeve Ndërkombëtare (ISA) realizon takim informues në ambjentet e Kolegjit Universitar “Qiriaz”, lidhur me ofrimin e mentorimit akademik dhe profesional, i cili ndihmon studentët në avancimin drejt rrugës së lidershit profesional ndërkombëtar.



U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Qiriaz dhe Praktika.al. Praktika.al është një zgjidhje teknologjike inovatore që mundëson akses në kohë reale të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Kolegji Qiriazi - universiteti ku zhvillohen talentet

Nga muzika te shumësportet



ELDIS ARRNJETI

Student i fakultetit Ekonomik. Muzikën e ka pasion, por Financën e zgjodhi si profesion. Është zëri brilant që vazhdon të sfidojë në muzikë në konkurime të ndryshme. Ka studiuar në shkollën e mesme të muzikës “Prenk Jakova” në Shkodër, në instrumentin e fagotit dhe instrument sekondar saksofon. Pjesëmarrës që në fëmijëri në aktivitete të ndryshme, nga ku është vlerësuar edhe me çmime në festivale. Në Dhjetor 2021, Eldis Arrnjeti merr pjesë në Festivalin e 60-të në RTSH me këngën "Refuzoj", ku fitoi çmimin e tretë, ndërsa në Shtator 2022, merr pjesë në “Kënga Magjike 2022” me këngën "Lutem". Endrra e tij për muzikën nuk ja zbehu asnjëherë dëshirën për profesionin e tij të ardhshëm si Financier.



ERGYS PEPOSHI

Studenti i Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit, tashmë është zyrtarisht mesfushor i djathtë me Teutën e Durrësit, në Superligën Shqiptare të futbollit. Në të shkuarën Peposhi ka luajtur me "Kukësin", për 3 sezone radhazi. Gjithashtu ka qenë pjesë e ekipit të "Laçit" dhe "Elbasanit". Pasioni për futbollin, nuk e pengoi ta vijonte karrierën e tij në një tjetër dimension, duke e zhvilluar atë në nivel akademik në Universitetin Qiriazi.



NIKO THANO

Basketbollisti i Kombëtares dhe Ekipit “Kamza Basket”, është një tjetër talent i spikatur nga Universiteti Qiriazi. Është lindur në Athinë, ndërkohë që hapat e parë të karrierës i hodhi në shtetin fqinjë, në Greqi, ku luajti në ligen e parë greke për 6 vite. Më pas ka luajtur me “Tiranën”, “Teutën”, “Goga Basket” dhe tashmë është basketbollist me Ekipin “Kamza Basket”. I cilësuar si, ndër lojtarët më të mirë në Shqipëri, pjesë e ekipit kombëtar prej shumë vitesh, me shumë trofe dhe arritje në skuadra ku është aktivizuar.

Studenti i Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit vazhdon ta ndjekë pasionin e tij për basketbollin, duke marrë pjesë përballë skuadrave më me zë, në SuperLigë dhe në Ligën Unike. Aktualisht ushtron edhe profesionin e trajnerit të basketbollit për moshat e vogla U12 dhe U14.



ARDIT ONUZI

Peshëngritësi i cili u shpall Kampion Kombëtar që në moshën 17 vjecare. Potencialet i tij në sport i ka treguar ndër vite, duke marrë pjesë në një sërë garash si, Kampionati Kombëtar i Peshëngritjes, Kampionati European i Sportit, garat Ballkanike dhe Mesdhetare etj. Një sportist profesionist, që vazhdon ta ushqejë çdo ditë dëshirën e tij për sportin. Këtë e tregojnë më së miri medaljet e fituara në kampionatet pjesëmarrëse. Synimet e tij janë, arritjet sa më të larta dhe kontributet në fushën e Peshëngritjes duke marrë pjesë në garat e ardhshme ndërkombëtare. Me dëshirën, këmbënguljen dhe vullnetin e hekurt që e karakterizon, ai është një përfaqësues plotësisht i denjë për vendin tonë në sportin që manaxhon Federata Shqiptare e Peshëngritjes. Aktualisht ndjek studimet në Fakultetin të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit në Universitetin Qiriazi.



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI



Programe Studimi të Akredituara



FAKULTETI I EKONOMISË

Bachelor

- Financë (180 ECTS)
- Menaxhim Biznesi (180 ECTS)
- Menaxhim në Hoteleri - Turizëm (180 ECTS)
- Informatikë Ekonomike dhe Biznesi (180 ECTS)

Master Shkencor

- Financë (120 ECTS)
- Administrim Biznesi (120 ECTS)



FAKULTETI I DREJTËSISË

Studime të Integruara Cikli i Dytë (5-Vjeçare)

- Drejtësi (300 ECTS)

Diplomë e Lartë Profesionale (2-Vjeçare)

- Asistent Ligjor dhe Administrativ (120 ECTS)



FAKULTETI I EDUKIMIT, SHKENCAVE SOCIALE DHE SPORTIT

Bachelor

- Edukim Fizik dhe Sporte (180 ECTS)

Diplomë e Lartë Profesionale (2-Vjeçare)

- Kujdes Social dhe Shëndetësor (120 ECTS)



KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË

Diplomë e Lartë Profesionale (2-Vjeçare)

- Teknologji Ushqimore (120 ECTS)
- Hoteleri-Turizëm (120 ECTS)
- Teknologji Informacioni (120 ECTS)



KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
KAMPUSI UNIVERSITAR UBT,
KODER - KAMEZ, TIRANË

INFO@QIRIAZI.EDU.AL
SEKRETARIA@QIRIAZI.EDU.AL

+355 67 20 00 874
+355 69 40 94 518

WWW.QIRIAZI.EDU.AL



UNIVERSITETI
QIRIAZI

HAP DYERT PËR MATURANTËT

Ju mirëpresim nga e hëna - premte 09:00-15:00.

Cel: 067 20 00 874

E-mail: info@qiriaz.edu.al

Website: www.qiriaz.edu.al

**MSH
2023**